



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada-Government*  
MINISTRIA E ARSDIMIT, E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE APTËSËM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSLOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



2018

# Shenjat e Trafikut dhe Sinjalizimi Rrugor



Msc. Gëzim Berisha  
Inxh.dipl. Uran Mulaj

Prishtinë 2018

# SHENJAT E TRAFIKUT DHE SINJALIZIMI RRUGOR

Botuesi:

Axhencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të rritur

Përgatitur nga: Msc.Gëzim Berisha

Inxh.dip.Uran Mulaj

Për botuesin: Fikrije Zymberi

Dizajni dhe përgatitja për shtyp:Msc.Gëzim Berisha

Inxh.dip.Uran Mulaj

Tirazhi: 200 copë

Shtypi:BLENDI Prishtinë

## PARATHËNIE

*Ky libër është shkruar duke u bazuar në planin dhe programin e lëndës me të njëjtin emër pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT-it) në Prishtinë, në lëmin e transportit dhe trafikut rrugor.*

*Shenjat e trafikut dhe të sinjalizimit rrugor gjithnjë e më shumë po mundësojnë zhvillimin e parametrave të rëndësishëm prej të cilëve varet kualiteti i shenjave dhe i sinjalizimit të trafikut. Mirëpo gjatë punës si mësimdhënës në Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë në lëmin e transportit dhe trafikut rrugor si dhe në Shkollën e Mesme Teknike “28 Nëntori” në Prishtinë në profilin e instruktorëve për kategorinë B, si dhe shkak i mungesës së literaturës për lëmin e transportit dhe trafikut rrugor, e kemi parë të arsyeshëm botimin e këtij libri për t’u shërbyer brezave të rinj të kësaj fushe.*

*Me zhvillimin e hovshëm të transportit dhe të trafikut lindi edhe nevoja që trafiku të pajiset me shenja dhe sinjale të trafikut të cilat rrisin sigurinë e pjesëmarrësve në trafik si dhe kontribuojnë për zvogëlimin dhe parandalimin e aksidenteve të trafikut në nivel kombëtar, regjional etj.*

*Duke dashur të japim kontribut në lëmin e transportit dhe trafikut rrugor dhe komunikimit në përgjithësi, iu qasëm punës për botimin e këtij libri i cili posaçërisht duhet t’u shërbejë nxënësve në lëmin e transportit dhe trafikut rrugor, por mund të përdoret edhe nga studiues të tjerë që dëshirojnë të mësojnë ose specializohen në këtë lëmë.*

*Duke qenë të hapur për vërejtje dhe sugjerime qëllimmira, shpresojmë se ky libër do të mirëpritet nga ata që e lexojnë.*

**Autorët**

## PËRMBAJTJA

PARATHËNIE .....	3
PËRMBAJTJA .....	4
PËRMBAJTJA E FIGURAVE.....	6
PËRMBAJTJA E TABELAVE.....	9
HYRJE .....	11
NDARJA E SINJALIZIMIT RRUGOR .....	13
1 SHENJAT VERTIKALE .....	13
1.1 SHENJAT E RREZIKUT.....	14
1.2 SHENJAT URDHËRUESE (TË PËRSHKRIMIT).....	71
1.2.1 SHENJAT E PËRPARËSISË.....	71
1.2.2 SHENJAT E SHESHTA (FLAT).....	81
1.2.3 SHENJAT E NDALIMIT.....	85
1.2.4 SHENJAT E DETYRIMIT .....	129
1.2.5 SHENJAT E LAJMËRIMIT .....	141
1.2.6 SHENJA TË TJERA DHE TABELAT PLOTËSUESE .....	168
1.2.7 TABELAT PLOTËSUESE .....	176
1.2.8 SHENJAT TREGUESE .....	181
1.2.8.1 SHENJAT E PARALAJMËRIMIT.....	182
1.2.8.2 SHENJAT E DREJTIMIT .....	187
1.2.8.3 SHENJAT E INTINERARIT .....	188
1.2.8.4 SHENJAT POHUESE (TË POHIMIT).....	189
1.2.8.5 SHENJAT INFORMUESE TË CILAT NA INFORMOJNË PËR GJENDJEN E RRUGËS SI DHE KUFIJTË E LEJUAR TË SHPEJTËSISË NË TO 190	
1.2.8.6 SHENJAT TURISTIKE DHE TË TERRITORIT .....	191
2 SHENJAT NDRIÇUESE .....	193
2.1 SHENJAT NDRIÇUESE PËR RREGULLIMIN E TRAFIKUT TË AUTOMJETEVE.....	193

2.1.1 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT TË MJETEVE .....	195
2.1.2 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT TË DESTINUAR VETËM PËR KËMBËSORË .....	201
2.1.3 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR TË RREGULLUAR TRANSPORTIN PUBLIK .....	202
2.1.4 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT NË VENDKALIMIN HEKURUDHOR .....	202
2.1.5 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR SHËNIMIN E PUNIMEVE DHE PENGESAVE NE RRUGË .....	204
3 PAISJET E TJERA TË TRAFIKUT NË RRUGË.....	211
4 SHENJAT HORIZONTALE.....	229
4.1 SINJALIZIMI HORIZONTAL I RRUGËVE .....	229
4.2 VENDOSJA E SHENJAVE HORIZONTALE NË RRUGË DHE SHKËLQIMI I TYRE .....	230
4.3 MATERIALET .....	236
4.4 VIJAT GJATËSORE NË RRUGË DHE NDARJA E TYRE .....	237
4.4.1 NGJYRA E SHENJAVE HORIZONTALE NË RRUGË.....	239
4.5 VIJAT TËRTHORE.....	246
4.6 VIJAT E PJERRËTA DHE TË LAKUARA .....	250
4.7 VENDKALIM KËMBËSORËSH OSE BIÇIKLETASH .....	251
4.8 SHIGJETA DREJTUESE .....	254
4.9 SHKRIME DHE SIMBOLE.....	259
4.10 VIJAT KUFIZUESE PËR VENDET E PARKIMIT, VENDPARKINGJET E REZERVUARA .....	262
4.11 ISHUJT E TRAFIKUT, SHENJAT PARAPRAKE PËR PENGESAT BRENDA RRUGËS .....	263
4.12 VIJAT KUFIZUESE TË STACIONEVE TË QËNDRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK TË LINJËS .....	267
4.13 SHENJAT E PARALAJMËRIMEVE TË NDRYSHME .....	268
5 SINJALET E POLICËVE TË TRAFIKUT.....	270
5.1 SHENJAT ME ANË TË DUARVE.....	271
5.2 SHENJAT ME POZICION TË TRUPIT .....	276

5.3 SHENJAT ME FËRSHËLLIMË (BILBIL) .....	278
5.4 SHENJAT ME MJETE NDRIÇUESE.....	278
LITERATURA.....	280

## PËRMBAJTJA E FIGURAVE

Figura 1. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	15
Figura 2. Madhësia e shenjave në % .....	17
Figura 3. Lartësia e shenjave në mm dhe në % .....	18
Figura 4. Lartësia e shenjave në mm dhe në % .....	18
Figura 5. Forma drejtkëndëshe e shenjës së rrezikut .....	19
Figura 6. Vendosja e shenjave sipas madhësisë në m <sup>2</sup> .....	21
Figura 7. Mënyra e vendosjes së shenjës .....	49
Figura 8. Forma e vendosjes së shenjës flat (sheshtë) .....	71
Figura 9. Forma e vendosjes së shenjës (alkant) .....	72
Figura 10. Për shenja deri në 1.1 m <sup>2</sup> , për shenja deri në 6 m <sup>2</sup> , për shenja më të mëdha se 6 m <sup>2</sup> .....	73
Figura 11. Forma e vendosjes së shenjave alform.....	74
Figura 12. Tipi R1, teknologji me rruaza qelqi, klasa e inxhinierive (Engineer Grade EG) .....	75
Figura 13. Folia e tipit HIG dhe HIP .....	75
Figura 14. Folia e tipit DG VIP dhe DG3 .....	76
Figura 15. Vendosja e shenjës STOP .....	82
Figura 16. Mënyra e vendosjes së shenjës .....	83
Figura 17. Mënyra e vendosjes së shenjës .....	86
Figura 18. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	104
Figura 19. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	107
Figura 20. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	108
Figura 21. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	109
Figura 22. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	110
Figura 23. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	111
Figura 24. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	112
Figura 25. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	113

Figura 26. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	114
Figura 27. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	115
Figura 28. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	117
Figura 29. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	118
Figura 30. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	119
Figura 31. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	120
Figura 32. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	121
Figura 33. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	123
Figura 34. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	124
Figura 35. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	125
Figura 36. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	126
Figura 37. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	127
Figura 38. Vendosja e shenjës sipas standardit .....	130
Figura 39. Paneli plotësues i shenjave rrethore me dimensione në cm .....	131
Figura 40. Madhësia e shenjave të trafikut në mm dhe % .....	142
Figura 41. Madhësia e shenjave të trafikut në mm dhe % .....	143
Figura 42. Vendosja e shenjave të trafikut në m <sup>2</sup> .....	143
Figura 43. Ndryshim vertikal, duke filluar nga vetëm një qendër e vëmendjes .....	148
Figura 44. Mënyra e vendosjes së shenjës së vendkalimit të këmbësorëve me ndryshim.....	149
Figura 45. Forma katrore e vendosur vertikalisht në cm .....	151
Figura 46. Dimensionet e shenjës katror në cm .....	157
Figura 47. Shenja e formës drejtkëndëshe në cm .....	163
Figura 48. Shenja e formës katërkëndëshe .....	164
Figura 49. Vendosja e shenjës plotësuese sipas standardit, kodit E01 .....	178
Figura 50. Vendosja e shenjës plotësuese sipas standardit, kodit E02 .....	179
Figura 51 .....	196
Figura 52.....	196
Figura 53.....	197
Figura 54.....	197
Figura 55.....	198

Figura 56.....	198
Figura 57.....	199
Figura 58.....	199
Figura 59.....	200
Figura 60.....	200
Figura 61.....	201
Figura 62.....	201
Figura 63.....	202
Figura 64.....	203
Figura 65.....	203
Figura 66.....	204
Figura 67. Treguesit e kaheve dhe dimensionet në mm.....	213
Figura 68. Mënyra e vendosjes së shenjës .....	218
Figura 69. Retrorefleksioni gjatë natës dhe ditës .....	230
Figura 70. Retrorefleksionit gjatë kohës me shi me thyerje të dritës gjatë të reshurave.....	231
Figura 71. Retrorefleksioni në kushtet me lagështi dhe reflektimi i dritës te ngasësi .....	232
Figura 72. Pika, linja sistematike, kaotike (vrazhda).....	233
Figura 73. Pajisje për matjen e retrorefleksionit .....	235
Figura 74. Matësi i trashësisë së ngjyrës Figura 75. Matësi i rezistencës së fërkimit .....	238
Figura 76. Dimensionet e vendosjes së shenjave horizontale në afërsi të kryqëzimit .....	248
Figura 77. Dimensionet e shigjetave orientuese të gjatësisë 5 m.....	256
Figura 78. Dimensionet e shigjetave orientuese të gjatësisë 7 m.....	256
Figura 79. Dimensionet e shigjetave orientuese për dy kryqëzime të afërta të gjatësisë 5 m dhe 7 m .....	257
Figura 80. Dimensionet e shigjetës kthim në trafik dhe kahja e lëvizjes për në garazhe.....	257
Figura 81. Dimensionet e fushave për orientim .....	265
Figura 82. Rregullat e prioriteteve të sinjalizimit.....	270
Figura 83. Pozicioni i policit në kryqëzim.....	271



Figura 84. Kalim i lirë	Figura 85. Ndalim kalimi	272
Figura 86. Kahet e ndalimit dhe lejimit të kalimit, pozicioni i policit në kryqëzim		273
Figura 87. Ndalim kalimi për të gjithë pjesëmarrësit në trafik		274
Figura 88. Krahasimi i shenjave të policit me semafor		274
Figura 89. Ndalim kalimi për pjesëmarrësit të cilët presin drejtimin e dorës, si dhe pozicionin e policit brenda kryqëzimit		275
Figura 90. Lëvizja e dorës lart-poshtë, poshtë-lart		276
Figura 91. Lëvizja e dorës në mënyrë rrethore		277
Figura 92. Ndalim kalimi për mjetin që i është drejtuar polici		277

## PËRMBAJTJA E TABELAVE

Tabela 1. Gjatësitë e brinjëve të trekëndëshit barabrinjës të shenjave të rrezikut janë	16
Tabela 2. Madhësia e shenjave të trafikut	16
Tabela 3. Dimensionet sipas rangut të rrugës	78
Tabela 4. Dimensionet e shenjave	78
Tabela 5. Dimensionet e shenjave në formë rrethi	79
Tabela 6. Madhësia e shenjave të trafikut	141
Tabela 7. Diametri i rrethit të shenjave të lajmërimit është	145
Tabela 8. Madhësia e brinjës së katrorit të shenjës së lajmërimit është	145
Tabela 9. Madhësia e brinjës së katërkëndëshit të shenjave të lajmërimit është	146
Tabela 10. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	147
Tabela 11. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	168
Tabela 12. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	168
Tabela 13. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	169
Tabela 14. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	169
Tabela 15. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	169
Tabela 16. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	170
Tabela 17. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	170
Tabela 18. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform	170

Tabela 19. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform.....	171
Tabela 20. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform.....	171
Tabela 21. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform .....	172
Tabela 22. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform .....	173
Tabela 23. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform .....	174
Tabela 24. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform .....	175
Tabela 25. Retrorefleksioni i shenjave sipas standardeve evropiane EN 1436.....	234
Tabela 26. Intensiteti i retrorefleksionit gjatë ditës (QD) në gjendje të thatë .....	234
Tabela 27. Intensiteti i retrorefleksionit gjatë natës (RL) në gjendje të lagësht .....	235
Tabela 28. Gjerësia e vijave sipas rangut të rrugës .....	239
Tabela 29. Format e vijave dhe llojet e tyre.....	240
Tabela 30. Gjatësia e dukshmërisë sipas shpejtësisë në km/h.....	245
Tabela 31. Shkrimet dhe simbolet në rrugë .....	259
Tabela 32. Vendparkimet dhe format e tyre .....	262
Tabela 33. Ishujt e trafikut për orientim .....	263
Tabela 34. Dimensionet e gungave varësisht nga shpejtësia .....	266
Tabela 35. Gungat artificiale.....	266

## HYRJE

Që në kohët e lashta kanë ekzistuar simbole të ndryshme, vizatime në shpella, në shkëmbinj të ndryshëm, të cilat i kanë informuar njerëzit për vendin në të cilin ndodhen në përgjithësi si, p. sh., për rreziqet, për vendin ku ndodhet ushqimi, për vendin e kafshëve të egra, për llojin e kafshës që është në atë zonë etj. Por, me zhvillimin e njerëzve edhe shenjat kanë ndryshuar si për nga forma, si për nga dukja, duke i informuar pjesëmarrësit në trafik për rrezikun, të drejtën, ndalesën, drejtimin, vendin ku ndodhen etj. Prandaj, dita-ditës ka lindur nevoja për rregulloret e rrugëve dhe sinjalet që i njohim ne sot, të cilat filluan në fillim të shekullit 20, me zhvillimin e automjeteve të para të cilat i kaluan kufijtë e shpejtësisë.

Konventa e parë ndërkombëtare për rrugët dhe trafikun e automjeteve u mbajt në Paris në vitin 1909, nga e cila dolën format e para të shenjave, (trekëndëshi si shenjë paralajmëruese, rrethi si shenjë rregulluese, drejtkëndëshi si shenjë udhëzuese) të cilat u përcaktuan në atë konventë. Ndërsa ngjyra e shenjave të trafikut është mjaft interesante. Në të gjitha shenjat e trafikut mbizotëron ngjyra e kuqe, e cila paralajmëron rrezikun. Po nga kjo rrjedhë edhe sinjali i kuq i semaforit i cili tregon për ndalim të qarkullimit të automjeteve apo këmbësorëve.

Marrëveshja e parë dhe më e rëndësishmja mbi shenjat e trafikut rrugor nga e cila është baza e sistemit evropian për shenjat e trafikut është botuar nën përkujdesjen e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë në vitin 1949. Nga ky dokument rrjedhë baza e përdorimit të simboleve në shenja duke mos përdorur fjalë apo shkrim brenda shenjës.

Më pas, në vitin 1968, në Vjenë u mbajt Konventa mbi Shenjat dhe Sinjalet Rrugore, e quajtur Konventa e Vjenës, e që ishte një traktat

shumëpalësh për të ndihmuar në rritjen e sigurisë në rrugë si dhe standardizimin e shenjave vertikale, shenjave horizontale dhe sinjalizimin ndriçues. Në këtë konventë u vendos që të gjitha shenjat, me përjashtim të atyre që nuk aplikohen gjatë natës, duhet të jenë me refleksion për t'u parë nga distanca. Po në këtë konventë u vendos edhe për shenjat horizontale të cilat mund të jenë të bardha apo të verdha.

Sinjalizimi që njohim ne sot për trafikun rrugor (duke përjashtuar sinjalizimin brenda objekteve, përveç parkimeve në garazh), ndahet në sinjalizim vertikal, horizontal dhe ndriçues. Pra, sinjalizimi mund të definohet si përmbledhje e shenjave të cilat u dedikohen pjesëmarrësve në trafik. Qëllimi kryesor i shenjave është informimi i pjesëmarrësve në trafik për rrezikun, kufizimin, udhëzimin, duke u bazuar në informatën që jep shenja apo sinjali.

Në materialin e paraqitur janë përfshirë shenjat e trafikut rrugor, si: shenjat vertikale, horizontale dhe sinjalet ndriçuese, duke u bazuar në ligjin e Republikës së Kosovës. Në këtë material janë shpjeguar në mënyrë më të zgjeruar forma, madhësia, ngjyrat, simboli si dhe disa nga mënyrat e vendosjes së shenjës në praktikë. Pozicioni i vendosjes së shenjave vertikale, horizontale dhe ndriçuese dhe harmonizimi i tyre mes vete është një faktor shumë i rëndësishëm për minimizimin e konfuzionit dhe pasigurisë tek pjesëmarrësit në trafik.

## NDARJA E SINJALIZIMIT RRUGOR

Ndarja e sinjalizimit rrugor behet ne:

- ✚ SHENJAT VERTIKALE
- ✚ SHENJAT E NDRITSHME
- ✚ SHENJAT HORIZONTALE
- ✚ SINJALIZIMET E POLICIT TË TRAFIKUT

Shenjat vertikale ndahen në këto kategori dhe kanë përparësi ndaj shenjave horizontale:

### 1 SHENJAT VERTIKALE

- ✚ Shenjat e rrezikut
- ✚ Shenjat urdhëruese
- ✚ Shenjat e tjera dhe panelet plotësuese
- ✚ Shenjat e përkohshme
- ✚ Shenjat treguese dhe të informimit

Shenjat vertikale janë shenja të ndërtuara prej formave dhe tabelave të ndryshme të cilat kanë simbole, konture dhe sfonde të ndryshme të cilat vendosen në mënyrë vertikale në skajin e rrugës ose mbi të, në atë mënyrë që syri i njeriut t'i shohë qartë.

## 1.1 SHENJAT E RREZIKUT


Sinjalet e rrezikut kanë formën e trekëndëshit barabrinjës, ku dy brinjë të trekëndëshit janë të shtrirë në një brinjë horizontale e që në anën e epërme takohen në një kulm. Sinjalet e rrezikut apo sinjalet paralajmëruese kanë formën e trekëndëshit dhe e kanë kornizën me ngjyrë të kuqe, ndërsa sfondi është me ngjyrë të bardhë si dhe mbishkrimi dhe simboli me ngjyrë të zezë që e paralajmërojnë një rrezik të mundshëm nga 50 m deri në 250 m (metra) përpara rrugës që jemi duke drejtuar mjetin, mirëpo kjo varet edhe nga lloji dhe kategoria e rrugës, ose sipas distancës që është e shënuar në tabelën plotësuese sinjalizuese dhe i detyron ngasësit e mjeteve ta mbajnë një qëndrim të kujdesshëm. Ngjyrat e shenjave duhet të jenë në përputhshmëri me standardet evropiane.

Në vazhdim do t'i pasqyrojmë disa sinjale të rrezikut, siç mund t'i quajmë ndryshe, sinjale paralajmëruese të rrezikut. Këto sinjale do t'i shtjellojmë në përputhje të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2011 për vendosjen, ngjyrën, formën si dhe dimensionet e tyre në përputhje të këtij Udhëzimi i cili vlen për tërë Republikën e Kosovës.

Në vijim do t'i shtjellojmë disa shenja apo sinjale të rrezikut të cilat i hasim çdo ditë kur jemi duke lëvizur me këmbë apo me veturë. Njëherësh do ta tregojmë llojin, kuptimin, formën, ngjyrën, dimensionin e shenjave, të sinjalizimeve dhe të pajisjeve në trafikun rrugor.

Ngjyrat bazë të të gjitha shenjave të rrezikut në përputhje me standardet evropiane janë:


- Fusha e bardhë apo (sfondi i bardhë)
- Konturi i kuq apo (korniza e kuqe)
- Simboli i zi







ALFORM (unaza)




Kodi A32



ALKANT (unaza)



ALFORM (unaza)



Tubi



Figura 1. Vendosija e shenjës sipas standardit

Tabela 1. Gjatësitë e brinjëve të trekëndëshit barabrinjës të shenjave të rrezikut janë



LLOJ I RRUGËS	Gjerësia e rrugës	Madhësia e shenjës	Largësia e vendosjes së shenjave të rrezikut	Largësia e vendosjes së shenjave treguese
Në autostradë dhe rrugë kryesore jashtë vendbanimeve	Mbi 7 metra	120 cm	150 m (metra)	250 m (metra)
Në rrugët dytësore jashtë vendbanimit	Prej 5-7 Metra	90 cm	100 m (metra)	150 m (metra)
Për rrugët e tjera	Deri ne 5 metra	60 cm	50 m (metra)	80 m (metra)
Për tunele dhe galeri	-	60 cm	-	-
Vendosja në një shenjë tjetër	-	40 cm	-	-

Tabela 2. Madhësia e shenjave të trafikut

		Madhësia 1 (70 %)	Madhësia 2 (100 %)	Madhësia 3 (125 % deri 140 %)
Disqet	Ø	420	600	750 (125 %)
Trekëndëshat	SL	630	900	1260 (140 %)
Katrori	SL	420	600	840 (140 %)
Drejtëndësh	H x B	630 x 420	900 x 600	1260 x 840 (140 %)
Të gjitha shifrat në	mm	mm	mm	mm



- Madhësia 1 - 70 %**
- 420 Ø
  - 630 SL
  - 420 x 420 mm
  - 231 x 420 mm
  - 315 x 420 mm
  - 420 x 420 mm
  - 500 x 500 mm
  - 750 x 500 mm



- Madhësia 1 - 100 %**
- 420 Ø
  - 630 SL
  - 420 x 420 mm
  - 231 x 420 mm
  - 315 x 420 mm
  - 420 x 420 mm
  - 500 x 500 mm
  - 750 x 500 mm






Figura 2. Madhësia e shenjave në %




Figura 3. Lartësia e shenjave në mm dhe në %




Figura 4. Lartësia e shenjave në mm dhe në %




Figura 5. Forma drejtkëndëshe e shenjës së rrezikut

Shenjat e rrezikut jashtë vendbanimeve vendosen në largësi prej 150 m deri 250 m para vendit në të cilin është rreziku në rrugë. Por, shenjat e rrezikut mund të vendosen edhe në largësi më të vogël se 150 m para vendit të rrezikut në rrugë, e kjo bëhet vetëm nëse këtë e kërkojnë rrethanat e pjesës së rrugës në të cilën vendoset shenja. Për arsye të shpejtësisë së mjeteve apo edhe të dukshmërisë së zvogëluar të rrugës, shenjat e rrezikut mund të vendosen edhe në një distancë më të madhe se 250 metra para vendit ku ndodhet rreziku në rrugë. Mirëpo ato shenja të rrezikut të cilat janë të vendosura në largësi më të vogël se 150 metra apo më të madhe se 250 metra duhet ta kenë tabelën plotësuese në të cilën shënohet distanca e vendit të rrezikut nga shenja e trafikut. Ndërsa në ato rrugë në të cilat fusha e dukshmërisë është zvogëluar apo në rrugët ku shpejtësia është e madhe si

dhe në rastet kur ka rrezik që shoferët mund të hasin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të papërgatitur në vendin e rrezikut në rrugë, atëherë në mes të shenjës së rrezikut të vendosur në largësinë e caktuar të atij vendi të rrezikut në rrugë, vendoset tabela plotësuese, në të cilën parashihet distanca deri te vendi i rrezikut.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Ndarja e sinjalizimit rrugor, në veçanti atij vertikal
- Shenjat e rrezikut, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut.

Pyetjet:

1. Forma e shenjave të rrezikut
2. Tregoni ndarjen e sinjalizimit rrugor
3. Ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut
4. Tregoni dimensionet sipas kategorisë së rrugës për shenjat e rrezikut
5. Tregoni ndarjen e sinjalizimit vertikal






Kodi A01



Kodi A 25


**A01 - Shenja e rrezikut** - Kjo shenjë tregon afërsinë e rrugës apo, më mirë të themi, pjesën e rrugës në të cilën pjesëmarrësve u kanoset rreziku. Kësaj shenje duhet t'i vendoset edhe tabela plotësuese e cila tregon rrezikun i cili u kanoset drejtuesve të mjeteve. Kjo shenjë duhet të punohet nga materiali retroreflektues. Kur shenja (A25) vendoset për shënimin e punimeve në rrugë, pengesa si dhe në rrugët e dëmtuara, ngjyra bazë është e verdhë. Kjo shenjë vendoset përkohësisht në rrugë.

Për shenja deri në 1.1 m<sup>2</sup>Për shenja deri në 6 m<sup>2</sup>Për shenja më të mëdha se 6 m<sup>2</sup>Figura 6. Vendosja e shenjave sipas madhësisë në m<sup>2</sup>

Shembujt e vendosjes së tabelave plotësuese do t'i sqarojmë në vijim.




Kodi A01 me E33




Kodi A01 me E14




Kodi A01 me E39



Kodi A01 me E19



Kodi A01 me E34



Kodi A01 me E40




Kodi A02

**A02 - Shenja e rrezikut** - Kjo shenjë tregon afërsinë e rrugës me kryqëzim të rrugëve me rëndësi të njëjtë, prej të cilave asnjëra nga to nuk janë rrugë me përparësi kalimi. Vendosija e kësaj shenje bëhet në rrugët jashtë vendbanimeve. Kjo vendoset në ato vende ku takohen dy rrugë me njëra-tjetrën. Dhe, sipas kodit rrugor, kjo shenjë e paralajmëron vendin në të cilin hyjnë në fuqi rregullat e përgjithshme të përparësisë së krahut të djathtë.

Kur afrohemi te ky kryqëzim i rrugëve me rëndësi të njëjtë, nuk ka rregulla të caktuara të trafikut, por vlen rregulli i përgjithshëm i krahut të djathtë dhe duhen marrë këto veprime:

- Të kyçet treguesi i drejtimit për ta treguar drejtimin e lëvizjes;
- Automjeti të ndalet dy metra para vendkalimit të shënuar për këmbësorë;
- T'u jepet përparësi kalimi këmbësorëve;
- T'u mundësohet kalim i lirë mjeteve të cilat kanë arritur përpara në kryqëzim;
- T'u jepet përparësi kalimi mjeteve që lëvizin nga krahu i djathtë.



Kodi A03

**A03 - Shenja e rrezikut** - Kjo shenjë tregon kryqëzimin e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e drejtë, kryqëzimin me të drejtë përparësi kalimi. Bën paralajmërimin e kryqëzimit të rrugës me përparësi kalimi nën këndin e drejtë  $90^0$ . Edhe pse qëndrojmë duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi, duhet pasur kujdes nga ndonjë mjet nga rruga dytësore.

Kur jemi duke lëvizur në drejtim të kryqëzimit me përparësi kalimi, duhet të kemi kujdes të shtuar dhe të bëhet zvogëlimi i shpejtësisë së lëvizjes dhe të sigurohemi që mjetet me të cilat jemi duke u kryqëzuar na japin përparësi kalimi. Ndërsa ngasësit e mjetit motorik të cilët janë duke lëvizur në rrugën dytësore duhet t'i kryejnë këto veprime:

- Ta bëjnë zvogëlimin e shpejtësisë së lëvizjes;
- U ndalohet të qëndrojnë në pjesën në të cilën kthehet;
- U ndalohet të qëndrojnë brenda kryqëzimit;
- U ndalohet të parakalojë.





Kodi A04



Kodi A05

**A04 dhe A05 - Shenja të rrezikut** - Këto shenja tregojnë kryqëzimin e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e drejtë nga ana e majtë, përkatësisht e djathtë. Këto kryqëzime mund t'i quajmë ndryshe si kryqëzime të formës "T". Kjo shenjë bën paralajmërimin e kryqëzimit të rrugës me përparësi kalimi nën këndin e drejtë 90°. Edhe pse qëndrojmë duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi, duhet pasur kujdes nga kyçja e ndonjë mjeti nga rrugët dytësore, si nga ana e djathtë ashtu edhe nga ana e majtë. Gjithashtu, te këto dy shenja, si te A04 ashtu edhe te shenja A05, duhet të kemi kujdes si te shenja A03. Këto shenja të rrezikut, sipas rregullave, vendosen në një distancë rreth 150 m nga pika e fillimit të rrezikut që është paralajmëruar.

Edhe te këto shenja të rrezikut duhet të kemi kujdes të shtuar dhe të bëhet zvogëlimi i shpejtësisë së lëvizjes dhe të sigurohemi që mjetet me të cilat jemi duke u kryqëzuar na japin përparësi kalimi. Në rrugët urbane ku shpejtësia maksimale e lejuar është më e vogël se 40 km/orë, atëherë distanca mund të zvogëlohet sipas kushteve të vendit. Ndërsa ngasësit e mjetit motorik, të cilët janë duke lëvizur në rrugën dytësore, duhet t'i kryejnë këto veprime.

- Ta zvogëlojnë shpejtësinë e lëvizjes;
- U ndalohet të qëndrojnë në pjesën në të cilën kthehen;
- U ndalohet të qëndrojnë brenda kryqëzimit;
- U ndalohet të parakalojnë.



Kodi A06



Kodi A07

### **A06 dhe A07 - Shenja të rrezikut** - Këto

shenja tregojnë kryqëzimin e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e ngushtë nga ana e majtë, përkatësisht ana e djathtë.

Paralajmërojnë kryqëzimin e rrugës me përparësi kalimi nën këndin e ngushtë. Edhe pse qëndrojmë duke lëvizur në rrugën me përparësi kalimi, duhet pasur kujdes nga kyçja e ndonjë mjeti nga rrugët dytësore si nga ana e djathtë, po ashtu edhe nga ana e majtë. Gjithashtu, te këto dy shenja, si te shenjat A04, A05, ashtu edhe te shenjat A06 dhe A07, duhet të kemi kujdes. Këto shenja të rrezikut, sipas rregullave, vendosen në distancë rreth 150 m nga pika e fillimit të rrezikut që

Këto shenja paralajmërojnë kyçje të mjeteve nga ana e djathtë apo e majtë nëpërmjet një rruge të përshpejtimit. Shenjat si këto mund të vendosen vetëm nëse në rrugën dytësore, e cila kryqëzohet me rrugën me përparësi kalimi para kryqëzimit, vendoset shenja kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi ose shenja ndalje e detyruar - STOP. Ndërsa ngasësit e mjetit motorik të cilët janë duke lëvizur në rrugën dytësore duhet t'i kryejnë këto veprime:

- Ta zvogëlojnë shpejtësinë e lëvizjes;
- Të mos bëjnë parakalim në afërsi të këtyre kyçjeve dytësore;
- Të bëjnë lëvizje defensive (mbrojtëse) që ta evitojnë aksidentin me mjetet e tjera;
- U ndalohet të qëndrojnë në pjesën në të cilën kthehen;
- U ndalohet të qëndrojnë brenda kryqëzimit.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave me kode A01, A02, A03, A04, A05, A06, A07;
- Shenjat e rrezikut, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut.

Pyetjet:

6. Forma e shenjave të rrezikut nën këndin e drejtë
7. Forma e shenjave të rrezikut nën këndin e ngushtë
8. Ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut nën këndin e drejtë dhe të ngushtë
9. Tregoni kryqëzimin e rrugës dytësore me rrugën kryesore nën këndin e drejtë
10. Tregoni shenjat e rrezikut A01 dhe A02




Kodi A08



Kodi A09

**A08 dhe A09 - Shenja të rrezikut** - Këto shenja tregojnë kthesën e rrezikshme nga ana e majtë, përkatësisht ana e djathtë e rrugës, për arsye të karakteristikave të saj. Këto shenja paralajmërojnë kthesën e rrezikshme të rrugës të cilat e kanë fushën e dukshmërisë së kufizuar. Po te këto shenja mund të vendosen edhe tabela (pane) plotësuese që mund ta tregojnë distancën prej shenjës së vendosur në rrugë deri te kthesat e rrezikshme. Gjithashtu, në këto kthesa të rrezikshme me dy korsi dhe dy kahe të lëvizjes ndalohet qëndrimi dhe parakalimi i mjeteve.

Siç e cekëm edhe më lart, këto kthesa janë të rrezikshme, ose rruga nuk e ka fushën e dukshmërisë së mjaftueshme, prandaj simboli në shenja është i ndryshëm, varësisht nga situata reale në pjesën e kësaj rruge.



Te këto kthesa duhet:

- Të bëhet rregullimi i shpejtësisë së lëvizjes në varësi të rrezes së kthesës;
- Të mos lëvizet prapa me mjet;
- Të mos bëhet ndalja apo pushimi me mjet;
- Të mos kthehet në anën e kundërt të kahut të lëvizjes;
- Të kihet kujdes nga lagështia në rrugë si dhe gjendja e pneumatikëve.



Kodi A10




Kodi A11

**A10 dhe A11 - Shenja të rrezikut** - Këto shenja tregojnë kthesën e rrezikshme të dyfishtë, ku kthesa e parë është nga ana e majtë, ndërsa e dytë nga ana e djathtë, përkatësisht A11 është kthesë e rrezikshme e dyfishtë, ku kthesa e parë është nga ana e djathtë, pastaj kthesa e dytë nga ana e majtë e rrugës. Këto shenja paralajmërojnë edhe një sërë kthesash të njëpasnjëshme të rrezikshme të rrugës të cilat e kanë edhe fushën e dukshmërisë së kufizuar. Po ashtu, te këto shenja mund të vendosen edhe tabela (panele) plotësuese që mund ta tregojnë numrin e kthesave të njëpasnjëshme.

Poshtë kësaj shenje mund të vendosen tabela (panele) plotësuese të cilat tregojnë distancën prej shenjës deri te pika ku fillon rreziku, si dhe gjatësinë e pjesës së rrugës në kthesa të rrezikshme.

Pas këtyre shenjave vendoset tabela plotësuese me numrin e kthesave të njëpasnjëshme. Kufizimet te këto shenja të rrezikut janë sikurse te shenjat A08 dhe A09. Edhe te këto vendosen tabela plotësuese të cilat mund t'i ilustrojmë edhe me shembuj.



Kodi A10 me E04

Kodi A11 me E03

Të këto kthesa duhet:

- Të bëhet rregullimi i shpejtësisë së lëvizjes në varësi të rrezes së kthesës;
- Të mos lëvizet prapa me mjet;
- Të mos bëhet ndalja apo pushimi me mjet;
- Të mos kthehet në anën e kundërt të kahut të lëvizjes;
- Të kihet kujdes nga lagështia në rrugë;
- Të jeni të vetëdijshëm për gjendjen e pneumatikëve (gomave) të mjetit.



Kodi A12

**A12 - Shenja e rrezikut** - Kjo shenjë tregon teposhtën e rrezikshme. Paralajmërohet se pjesa e kësaj rruge është me një pjerrtësi anësore të rrezikshme prej 10 %. Në këto raste duhet të bëhet ngadalësimi i shpejtësisë dhe të kemi kujdes të shtuar si dhe vlerësim të drejtë të situatave të cilat mund të krijohen, ndërsa frenimi i automjetit duhet të bëhet në mënyrë të koordinuar me motorin dhe frenat e mjetit që drejtoni.

Te këto pjesë të rrugës ndalohet ndalja dhe qëndrimi në vend i mjetit si dhe fikja e automjetit apo të mbahet i shtypur freksioni i mjetit dhe të përdoren sa më pak frenat për arsye se mund të mbinxehen elementët frenues. Rekomandohet që ta rrisim distancën e sigurisë nga mjeteve që lëvizin para nesh. Po këta ngasës në të njëjtën kohë janë të detyruar ta mbajnë anën e lëvizjes që t'ua mundësojnë kalimin e lirë edhe mjeteve që vijnë nga kahu i kundërt i lëvizjes.





Kodi A13

**A13 - Shenja e rrezikut** - Kjo shenjë tregon përpjetën e rrezikshme. Paralajmërohet se pjesa e kësaj rruge është me ngritje me pjerrtësi të rrezikshme prej 12 %. Në këto raste kur kemi të bëjmë me lëvizje përpjetë, ngasësi i mjetit duhet ta bëjë zgjedhjen e shpejtësisë me të cilën mund ta bëjë kalimin e asaj pjese të rrugës në përpjetën, pa bërë ndërrimin e shpejtësisë dhe pa e ndaluar automjetin.

Të kemi kujdes të shtuar si dhe vlerësim të drejtë të situatave të cilat mund të krijohen. Në të përpjetat të cilat kanë një pjerrtësi më të ashpër se 12 % duhet të bëhet shtimi i gazit. Ngasësit në këto pjesë të rrugës i ndalohet të qëndrojnë kur rruga është e dëmtuar dhe të ngasë me shpejtësi të madhe si dhe ta bëjë ndërrimin e shpejtësisë pasi të hyjë në pjesën me pjerrtësi. Te këto shenja mund të vendosen edhe tabelat plotësuese të cilat na tregojnë se në këtë pjesë të rrugës mund të hasim në pengesa të ndryshme, për shembull, kamionë të cilët lëvizin ngadalë.

Te këto përpjeta duhet:

- Ta shmangim manovrimin me automjet;
- Ta rrisim distancën e sigurisë nga mjetet e rënda;
- Të bëjmë lëvizje me shpejtësi të vogël në mënyrë që ta shfrytëzojmë mirë fuqinë e motorit.



Kodi A14

**A14 - Shenja e rrezikut: ngushtim rruge nga ana e majtë dhe e djathtë** - Vendosija e

kësaj shenje tregon ngushtimin nga të dyja anët e rrugës dhe na tregon rrezikshmërinë e kësaj pjese të rrugës ku mund të përplasemi me mjete të cilat mund të vijnë nga ana e kundërt e lëvizjes.

Pas kësaj shenje mund të vendosen shenjat B38 të përparësisë së kalimit, siç janë: përparësia e lëvizjes së mjeteve që vijnë nga kahja e kundërt e lëvizjes apo shenja C01 e përparësisë së lëvizjes, pavarësisht prej mjeteve që vijnë nga ana e kundërt e lëvizjes. Tani ilustruam edhe me shembuj vendosjen e këtyre shenjave pas shenjës ngushtim rruge në të dyja anët si nga ana e majtë, po ashtu edhe nga ana e djathtë e rrugës.



B38



C01

Në afërsi të shenjës ngushtim rruge nga të dyja anët ngasësi është i detyruar:

- Ta ulë shpejtësinë e lëvizjes;
- T'i evitojë situatat e rrezikshme;
- Ta mbajë drejtimin e lëvizjes.

Ndërsa ngasësit të mjetit motorik i ndalohet:

- Ta bëjë parakalimin e mjeteve;
- Ta ndërrojë krosin e lëvizjes;
- Të qëndrojë në pjesën e ngushtë të rrugës.

Nëse kjo shenjë vendoset në rast të punimeve në rrugë, e cila mund të vendoset si te rrugët me një drejtim të lëvizjes, ashtu edhe te rrugët me dy drejtime të lëvizjes, ka sfond të verdhë, korniza është e kuqe dhe simbol të zi.

**A15 - Shenja e rrezikut: ngushtim rruge nga ana e djathtë** - Vendosja e kësaj shenje tregon ngushtimin e rrugës nga ana e djathtë dhe na tregon rrezikshmërinë e kësaj pjese të rrugës ku mund të përplasemi me mjete të cilat mund të vijnë nga ana e kundërt e lëvizjes.



Kodi A15

Te kjo shenjë mund të vendosim edhe tabela plotësuese të cilat na bëjnë me dije për pjesën në vazhdim të rrugës. Në rastet e vendosjes së kësaj shenje kur kemi punime në rrugë, kjo shenjë ka sfondin me ngjyrë të verdhë.

Në afërsi të kësaj shenje duhet:

- Të ulet shpejtësia e lëvizjes
- Të kihet kujdes për përcjelljen e shenjave në vazhdim të rrugës.

**A16 - Shenja e rrezikut: ngushtim rruge**

**nga ana e majtë** - Vendosija e kësaj shenje tregon ngushtimin e rrugës nga ana e majtë dhe na tregon rrezikshmërinë e kësaj pjese të rrugës ku mund të përplasemi me mjete të cilat mund të vijnë nga ana e kundërt e lëvizies.



Kodi A16

Edhe te kjo shenjë vlejnjë rregullat sikurse te shenja A15.

**A17 - Shenja e rrezikut të rrugës me gunga**

- Kjo shenjë paralajmëron se një pjesë e rrugës është konvekse (me gunga) dhe rrezikshmëria në këtë pjesë të rrugës na kufizon edhe fushën e dukshmërisë. Në këtë pjesë të rrugës nuk lejohet parakalimi nëse rruga është me kahe të ndryshme të lëvizjes.



Kodi A17

Në pjesën e kësaj rruge nuk lejohet:

- Të ndalesh me automjet;
- Të qëndrosh me automjet;
- Të parakalosh me automjet në rast të rrugës me dy kahe me lëvizje të kundërta;
- Të bësh lëvizje të mjetit prapa;
- Të ktheheni në gjysmërreth.

Te rrugët me dy kahe, por me një drejtim të lëvizjes, lejohet tejkalimi i mjeteve në rast se nuk është ndaluar me ndonjë shenjë tjetër të trafikut.

### **A18 - Shenja e rrezikut të rrugës së deformuar**

Paralajmëron pjesën e rrugës e cila ka sipërfaqen e rrugës së deformuar, pra se shtresa e asfaltit është e dëmtuar apo ka ndodhur rrëshqitja e një pjese të asfaltit si dhe mënyra jo e duhur e shtrimit të asfaltit.



Kodi A18

Në këtë shenjë mund të vendosen edhe tabela plotësuese të cilat na japin informacione shtesë për pjesën tjetër të rrugës.

Ndërsa ngasësi nuk lejohet:

- Të qëndrojnë apo të kthehet prapa;
- Nëse rruga është në një kah të lëvizjes nuk lejohet tejkalimi kur fusha e dukshmërisë s'është e mjaftueshme.

Ndërsa në pjesën e kësaj rruge ngasësi duhet ta:

- Ulë shpejtësinë e lëvizjes;
- Ta mbajë timonin e mjetit me të dyja duart;
- Të lëvizet me kujdes në rast se rruga është me lagështi;
- Të manovrohet me automjetin në rast se nuk rrezikohen pjesëmarrësit e tjerë në trafik për t'i evituar deformimet e mëdha në rrugë.

**A19 - Shenja e rrezikut të rrugës me gropa**

**(lugët)** - Paralajmëron pjesën e rrugës e cila ka sipërfaqen e konkave (gropë) të rrugës së deformuar apo siç i quajmë ndryshe, lugje në rrugë. Pra, na tregon se shtresa e asfaltit është e dëmtuar apo ka ndodhur rrëshqitja e një pjese të asfaltit si dhe mënyra jo e drejtë e punimit të bazës së rrugës.



Kodi A19

Në këto pjesë të rrugës, kur kemi të bëjmë me reshje atmosferike, duhet të kemi kujdes për arsye se këto gropa, siç i quajmë ndryshe lugje, mund të mos i vërejmë sepse janë të mbushura me ujë dhe gjatë lëvizjes me automjet mund të hasim në to dhe ekziston mundësia edhe e humbjes së drejtimit dhe rrezikimit të pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, andaj duhet ta:

- Zvogëlojmë shpejtësinë e lëvizjes për arsye se mund të vijë deri te humbja e kontrollit të automjetit;
- Ta mbajmë timonin me të dyja duart;
- Të tregojmë kujdes të shtuar kur jemi duke tejkaluar apo parakaluar;
- Të bëjmë lëvizje me marsh të ingranuar;
- Të lëvizim me kujdes të shtuar nëse kemi të ngjitur në automjet rimorkio, për arsye se automjeti mund të s'postohet më lehtë.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave me kode A08 - A19;
- Shenjat e rrezikut, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut.

Pyetjet:

11. Forma e shenjave të rrezikut nga A08-A19
12. Ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut nga A08-A19
13. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode A08-A19
14. Tregoni shenjat e rrezikut nga A08 deri A19.

**A20 - Shenja e rrezikut të rrugës së rrëshqitshme** - Paralajmëron pjesën e rrugës e cila ka sipërfaqe të rrëshqitshme dhe se mund të vijë deri te rrëshqitja e automjetit. Kujdes të shtuar duhet të kemi sidomos kur kemi të bëjmë edhe me reshje të shiut sepse shiu bashkohet me pluhurin dhe nga ky kombinim formohet një lëndë rrëshqitëse në rrugë.



Kodi A 20

Si në shenjat e tjera të trafikut që vendosen tabelat plotësuese, edhe te kjo shenjë mund të vendosim një të tillë, e cila na paralajmëron për rrezikun e mundur që mund të hasim në rrugë. Në pjesën e kësaj sipërfaqeje duhet të kemi parasysh se në rast të frenimit të automjetit, rruga e frenimit rritet, ndërsa koeficienti i puthitjes së pneumatikut me asfaltin zvogëlohet.

Në këtë pjesë të rrugës ngasësi i automjetit duhet ta:

- Evitohet frenimin e vullshëm me automjet;
- Rrisë distancën e sigurisë ndërmjet mjeteve në lëvizje;
- Bëjë evitimin e frenimit dhe të shpejtimit të automjetit;
- Ulë shpejtësinë e lëvizjes;
- Mos bëjë manovrime të shpejta me timonin e automjetit.



**A21 - Shenja e rrezikut përplasje gurësh** - Kjo shenjë na tregon se në pjesën e rrugës ka material të paqëndrueshëm në rrugë siç janë çaklli, rëra, zhavorri, zalli etj. Këto materiale bëjnë që koeficienti i puthitjes së pneumatikut me asfaltin të mos jetë në parametrat e duhur dhe, si pasojë e kësaj, vjen deri te përplasia. Këto përplasje gurësh janë shumë të rrezikshme për pjesëmarrësit në trafik.



Kodi A 21

Në pjesën e kësaj rruge ngasësit e automjeteve duhet:

- Ta ulin shpejtësinë e lëvizjes;
- Të lëvizin me kujdes të shtuar;
- Të mos bëjnë manovrime të panevojshme me automjet;
- Ta rrisin distancën e sigurisë ndërmjet automjeteve në lëvizje.

Edhe te këto shenja mund t'i vendosim tabelat plotësuese që mund të na informojnë për pjesën tjetër të rreziqeve që mund t'i hasim në rrugë.

**A22 - Shenja e rrezikut rënie gurësh nga ana e djathtë** - Kjo shenjë tregon për rrezikun e shembjes së gurëve nga ana e djathtë e rrugës, andaj te kjo shenjë duhet të vendoset tabela plotësuese që na tregon edhe gjatësinë e kësaj pjese të rrugës ku ka shembje gurësh. Kjo, po ashtu, paralajmëron edhe shembjen e dherave të ndryshme nga sipërfaqet shkëmbore si dhe malore.



Kodi A22

Në këtë pjesë të rrugës drejtuesi i automjetit duhet:

- Ta ulë shpejtësinë e lëvizjes;
- Të kontrollojë për rënien eventuale të gurëve apo dherave shkëmborë;
- Pasi të sigurohet që s'ka rënie të gurëve dhe dherave shkëmborë, ta fillojë kalimin e kësaj pjese të rrugës.

Po këto rregulla vlejné edhe për shenjën e rënies së gurëve nga ana e majtë.



Kjo shenjë tregon për rrezikun e shembjes së gurëve nga ana e majtë e rrugës, andaj te kjo shenjë duhet të vendoset tabela plotësuese që na tregon gjatësinë e kësaj pjese të rrugës ku ka shembje gurësh apo dhera shkëmborë.

Edhe te kjo pjesë e rrugës drejtuesi i automjetit duhet:

- Ta ulë shpejtësinë e lëvizjes;
- Të kontrollojë për rënien eventuale të gurëve apo dherave shkëmborë;
- Pasi të sigurohet që s'ka rënie të gurëve dhe të dherave shkëmborë, ta fillojë kalimin e kësaj pjese të rrugës

**A23 - A24 - Shenjat e rrezikut** - Këto shenja tregojnë arritjen tek shenjat ndriçuese me semaforë dhe tregojnë afërsinë e vendit ku trafiku është i rregulluar me shenja ndriçuese të trafikut.



Kodi A23

Kodi A24

Dhënia e këtyre shenjave bëhet në mënyrë që t'i njoftojë pjesëmarrësit në trafik se do të jeni afër udhëkryqit të pajisur me semaforë të cilët mund të jenë të vendosur në mënyrë horizontale apo vertikale. Shenja A23 është vendosur në mënyrë vertikale dhe simboli i kuq është lart, ngjyra e verdhë në mes, ndërsa e gjelbër në fund. Ndërkaq shenja A24 dritat i ka në mënyrë horizontale, drita e kuqe është në anën e majtë, në mes drita e verdhë, kurse drita e gjelbër në anën e djathtë.

Këto shenja vendosen atëherë kur ka punime në rrugë, kur ka pengesa si dhe kur rruga është e dëmtuar, kurse ngjyra themelore e tyre është e verdha.

Në këto raste ngasësit duhet:

- Të kenë kujdes të shtuar gjatë ndërrimit të shiritit;
- Ta ulin shpejtësinë e lëvizjes;
- Të mos manovrojnë në ndërrimin e kahut të lëvizjes;
- Të kenë kujdes në leximin e shenjave në vazhdim.

**A25 - Shenjat e rrezikut punime në rrugë** - Kjo shenjë tregon afërsinë e vendit ku janë duke u kryer punime në rrugë. Ngjyra kryesore e kësaj shenje është e verdhë. Shenja duhet të punohet me klasën e dytë retroreflektive, të përkohshme.



Kodi A25

Afër kësaj shenje vendoset tabela plotësuese e cila i ka shënimet e kryerjes së punimeve në rrugë, ndërsa në kushtet kur dukshmëria është zvogëluar, në rastin konkret natën, duhet të jenë të shënuar me shenja ndriçuese. Mirëpo duhet të ceket se kjo shenjë vendoset nga vendi i kryerjes së punimeve në rrugë.

**A26 - Shenjat e rrezikut të trafikut në të dyja kahet e rrugës -**

Paralajmëron atë pjesë të rrugës ku trafiku zhvillohet në të dy krahët e rrugës me drejtime të ndryshme të lëvizjes, atëherë kur pjesa e rrugës para kësaj shenje ishte me një drejtim të lëvizjes.



Kodi A26

Kjo shenjë duhet të vendoset në të dyja kahet në vendin ku fillon trafiku, ndërsa ngjyrat bazë të saj janë sfondi i bardhë, korniza e kuqe dhe simboli i zi. Kur kemi të bëjmë me punime në rrugë, ngjyra bazë e saj është sfondi me të verdhë, korniza e kuqe dhe simboli i zi. Gjatë kalimit nga pjesa e rrugës me një kah të lëvizjes në rrugën me dy kahe të lëvizjes ngasësit duhet t'i kryejnë këto veprime.

Në këtë pjesë të rrugës ngasësit duhet:

- Ta mbajnë drejtimin e lëvizjes;
- Ta ulin shpejtësinë e automjetit.

Ndërsa ngasësit i ndalohet:

- Të bëjë manovrime me automjet;
- Të qëndrojë i ndalur në rrugë;
- Të bëjë parakalime.

**A27 - Shenjat e rrezikut të qarkullimit rrethrotullues** - Kjo shenjë paralajmëron një pjesë të rrugës, pra një kryqëzim të dy ose më shumë rrugëve urbane të rregulluara me qarkullim rrethrotullues sipas kahut të shigjetave.



Kodi A27

Duhet të theksojmë se të këto lloje të kryqëzimeve, qendra e kryqëzimit duhet të lihet çdoherë në krahun e majtë dhe t'u jepet përparësia e kalimit mjeteve që vijnë nga ana e majtë, pra atyre mjeteve të cilat kanë hyrë më parë në rrethrotullim.

Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Të zvogëlohet shpejtësia e lëvizjes;
- Të vlerësohet situata e lëvizjes;
- Të bëhet respektimi i rregullave për drejtimin e automjetit.

Ndërsa kur kjo shenjë vendoset në ato vende në rrugë për shënimin e punimeve apo të dëmtimeve në rrugë si dhe pengesave të ndryshme në rrugë, ngjyra bazë e saj është e verdhë.

**A28 - Shenja e rrezikut të ngricës në rrugë** - Shenja ngricë në rrugë na tregon atë pjesë të rrugës në të cilën ekziston rreziku i papritur i ngricave në rrugën në të cilën jemi duke lëvizur.



Kodi A28

**A29 - Shenja e rrezikut e përmbysjes, rrëshqitjes së mjeteve** - Edhe kjo shenjë, si të gjitha të tjerat e rrezikut, na paralajmëron afërsinë e vendit ku ekziston rreziku i përmbytjes apo, më mirë të themi, rrëshqitjes së mjetit.



Kodi A29



**A30 - Shenja e rrezikut të kolonës së mjeteve në rrugë** - Kjo shenjë na tregon afërsinë e asaj pjese të rrugës në të cilën, në kushte të përcaktuara apo edhe në rrethana të ndryshme, ekziston rreziku nga kolona e mjeteve të ndalura në atë pjesë të rrugës në të cilën lëvizim.



Kodi A30




Për shenja deri në 1.1 m<sup>2</sup>Për shenja deri në 6 m<sup>2</sup>Për shenja më të mëdha se 6 m<sup>2</sup>

Figura 7. Mënyra e vendosjes së shenjës


**A31 - Shenja e rrezikut të bankinës së dëmtuar** - Paralajmëron pjesën e rrugës së bankinës së dëmtuar, por edhe mundësinë e shembjes së kësaj bankine dhe rrezikun e rënies së mjetit në ndonjë gropë anësore.




Kodi A31




Për shenja deri në 1.1 m<sup>2</sup>



Për shenja deri në 6 m<sup>2</sup>



Për shenja më të mëdha se 6 m<sup>2</sup>



Te kjo shenjë mund të vendoset edhe një tabelë plotësuese e cila na tregon edhe për gjatësinë e kësaj pjese e cila është e dëmtuar.



Kodi A31 dhe E03

Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Të mos i afrohem shumë asaj ane të rrugës;
- Ta ulim shpejtësinë e lëvizjes së mjetit;

**A32 - Shenja e rrezikut të paralajmërimit të këmbësorëve në rrugë** - Kjo shenjë tregon afërsinë e asaj pjese të rrugës në të cilën lëvizin këmbësorët.



Kodi A32

**A33 - Shenja e rrezikut të paralajmërimit të vendkalimit të shënuar për këmbësorë** - Kjo shenjë tregon afërsinë e vendit në të cilin gjendet vendkalimi i shënuar për këmbësorë. Kjo shenjë duhet të punohet nga materiali i klasës së dytë retroreflektive.



Kodi A33

Paralajmëron vendkalimin e këmbësorëve me sinjal horizontal, ndërsa vendoset kryesisht në rrugët interurbane. Kjo shenjë mund të vendoset edhe në rrugët urbane. Paralajmëron afërsinë e vendit në rrugë apo atë pjesë të rrugës ku është caktuar vendkalimi për këmbësorë nga njëra anë e rrugës në tjetrën. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ngasësit duhet ta bëjnë uljen e shpejtësisë së lëvizjes në mënyrë që t'u mundësohet këmbësorëve kalimi i lirë, apo mos të ndodhë ndonjë përplasje me këmbësorët të cilët e kalojnë atë pjesë të rrugës;
- Ngasësit e mjetit motorik te kjo shenjë nuk duhet të qëndrojnë në vijat e bardha dhe u ndalohet ta bëjnë parakalimin e mjeteve që tashmë janë ndaluar për t'ua mundësuar këmbësorëve kalimin e rrugës;
- Të mos qëndrojnë në vijat e këmbësorëve edhe në ato largësi më të vogla se 30 metra.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave me kode A20-A33;
- Shenjat e rrezikut, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut.

Pyetjet:

15. Forma e shenjave të rrezikut nga A20-A33
16. Ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut nga A20-A33
17. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode A20-A33.
18. Tregoni shenjat e rrezikut nga A20 deri A33.

**A34 - Shenja e rrezikut të paralajmërimit të fëmijëve në rrugë** - Shenja tregon afërsinë e vendit në rrugë ku fëmijët shpesh, dhe në numër të madh, lëvizin në rrugë, afër shkollave, kopshteve dhe çerdheve. Kjo shenjë duhet të punohet nga materiali, më së paku, i klasës së dytë retroreflektive.



Kodi A34

Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ngasësit e mjetit motorik duhet ta ulin shpejtësinë e lëvizjes;
- T'i shikojnë fëmijët me kujdes;
- Të mos bëjnë parakalim të mjeteve që u kanë dhënë përparësi kalimi fëmijëve;
- Ndalohet qëndrimi në këtë zonë.

**A35 - Shenja e rrezikut të paralajmërimit të pistës së aeroportit**

Shenja tregon afërsinë e vendit të rrugës ku aeroplanët fluturojnë ulët para se të ngrihen në ajër.



Kodi A35

Kjo shenjë paralajmëron se në këtë zonë ka mundësi të zhvillohen zhurma të mëdha apo edhe mund të ketë verbim nga dritat e forta të cilat i shkaktojnë mjetet fluturuese që fluturojnë ulët.

Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ngasësit e mjetit motorik duhet ta ulin shpejtësinë e lëvizjes për arsye të shqetësimeve që mund t'i shkaktojnë avionët.

### **A36 - Shenja e rrezikut që tregon afërsinë e tunelit apo galerisë**

**në rrugë** - Kjo shenjë tregon afërsinë e tunelit apo të galerisë në rrugë.



Kodi A36

Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ngasësit e mjetit motorik duhet ta ulin shpejtësinë e lëvizjes sipas shenjës së rekomanduar në tabelë;
- Ta shikojnë situatën e lëvizjes me kujdes të shtuar;
- Të mos bëjnë parakalim të mjeteve që u kanë dhënë përparësi kalimi mjeteve të tjera;
- Ndalohet qëndrimi në tunel.



**A37 - Shenja e rrezikut të erërave anësore** - Kjo shenjë tregon afërsinë e pjesës së rrugës në të cilën shpesh mund të fryjnë erërat anësore.



Kodi A37

Shenja na paralajmëron se ka mundësi të ketë erë të fortë anësore, kurse rreziku më i madh mund të jetë për ato mjete të cilat janë karrocieri e mëdha, ngasësve të të cilave mund t'u shkaktohet humbja e qëndrueshmërisë anësore të mjetit të cilin e drejtojnë. Kjo vjen veçanërisht kur kemi të bëjmë me rrugë të lagur apo të njollosur me baltë. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ngasësit e mjetit motorik duhet ta ulin shpejtësinë e lëvizjes;
- Të mbajnë timonin e drejtimit me një siguri të shtuar për arsye të kontrollimit të rrymave të mëdha të erës;
- Ta vazhdojnë drejtimin e lëvizjes me një marsh më të ulët;
- Ndalohet parakalimi i mjeteve të tjera në lëvizje.

**A38 - Shenja e rrezikut nga zjarri** - Kjo shenjë tregon hapësirën në të cilën ekziston rreziku nga zjarri. Simboli i mjetit të ndezur në shenjë është me ngjyrë të verdhë, ndërsa simboli i zjarrit është me ngjyrë të kuqe.



Kodi A38

Shenja e rrezikut nga zjarri na tërheq vëmendjen e një rreziku të mundshëm që mund të vijë nga ndezja e zonave malore apo të afërsisë së vendeve të cilat mund të gjenden ngjitur me rrugën e lëvizjes me rrezik të madh zjarri. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Mos të hedhim mjet ndezës nga dritarja e mjetit sepse jemi duke lëvizur afër pyllit, shkurreve dhe barit të thatë;
- Mos të ndalemi mbi bar të thatë pasi mund të hedhen cigare nga dritarja e mjetit etj.

**A39 - Shenja e rrezikut që paralajmëron biçiklistët në rrugë** - Kjo shenjë e tregon afërsinë e vendit të rrugës në të cilën biçiklistët shpesh mund lëvizin apo janë duke lëvizur në rrugë të cilët kanë dalë nga rrugët anësore apo nga shtegu i biçiklistëve.



Kodi A39

Kjo shenjë na paralajmëron afërsinë e vendkalimit të biçikletave të cilat mund të dalin nga rrugët anësore. Mirëpo, meqenëse edhe gjatë lëvizjes me biçikletë mund të ndryshohet drejtimi në çdo çast, duhet që gjatë parakalimit me mjet të kemi kujdes dhe të mbajmë një distancë anësore të lëvizjes prej rrethit, një metër anash tij.

**A40 - Shenja e rrezikut që paralajmëron urë lëvizëse** - Kjo shenjë e tregon afërsinë e vendit në të cilin rruga kalon përtej urës lëvizëse, ndërsa simboli i ujit në shenjë është me ngjyrë të kaltër dhe dy vija të valorizuara.



Kodi A40

Kjo shenjë paralajmëron urën e lëvizshme. Para kësaj shenje duhet të kemi kujdes në situata të cilat ndodhin para nesh gjatë lëvizjes me mjet. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë: të tregojmë kujdes të shtuar që mos të ndeshemi me urën lëvizëse.

**A41 - Shenja e rrezikut për afërsi të bregut** - Kjo shenjë tregon afërsinë e vendit në të cilin rruga gjendet në breg. Simboli i ujit në shenjë është me dy vija të valorizuara me ngjyrë të kaltër.



Kodi A41

Këtu kemi të bëjmë me shenjën e cila na paralajmëron se rruga përfundon në digë, në

kanal apo në lumë etj. Me këtë shenjë paralajmërohem se jemi afër vendit në të cilin mund të biem në greminë apo në bregdet. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ta bëjmë ngadalësimin e shpejtësisë së lëvizjes;
- Të tregojmë kujdes për të mos rënë në ujë.

**A42 - Shenja e rrezikut të rrugës së tramvajit** - Kjo shenjë tregon afërsinë e vendit në të cilën rruga kalon përtej rrugës së tramvajit e cila është në nivel.



Kodi A42

**A43 - Shenja e rrezikut kafshët në rrugë** - Kjo shenjë tregon afërsinë në të cilin kafshët shtëpiake me mbikëqyrës mund ta kalojnë rrugën përtej apo të lëvizin përgjatë rrugës. Simboli i kësaj shenje mund të jetë i ndryshëm, varësisht nga lloji i kafshëve.



Kodi A43

Shenja paralajmëron pjesën e rrugës ku mund të kalojë kafsha shtëpiake në rrugë. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ta ulim shpejtësinë e lëvizjes, në të njëjtën kohë ta rrisim vëmendjen për të qenë të gatshëm të ndalemi në rast se kafsha bën ndonjë veprim të papritur;
- Ta vëzhgojmë rrugën dhe, pasi të sigurohemi se nuk ka pengesa, ta vazhdojmë lëvizjen.

**A44 - Shenja e rrezikut egërsirat në rrugë** - Kjo shenjë tregon afërsinë e rrezikut të veçantë në të cilin egërsirat shpesh mund ta kalojnë rrugën. Simboli i kësaj shenje mund të jetë i ndryshëm, varësisht nga lloji i egërsirave.



Kodi A44

Shenja paralajmëron pjesën e rrugës ku mund të kalojë kafsha e egër në rrugë. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ta ulim shpejtësinë e lëvizjes, në të njëjtën kohë rrisim vëmendjen për të qenë të gatshëm të ndalemi në rast se kafsha e bën ndonjë veprim të papritur;
- Ta vëzhgojmë rrugën dhe, pasi të sigurohemi se nuk ka pengesa, ta vazhdojmë lëvizjen.

**A45 - Shenja e rrezikut vendkalim hekurudhor i siguarur/mbrojtur -**

Kjo shenjë tregon afërsinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës me barriera dhe gjysmëbarriera.



Kodi A45

Kjo shenjë punohet së paku nga klasa e dytë retroreflektive dhe tregon kalimin e rrugës me mbrojtës ose gjysmëmbrojtës. Kjo shenjë na paralajmëron se pas 150 m ka kalim me nivel që është i ruajtur, është i vendosur mbi panelin vertikal, i cili tregon distancën me tri vija prej 150 m prej kalimit në nivel. Ndërkaq panelet vertikale të cilat tregojnë distancën me dy dhe me një vijë të kuqe të pjerrët vendosen midis këtij sinjali dhe kalimit në nivel në mënyrë që të tregohet distanca prej 100 m dhe 50 m prej binarëve, ndërsa në afërsi të nivelit vendosen aparatet të cilët kanë dritë të kuqe dhe ndizen 30 sekonda përpara se të ulet barriera apo mbrojtësi, si dhe aparatet akustike që hyjnë në veprim pesë sekonda para se të ulen barrierat apo mbrojtësit.



Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave me kode A33-A45;
- Shenjat e rrezikut, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut.

Pyetjet:

19. Forma e shenjave të rrezikut nga A34-A45
20. Ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut nga A34-A45
21. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode A34-A45
22. Tregoni shenjat e rrezikut nga A34 deri A45.

**A46 - Shenja e rrezikut vendkalim hekurudhor i pasiguar** - Kjo shenjë tregon afërsinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës pa barriera dhe gjysmëbarriera, po ashtu afërsinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila nuk sigurohet me barriera dhe gjysmëbarriera.




Kodi A46

Shenja punohet së paku nga klasa e dytë retroreflektive. Kjo na paralajmëron kalimin e rrugës në nivel pa mbrojtës apo gjysmëmbrojtës. Kjo shenjë vendoset në panelet tregues vertikale me tri vija, në largësi 150 m nga kalimi në nivel, ndërsa panelet e tjera treguese vertikale me dy dhe një vijë vendosen midis sinjalit dhe binarëve në largësitë 100 m dhe 50 m nga binarët. Në afërsi të kësaj shenje duhet të veprojmë në këtë mënyrë:

- Ta ndalojmë lëvizjen kur ulen apo ngrihen barrierat apo gjysmëbarrierat;
- Ta ndalojmë lëvizjen kur kyçen sinjalet akustike;
- Ta ulim shpejtësinë e lëvizjes;
- Ta ndalojmë qëndrimin mbi shina etj.

**A47 A48 - Shenja: Kryqi i Andreut** - Kjo shenjë shënon vendin në të cilin rruga kalon përtej hekurudhës në nivel pa barriera dhe gjysmëbarriera me një palë binarë, apo (A48) me dy apo më shumë binarë. Kur përgjatë rrugës nuk ka hapësirë të mjaftueshme për vendosjen normale të shenjës ajo mund të vendoset në këndin prej 90° në anën e djathtë.



Kodi A47

Kodi A48

Sipas dispozitave të përgjithshme të udhëzimit administrativ për vendosjen, formën, ngjyrën, dimensionet e shenjave dhe sinjalizimet e pajisjeve në trafikun rrugor, këto shenja punohen nga:

- Së paku klasa e dytë retroreflektive;
- Shenja ka formën e një apo dy shinave;
- Për shkak të dukshmërisë më të mirë mund të jetë e vendosur në një tabelë të bardhë;
- Shenja vendoset vetëm në kalimin e rrugës përtej hekurudhës në nivel, e cila është plotësisht e pambrojtur apo e mbrojtur me pajisjet e dhënies së sinjaleve me drita dhe akustike, pa barriera dhe gjysmëbarriera, në largësi prej 5m nga largësia e binarëve hekurudhorë. Nëse rrethanat janë të tilla, mund të vendoset edhe në distancë jo më të vogël se 3 m dhe jo më të madhe se 10 metra nga binarët hekurudhorë;

- Nëse kalimi përtej hekurudhës në nivel është i mbrojtur me pajisjet e shenjave ndriçuese, atëherë shenja vendoset në të njëjtën shtyllë mbi shenjën sinjalizuese. Shenja duhet të jetë e dukshme nga një distancë më së paku prej 50 m.

**A49 - Shenja e afërsisë së vendkalimit hekurudhor të siguar** - Kjo shenjë tregon largësinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila është e siguar me barriera dhe gjysmëbarriera.



Këto shenja janë distanca treguese. Shenja e parë, me një vijë të pjerrtë, tregon largësinë prej 80 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së parë treguese, ndërsa shenja e dytë me dy vija të pjerrëta tregon largësinë prej 160 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së parë treguese, ndërsa shenja e tretë me tri vija të pjerrëta tregon largësinë prej 240 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së tretë treguese. Vlen të theksohet se në literaturë të ndryshme këto largësi mund t'i gjeni edhe si 50 m, 100 m, 150 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së parë, dytë dhe tretë treguese.

### **A50 - Shenja e rrezikut vendkalim hekurudhor i pasiguar -**

Kjo shenjë tregon largësinë e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel e cila nuk është e siguar me barriera dhe gjysmëbarriera.



Kodi A50

Edhe këto shenja, sikurse shenja paraprake, janë distanca treguese. Shenja e parë, me një vijë të pjerrtë, tregon largësinë prej 80 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së parë treguese; shenja e dytë, me dy vija të pjerrëta, tregon largësinë prej 160 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së parë treguese; shenja e tretë, me tri vija të pjerrëta, tregon largësinë prej 240 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së tretë treguese. Vlen të theksohet se në literaturë këto largësi mund t'i gjeni edhe si 50 m, 100 m, 150 m ndërmjet linjës hekurudhore dhe shenjës së parë, dytë dhe tretë treguese.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave me kode A46-A50;
- Shenjat e rrezikut, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut.

Pyetjet:

23. Forma e shenjave të rrezikut nga A46-A50
24. Ngjyrat bazë të shenjave të rrezikut nga A46-A50
25. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode A46-A50
26. Tregoni shenjat e rrezikut nga A46 deri A50.

## 1.2 SHENJAT URDHËRUESE (TË PËRSHKRIMIT)

Tani do t'i paraqesim disa sinjale urdhëruese, siç mund t'i quajmë ndryshe, sinjale të përshkrimit. Këto sinjale do t'i shtjellojmë në përputhje të Udhëzimit Administrativ nr. 4/2011 për vendosjen, ngjyrën, formën si dhe dimensionet e tyre.

Në vijim do t'i shtjellojmë disa shenja apo sinjale urdhëruese të cilat i hasim çdo ditë kur jemi duke lëvizur qoftë me këmbë apo me veturë. Njëherësh do ta tregojmë llojin, kuptimin, formën, ngjyrën, dimensionin e shenjave, të sinjalizimeve dhe pajisjeve në trafikun rrugor. Këto sinjale na shërbejnë për t'i paralajmëruar pjesëmarrësit në komunikacionin rrugor për:

1. PËRPARËSITË
2. NDALIMET
3. DETYRIMET
- 4.

### 1.2.1 SHENJAT E PËRPARËSISË




Figura 8. Forma e vendosjes së shenjës flat (sheshhtë)

### 1.2.1.1 SHENJA ME KËND (ALKANT)

Shenja e tipit (alkant) është e prodhuar nga alumini, me tehe dhe me fllanxha me një fytyrë të përsosur. Shenja qëndron e pastër për shkak të dizajnit që ka, nuk ka nevojë për vrima, ribatina, saldim ose ndonjë teknikë të ngjashme. Shenja është më e qëndrueshme kundër deformimeve të qëllimshme apo aksidentale për shkak të teheve që ka, është e përshtatshme për mjediset urbane dhe i përmbush të gjitha kërkesat moderne. Karakteristikat e tjera të shenjës janë:

- Vendosje e shpejtë dhe efektive pa pasur nevojë për përdorimin e mjeteve të veçanta;
- Lehtë zëvendësohet me shenjat e tjera;
- Reziston ndaj qëllimeve të këqija, dëmtimeve aksidentale apo të qëllimshme;
- Siguri pasive të lartë;
- Trajtim të lehtë.




Figura 9. Forma e vendosjes së shenjës (alkant)



### 1.2.1.2 SHENJA E SHESHTË ME RRETH (ALFORM)

Shenja e tipit (alform) është e prodhuar nga materiali i aluminit, me trashësi 2 mm, e përforcuar me rreth (profil) alumini (alform). Shenjat më të mëdha se 1.1 m<sup>2</sup> punohen nga alumini me trashësi 3 mm dhe përforcohen me rreth (profil) alform. Në varësi të madhësisë, përforcimi i shenjave të tipit alform bëhet në tri mënyra.




Figura 10. Për shenja deri në 1.1 m<sup>2</sup>, për shenja deri në 6 m<sup>2</sup>, për shenja më të mëdha se 6 m<sup>2</sup>

Tiparet kryesore të shenjave alform:

- Stabilitet;
- Funksionalitet;
- Kosto efektive;
- Transport i lehtë;
- Të qëndrueshme;
- Dizajni i shenjës është i kënaqshëm.




Figura 11. Forma e vendosjes së shenjave alform

Foljet (fytyrat) retroreflektive që përdoren në shenjat e komunikacionit sipas standardeve evropiane janë:

Tipi R1 teknologji me rruaza qelqi, klasa e inxhinierive (Engineer Grade EG). Është brezi i parë i folieve që zakonisht vendosen në rrugët me trafik të vogël.




Figura 12. Tipi R1, teknologji me rruaza qelqi, klasa e inxhinierive (Engineer Grade EG)

Tipi R2, teknologji me rruaza qelqi:

1. Klasa me intensitet të lartë (High Intensity Grade HIG). Është folie reflektuese me rruaza qelqi, që zakonisht vendoset në qytete me trafik të ulët;
2. Me intensitet të lartë prizmatike (High Intensity Prismatic HIP). Është folie reflektuese, që vendoset në qytete me intensitet të lartë dhe të ulët të trafik. Hyrje e ka këndin e madh dhe reflekton mirë.




Figura 13. Folia e tipit HIG dhe HIP

Tipi R3, teknologji mikro-prizmatike:

3. Klasa diamanti (Diamond Grade VIP (DG VIP)). Është folie retroreflektuese, e cila vendoset në rrugët më performancë të lartë, ku kërkohet edhe reflektim i mirë (autostrada, magjistrale etj.). Në hyrje ka këndin e lartë dhe reflekton shumë mirë edhe në kthesa;
4. Klasa diamanti (Diamond Grade (3 DG3)). Është gjenerata e fundit e mikrofilmave retroreflektues, me një performancë shumë të lartë të filmave retroreflektues LDP. Janë shumë të përshtatshme për sinjalet e rrugëve me performancë të lartë, si autostrada, magjistrale etj. dhe në qytete me ndriçim të lartë. Në hyrje ka këndin e lartë dhe reflekton shumë mirë edhe në kthesa.





Figura 14. Folia e tipit DG VIP dhe DG3

Shenjat e urdhrave të prera janë ato shenja të cilat u bëjnë me dije të gjithë pjesëmarrësve në komunikacionin rrugor për ndalimet, kufizimet dhe obligimet që domosdoshmërisht duhet t'u përmbahen.

Këto shenja kanë formën e rrethit, përveç shenjës trekëndësh, ku njëra brinjë e trekëndëshit është e vendosur horizontalisht, ndërsa këndi (maja) është normal me rrugën () B01 (kryqëzim me rrugën kryesore) dhe shenjës B02 (ndalje e obligueshme STOP).

Ngjyra bazë e shenjave të ndalimit dhe e shenjave të kufizimit është e bardhë, simbolet dhe mbishkrimet te këto shenja janë me ngjyrë të zezë. Shenjat e obligimit ngjyrën bazë e kanë të kaltër, ndërsa simbolet me ngjyrë të bardhë. Skaji i rrethit, shiritat e drejtë dhe të pjerrët, në shenjat e urdhrave të prera, janë me ngjyrë të zezë.

Tabela 3. Dimensionet sipas rangut të rrugës

Lloji i rrugës	Gjerësia e rrugës	Madhësia e shenjës	Largësia e vendosjes së shenjës	Kujdes
<b>Shenja trekëndësh</b>				
Në autostradë dhe rrugë kryesore jashtë vendbanimeve	Mbi 7 m	120 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	Nëse për ndonjë arsye nuk mund të vendoset shenja në vendin ku fillon detyrimi, atëherë shenja mund të vendoset edhe në distancë më të madhe, mirëpo me tabelë plotësuese ku tregon distancën deri te vendi ku fillon detyrimi.
Në të gjitha rrugët tjera dhe të vendbanimit	///	90 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Për rrugët e pakategorizuara, shtegun e biçikletave	///	60 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Vendosja në një shenjë tjetër	///	45 cm	-	

Dimensionet e shenjave në formë rrethi, në të cilat është vendosur tetëkëndëshi i rregullt, shenja STOP, janë të paraqitura në tabelën nr 4.

Tabela 4. Dimensionet e shenjave

Lloji i rrugës	Gjerësia e rrugës	Madhësia e shenjës (D)	Largësia e vendosjes së shenjës	Kujdes
<b>Shenja tetëkëndësh STOP</b>				
Në autostradë dhe rrugë të rezervuar për komunikacion, në rrugët në vendbanim që nuk janë në lagje	Mbi 7.0 m	90 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	Nëse për ndonjë arsye nuk mund të vendoset shenja në vendin ku fillon detyrimi, atëherë shenja mund të vendoset edhe në distancë më të madhe, mirëpo me tabelë plotësuese, ku tregon distancën deri te vendi ku fillon detyrimi.
Në të gjitha rrugët e tjera dhe të vendbanimit	Deri 7.0 m	60 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Në tunele dhe galeri	///	60 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Vendosja në një shenjë tjetër	///	40 cm	-	

Tabela 5. Dimensionet e shenjave në formë rrethi

Lloji i rrugës	Gjerësia e rrugës	Madhësia e shenjës (D)	Largësia e vendosjes së shenjës	Kujdes
<b>Shenja rrethore</b>				
Në autostradë dhe rrugë të rezervuar për komunikacion, në rrugë në vendbanim që nuk janë në lagje	Mbi 7.0 m	90 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	Nëse për ndonjë arsye nuk mund të vendoset shenja në vendin ku fillon detyrimi, atëherë shenja mund të vendoset edhe në distance më të madhe mirëpo me tabelë plotësuese ku tregon distancën deri te vendi ku fillon detyrimi.
Në rrugët kryesore urbane dhe me gjerësinë e cekur në këtë tabelë	5.0 – 7.0 m	60 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Në tunele dhe galeri	///	60 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Në të gjitha rrugët e tjera dhe rrugët urbane	///	40 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	
Vendosja në një shenjë tjetër	///	min 40 cm	Në vendin ku fillon detyrimi	

Shenja e urdhrave të prera duhet të përsëritet pas çdo udhëkryqi nëse shenja vlen edhe pas atij udhëkryqi.

Shenjat rrethore të urdhrave të prera, si ato të kufizimit dhe ato të obligimit që janë të vendosura në shtyllën e njëjtë me shenjën e vendbanimit, në hyrje të vendbanimit vlejnë për tërë territorin e vendbanimit, vetëm në rast se në ndonjë rrugë apo pjesë të rrugës përcaktohet me ndonjë shenjë tjetër të urdhrave të prera.

Të gjitha këto rregulla kanë të bëjnë edhe për objektet rrugore në të cilat zhvillohet komunikacioni, si tunele, ura, ose të ngjashme. Në rastet kur shenja vlen vetëm për një kohë të caktuar apo vetëm për ndonjë ditë të caktuar, duhet të vendoset tabela plotësuese për kohën apo ditën në të cilën vlen urdhri i paraparë me shenjë, ose mund të vendosen edhe shenja të komunikacionit që janë të punuara në atë mënyrë që simboli i tyre si dhe tabela plotësuese e cila përcakton domethënien e tyre, parashihen vetëm gjatë kohës kur vlen urdhri i paraparë me shenjë.

Tani do ta shtjellojmë sipas kodeve rrugore që kanë dalë në bazë të marrëveshjes së Konventës së Vjenës mbi sinjalizimin rrugor të gjitha shenjat e urdhrave të prera.

**B01 - Shenja: kryqëzim me rrugën me përparësi kalimi** - Kjo shenjë tregon afërsinë e kryqëzimit në të cilën shoferi duhet t'u japë përparësi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin në rrugën në të cilën ai hyn.



Kodi B01

Kjo shenjë, në rrugën me përparësi kalimi, tregon afërsinë e kryqëzimit në të cilën ngasësit e automjetit motorik duhet t'u japin përparësi kalimi të gjitha atyre mjeteve të cilat lëvizin në rrugën në të cilën ata dëshirojnë të futen.

Forma dhe materiali punues i kësaj shenje është:

- Shenja punohet së paku nga klasa e dytë retroreflektive;
- Ka formën e trekëndëshit barabrinjës. Njëra brinjë është e vendosur në mënyrë horizontale, ndërsa maja e shenjës është e kthyer kah ana e kundërt poshtë.

Ngjyra bazë e shenjës B01 është: fusha (sfondi) e bardhë, konturi (korniza) i kuq, ndërsa simbol nuk ka.

Kemi tri lloje të kornizave që përdoren në shenjat vertikale (duke i përjashtuar ato me ndriçim) të komunikacionit:



- Shenja të sheshta (flat);
- Shenja me kënd (alkant);
- Shenjat e sheshta me rreth (alform).


Shenjat që i përmendëm më lart mund të jenë edhe nga llamarina, por nuk preferohen.

### 1.2.2 SHENJAT E SHESHTA (FLAT)

Shenjat e sheshta punohen nga alumini me trashësi 2 mm deri në 3 mm. Ky lloj i shenjave (kornizave) nuk ka ndonjë kënd të përforcimit. Përforcimi i tyre bëhet duke bërë vrima dhe duke përdorur ribatinat për shtrëngim. Këto lloje të kornizave nuk janë shumë të pëlqyera pasi që mbesin shenjat e ribatinave.

**B02 - Shenja: ndalje e obliguar para kryqëzimit me rrugën me përparësi kalimi**

Kjo shenjë tregon afërsinë e kryqëzimit në të cilën shoferi duhet t'u japë përparësi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin rrugës në të cilën ai hyn.



Kodi B02

Figura 15. Vendosja e shenjës STOP





Figura 16. Mënyra e vendosjes së shenjës


Shenja ndalje e obliguar B02 tregon vendin para hyrjes në kryqëzim në të cilën shoferi është i obliguar ta ndalë mjetin dhe t'u japë përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin në rrugën në të cilin hyn ose tregon vendin para vendkalimit hekurudhor (kalimi i rrugës përtej hekurudhës në nivel të njëjtë), ku shoferi duhet ta ndalë mjetin dhe t'u japë përparësi kalimi të gjitha mjeteve të cilat lëvizin binarëve të trenit:

- Shenja punohet së paku nga klasa e dytë retroreflektive;
- Shenja B02 ka formën e tetëkëndëshit të rregullt;
- Ngjyra bazë e shenjës B02 është: fusha (sfondi) i kuq, konturi (korniza) e bardhë dhe simboli (shkrimi) i bardhë.

Shenja duhet të vendoset në vendin ku mjete duhet të ndalet. Kjo shenjë bashkëvepron me shenjën horizontale tërthore në rrugë, e cila tregon pozicionin të cilin duhet të ndalet mjete.

### 1.2.3 SHENJAT E NDALIMIT

**B03 - Shenja ndalim trafiku në dy drejtimet** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën ndalohe komunikacioni për të gjitha mjetet në dy drejtimet.



Kodi B03

Shenja B03 ka formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Shenja nuk ka simbol të veçantë.

Këto shenja vendosen në të gjitha ato rrugë, pjese të rrugës apo sheshe që është i ndaluar qarkullimi i mjeteve në të dy drejtimet. Kjo shenjë mund të kombinohet edhe me shenjën (tabela) plotësuese e cila tregon domethënien e ndalesës.

**B04 - Shenja ndalim trafiku për të gjitha mjetet me veprim motorik, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore dhe mopedëve.



Kodi B04

Shenja B04 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. E kuqe
2. Simboli është një vijë horizontale me ngjyrë të bardhë.

Shenja vendoset në fillim të rrugës. Baza (fytyra) e shenjës duhet të jetë e kthyer përballë automjeteve që u është ndaluar qarkullimi në atë kah.




Figura 17. Mënyra e vendosjes së shenjës

**B05 - Shenja ndalim trafiku për të gjitha mjetet me veprim motorik, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore dhe mopedëve.



Kodi B05

Shenja B05 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i zi.

Brenda shenjës është simboli në të cilën është e paraqitur forma e një mjeti motorik (pjesa e përparme e një veture).

**B06 - Shenja ndalim trafiku për autobus** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për autobus.



Kodi B06

Shenja B06 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i zi.

Brenda shenjës është simboli në të cilën është e paraqitur forma e një mjeti motorik (pjesa anësore e autobusit).



**B07 - Shenja ndalim trafiku për mjetet transportuese -\* kamion** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet transportuese me masën më të madhe të lejuar mbi 3.5 tonë.



Kodi B07

Nëse nën simbolin e kamionit është shkruar masa më e madhe e lejuar e kamionit, ndalesa vlen për ata kamionë të cilët masa më e madhe e lejuar e tejkalon atë që është paraparë me shenjë.

Shenja B07 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i zi.

Brenda shenjës është simboli në të cilën është paraqitur forma e një mjeti motorik (pjesa anësore e kamionit).

**B08 - Shenja ndalim komunikacion për cisterna** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet të cilat bartin materie të cilat mund ta ndotin ambientin. Përkatësisht ndalon kalimin e mjeteve që transportojnë produkte që bashkëveprojnë dhe ndotin ujin.



Kodi B08

Shenja B08 ka formë të rumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës ka ngjyrë portokalli
4. Boshtet e rrotave kanë ngjyrë të zezë
5. Ndërsa dy vijat valore kanë ngjyrë të kaltër.

Kjo lloj shenje nuk aplikohet në rastet kur rezervuari i karburanteve nuk i plotëson kushtet sipas ECE-së.

**B09 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet të cilat bartin eksploziv ose ndonjë materie lehtë ndezëse** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet të cilat bartin eksploziv ose ndonjë materie të lehtë ndezëse. Shenja nuk specifikon karburantin që kanë në rezervuar.




Kodi B09

Shenja B09 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës ka ngjyrë portokalli dhe ngjyrë të zezë
4. Ndërsa me ngjyrë të zezë janë të paraqitura boshtet e mjetit dhe rrotat.

**B10 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet të cilat bartin materie të rrezikshme, siç janë: materiet shpërthyes (eksplozive), gazra apo materiale që, kur preken, japin gazra, lëngje djegëse, materiale helmuese reaktive, material brejtës, material ndotës dhe infektues, materiale që ndezën vetvetiu.



Kodi B10

Shenja B10 ka formë të rumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës ka ngjyrë portokalli
4. Ndërsa boshtet e rrotave janë të paraqitura me ngjyrë të zezë

**B11 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet motorike të cilat tërheqin mjetet bashkëngjitëse** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet transportuese të cilat tërheqin mjetet bashkëngjitëse.



Kodi B11

Kjo shenjë lejon tërheqjen e rimorkiove me një aks dhe mjetet artikulare.

Shenja B11 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një rimorkio me një aks me ngjyrë të zezë.

**B12 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet transportuese të cilat tërheqin mjetet bashkëngjitëse** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet transportuese të cilat tërheqin mjetet bashkëngjitëse.



Kodi B12

Kjo shenjë lejon tërheqjen e rimorkiove me një aks dhe mjeteve artikulare. Shenja B12 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është pjesa e pasme e mjetit tërheqës si dhe një rimorkio me dy akse me ngjyrë të zezë.

**B13 - Shenja ndalim komunikacioni për traktor** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për traktor. Paraqet ndalimin e kalimit për mjete bujqësore si traktor, autokombajna etj.



Kodi B13

Shenja B13 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është forma e traktorit dhe e traktoristit me ngjyrë të zezë.

Kjo shenjë tregon edhe ndalimin e qarkullimit të makinave bujqësore.

**B14 - Shenja ndalim komunikacioni për motoçikleta** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për motoçikleta dhe mjete motorike me tri rrota.



Kodi B14

Shenja B14 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është paraqitur forma e mjetit me veprim motorik me tri rrota me ngjyrë të zezë.



**B15 - Shenja ndalim komunikacioni për mopedë/ciklomotorë** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mopedë me dy ose tri rrotë.



Kodi B15

Shenja B15 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simbol i shenjës është paraqitur forma e mjetit me veprim motorik me tri rrota me ngjyrë të zezë.

Diskutimet dhe pyetjet ne grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave të ndalimit me kode B01-B15;
- Shenjat e ndalimit, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të ndalimit.

Pyetjet:

27. Forma e shenjave të ndalimit nga B01-B15
28. Ngjyrat bazë të shenjave të ndalimit nga B01-B15
29. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode B01-B15
30. Tregoni shenjat e ndalimit nga B01 deri B15.

**B16 - Shenja ndalim komunikacioni për mopedë/ciklomotorë** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mopedë me dy ose tri rrota.



Kodi B16

Shenja B16 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është forma e biçikletës me ngjyrë të zezë.

**B17 - Shenja ndalim komunikacioni për biçikletë dhe mopedë** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për biçikleta dhe mopedë.



Kodi B17

Shenja B17 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Vija horizontale është me ngjyrë të kuqe
4. Simboli i shenjës është forma e biçikletës dhe e mjetit me veprim motorik me ngjyrë të zezë.

Simbolet janë të vendosura njëra në pjesën e epërme të shenjës mbi vijën e kuqe, tjetra në pjesën e poshtme të shenjës nën vijën e kuqe.

**B18 - Shenja ndalim komunikacioni për qerre** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për qerre.



Kodi B18

Shenja B18 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është forma e një kali, së bashku me qerre, me ngjyrë të zezë.

**B19 - Shenja ndalim komunikacioni për karrocë dore** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për karrocë dore.



Kodi B19

Shenja B19 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është forma e njeriut, së bashku me karrocë, me ngjyrë të zezë.

**B20 - Shenja ndalim komunikacioni për të gjitha mjetet motorike** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për të gjitha mjetet me veprim motorik. Kjo shenjë e ndalimit mund të shfrytëzohet për lloje të ndryshme të mjeteve.



Kodi B20

Shenja B20 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Vija horizontale është me ngjyrë të kuqe
4. Simboli i shenjës është forma e motoçikletës dhe e mjetit me veprim motorik me ngjyrë të zezë.

Simbolet janë të vendosura njëra në pjesën e epërme të shenjës, mbi vijën e kuqe, tjetra në pjesën e poshtme të shenjës, nën vijën e kuqe. Në këtë shenjë mund të vendosen të gjitha simbolet nga shenja B05-B19 duke i përdorur të gjitha ngjyrat siç janë shpjeguar më lart.

**B21 - Shenja ndalim komunikacioni për këmbësorë** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për këmbësorë.




Kodi B21

Shenja B21 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është forma e njeriut duke ecur, me ngjyrë të zezë.


**B22 - Shenja ndalim komunikoni për mjetet te të cilat tejkalohe gjerësia e caktuar** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikoni për mjetet te të cilat tejkalohe gjerësia e caktuar në shenjë.







ALFORM (unaza)




Kodi B22



ALKANT (unaza)



ALFORM (unaza)



Tubi



Figura 18. Vendosja e shenjës sipas standardit



Shenja B22 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shifër, së bashku me njësinë me ngjyrë të zezë, si dhe në të dyja anët, ana e djathtë dhe ana e majtë e shenjës, kanë nga një formë trekëndëshi me ngjyrë të zezë.

Numri (shifra) në shenjë është i dhënë si shembull, ndërsa numri i vërtetë duhet të vendoset sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit. Zakonisht kjo shenjë vendoset në rrugët e ngushta, ura, tunele etj.

**B23 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalohe lartësia e caktuar** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalohe lartësia e caktuar në shenjë.



Kodi B23


Shenja B23 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shifër, së bashku me njësinë me ngjyrë të zezë, si dhe në të dyja anët, ana e epërme dhe ana e poshtme e shenjës, kanë nga një formë trekëndëshi me ngjyrë të zezë.

Numri (shifra) në shenjë është i dhënë si shembull, ndërsa numri i vërtetë duhet të vendoset sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit.

Zakonisht kjo shenjë vendoset para urave me harqe tunele etj.


Edhe kjo shenjë e komunikacionit vendoset si shenjat e tjera të cekura më lart.




ALFORM (unaza)

ALKANT (unaza)

Kodi B23



ALFORM (unaza)



Tubi

Figura 19. Vendosja e shenjës sipas standardit

**B24 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalohe masa e caktuar** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalohe masa e caktuar në shenjë.




Figura 20. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B24 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shifër, së bashku me njësinë me ngjyrë të zezë.

Numri (shifra) në shenjë është i dhënë si shembull, ndërsa numri i vërtetë duhet të vendoset sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit.

Zakonisht kjo shenjë vendoset para urave me harqe tunele etj.

**B25 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalo het ngarkesa boshtore e caktuar** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalo het ngarkesa boshtore e caktuar në shenjë.





Figura 21. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B25 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shifër, së bashku me njësinë me ngjyrë të zezë, si dhe forma e boshtit të automjetit me ngjyrë të zezë.

Numri (shifra) në shenjë është i dhënë si shembull, ndërsa numri i vërtetë duhet të vendoset sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit. Kjo shenjë zakonisht vendoset përpara një ure.

**B26 - Shenja ndalim komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalohe**  
**gjatësia e caktuar** - Kjo shenjë tregon rrugën, përkatësisht pjesën e rrugës  
 në të cilën është i ndaluar komunikacioni për mjetet te të cilat tejkalohe  
 gjatësia e caktuar në shenjë.



Kodi B26

ALFORM (unaza)

Figura 22. Vendosija e shenjës sipas standardit

Shenja B26 ka formë të rumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shifër, së bashku me njësinë dhe me shigjeta, që tregojnë gjatësinë e automjetit ngjyrë të zezë si dhe formën e automjetit me ngjyrë të zezë.

Numri (shifra) në shenjë është i dhënë si shembull, ndërsa numri i vërtetë duhet të vendoset sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit.

**B27 - Shenja e distancës më të vogël në mes të mjeteve gjatë lëvizjes** - Kjo shenjë tregon distancën më të vogël në mes të mjeteve gjatë lëvizjes së cilës shoferi duhet t'i përmbahet.





Figura 23. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B27 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shifër, së bashku me njësinë, si dhe simboli i mjetit për të cilin vlen urdhri.

Numri (shifra) në shenjë është dhënë si shembull, ndërsa numri i vërtetë duhet të vendoset sipas rrethanave në rrugë dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit.

**B28 - Shenja ndalim kthimi majtas** - Kjo shenjë tregon vendin ku është i ndaluar kthimi majtas dhe kthimi gjysmërrethor.



Kodi B28 ALFORM (unaza)

Figura 24. Vendosja e shenjës sipas standardit


Shenja B28 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shigjetë e kthyer në të majtë me ngjyrë të zezë.

Vija e pjerrtë me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të shigjetës (është mbi shigjetë).



**B29 - Shenja ndalim kthimi djathtas** - Kjo shenjë tregon vendin ku është i ndaluar kthimi djathtas për të gjitha automjetet në qarkullim.



Kodi B29

ALFORM (unaza)


Figura 25. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B29 ka formë të rumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shigjetë e kthyer në të djathtë me ngjyrë të zezë.

Vija e pjerrtë me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të shigjetës (është mbi shigjetë).

**B30 - Shenja ndalim kthimi gjysmërrethor** - Kjo shenjë tregon vendin ku është i ndaluar kthimi gjysmërrethor për të gjitha automjetet në qarkullim.



Kodi B30

ALFORM (unaza)


Figura 26. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B30 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një shigjetë e kthyer në gjysmërreth (180°) me ngjyrë të zezë.

Vija e pjerrtë me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të shigjetës (është mbi shigjetë).

**B31 - Shenja kufizim i shpejtësisë** - Kjo shenjë tregon vendin ose pjesën e rrugës në të cilën mjetet nuk lejohen të lëvizin më shumë sesa parashihet në shenjë.



Kodi B31

ALFORM (unaza)

Figura 27. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B31 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simbol i shenjës është një shifër pa njësi, por që nënkupton kufizimin e shpejtësisë në km/h dhe është me ngjyrë të zezë. Numri (shifra) në shenjën e paraqitur në këtë material nënkupton shembullin, ndërsa numri (shifra) i vërtetë vendoset sipas rrethanave dhe nevojave të sigurisë së komunikacionit.

Kësaj shenje mund t'i vendoset edhe tabela plotësuese me të cilën tregohet lloji ose masa e mjetit për të cilën vlen kufizimi. Në rastet kur kjo shenjë vendoset nën shenjën e emërimit të vendbanimit, kufizimi vlen për tërë territorin e vendbanimit, vetëm në rast se në ndonjë rrugë apo pjesë të rrugës përcaktohet me ndonjë shenjë tjetër të urdhrave të prera. Shenja vendoset aty ku fillon detyrimi (kufizimi i shpejtësisë).

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave të ndalimit me kode B16-B31;
- Shenjat e ndalimit, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të ndalimit.

Pyetjet:

31. Forma e shenjave të ndalimit nga B16-B31
32. Ngjyrat bazë të shenjave të ndalimit nga B16-B31
33. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode B16-B31
34. Tregoni shenjat e ndalimit nga B16 deri B31.

**B32 - Shenja ndalim tejkalimi për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore** - Kjo shenjë tregon vendin ose pjesën e rrugës ku ndalohet tejkalimi për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore dhe mjeteve të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 30 km/h si dhe mjetet të cilat nuk konsiderohen mjete motorike.




Figura 28. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B32 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës ka të paraqitur pamjen e pasme të veturave. Vetura në anën e djathtë është e paraqitur me ngjyrë të zezë, ndërsa vetura në anën e majtë është e paraqitur me ngjyrë të kuqe.

Kjo shenjë bashkëvepron me shenjat horizontale, vijën e pandërprerë gjatësore. Shenja vendoset në vendin ku fillon detyrimi (ndalimi i tejkalimit).

**B33 - Shenja ndalim tejkalimi për mjetet transportuese - kamionë** - Kjo shenjë tregon vendin ose pjesën e rrugës ku ndalohej tejkalimi për mjetet transportuese. Masa më e madhe e lejuar është mbi 3.5 tonë, përveç motoçikletës pa rimorkio anësore dhe mjetet të cilat në rrugë të rrafshët nuk mund të zhvillojnë shpejtësi më të madhe se 30 km/h si dhe mjetet të cilat nuk konsiderohen mjete motorike.




Figura 29. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B33 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës ka të paraqitur pamjen e pasme të veturës me ngjyrë të zezë, në anën e djathtë, ndërsa në anën e majtë është e paraqitur pamja e pasme e një kamioni me ngjyrë të kuqe.


Shenja vendoset në vendin ku fillon detyrimi (ndalimi i tejkalimit). Shenjës mund t'i vendoset edhe tabela plotësuese ku mund të shënohet masa më e madhe e lejuar në tonë (p. sh., 7 t). Pra, tabela plotësuese tregon për cilat automjete vlen kufizimi.

**B34 - Shenja ndalim kalimi pa u ndalur - Dogana****B35 - Shenja ndalim kalimi pa u ndalur - Policia****B36 - Shenja ndalim kalimi pa pagesë - Pagesa rrugore**

Shenja B34 tregon afërsinë e doganës ku mjete duhet të ndalet.

Shenja B35 tregon afërsinë e policisë ku mjete duhet të ndalet.

Shenja B36 tregon afërsinë e vendpagesës ku mjete duhet të ndalet dhe të bëhet pagesa rrugore.



Kodi B34

ALFORM (unaza)

Kodi B35

Kodi B36

Figura 30. Vendosija e shenjës sipas standardit

Shenjat B34, B35 dhe B36 kanë formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjave janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një vijë horizontale me ngjyrë të zezë e cila nuk është e bashkuar me skajin e kuq të konturit të shenjës. Mbi vijë është shkruar DOGANA, POLICIA, PAGESA RRUGORE, po ashtu edhe nën vijë është shkruar (në gjuhën angleze - Dogana, Policia, Pagesa Rrugore = KOSTOMS, POLICE, PEAGE). Mbishkrimi i këtyre shenjave është me ngjyrë të zezë.

Këto shenja vendosen në vendin ku fillon detyrimi dhe tregojnë arsyen e ndaljes së obliguar.

**B37 - Shenja ndalimi i dhënies së shenjave akustike (zërit)** - Kjo shenjë tregon rrugën ose pjesën e rrugës ku ndalohet dhënia e shenjave akustike, përveç në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë si dhe në rastet emergjente siç janë: kur bëhet transporti i të aksidentuarve dhe të lënduarve rënd.




Figura 31. Vendosja e shenjës sipas standardit



Shenja B37 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një instrument muzikor (Tromboni) me ngjyrë të zezë. Vija e pjerrët me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të instrumentit muzikor (Trombonit).

Shenja vendoset në vendin ku fillon detyrimi. Zakonisht vendoset në qendrat e banuara, pranë shkollave, spitaleve, kopshteve, institucioneve të tjera etj.

**B38 - Shenja përparësi kalimi për mjetet nga kahja e kundërt** - Kjo shenjë tregon ndalimin e hyrjes së mjetit në pjesën e ngushtë të rrugës para se të kalojnë mjetet nga drejtimi i kundërt.




Figura 32. Vendosja e shenjës sipas standardit


Shenja B38 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i bardhë
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simbolet e shenjës janë dy shigjeta me kaheje të kundërta. Shigjeta e anës së djathtë është në drejtim nga poshtë-lart si dhe ka ngjyrë të kuqe, ndërsa shigjeta e anës së majtë është në drejtim nga lart-poshtë dhe ka ngjyrë të zezë.

Zakonisht shenja vendoset tek urat e ngushta, në vendin nga i cili shihet pjesa e rrugës për të cilën ka të bëjë ndalimi. Kjo shenjë ndalon parakalimin e mjeteve me veprim motorik (përpos atyre mjeteve që janë me dy rrota, mirëpo vetëm nëse manovrimi me mjet kryhet brenda shiritit qarkullues). Pra, mjetet mund të parakalohen vetëm në këto raste:

1. Ndalohet parakalimi i mjeteve nga mjetet me dy rrota në lëvizje
2. Mund të bëhet parakalimi i mjeteve pa motor, mirëpo vetëm nëse manovrimi me mjet bëhet brenda shiritit qarkullues apo korsisë së qarkullimit
3. Mund të bëhet parakalimi i mjeteve me dy rrota vetëm nëse manovrimi me mjet bëhet brenda shiritit qarkullues apo korsisë së qarkullimit.

**B39 - Shenja ndalim ndaljeje dhe parkimi** - Kjo shenjë tregon anën e rrugës ku janë të ndaluar ndalja dhe parkimi i mjetit.



Kodi B39

ALFORM (unaza)


Figura 33. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B39 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i kaltër
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simbolet e shenjës janë dy vija të pjerrëta me ngjyrë të kuqe të kryqëzuara njëra me tjetrën.

Kësaj shenje mund t'i vendoset tabela plotësuese në të cilën vizatohen shigjetat paralelisht me aksin e rrugës dhe gjatësinë në metra të cilat tregojnë ndalesën, përkatësisht kufizimin që ka të bëjë vetëm me pjesën e rrugës që tregojnë shigjetat dhe distancën e shënuar pranë tyre. Shenja vendoset aty ku fillon ndalimi. Pra, te kjo shenjë nuk lejohet qëndrimi në anën ku është e vendosur shenja si dhe nuk lejohet ndërprerja e lëvizjes së mjeteve për ta bërë ta mundur hipjen apo edhe zbritjen e udhëtarëve si dhe ndalon edhe frenimin e vullshëm. Kësaj shenje mund t'i vendoset edhe një panel plotësues i cili jep informata shtesë lidhur me shenjën përkatëse apo edhe kohën e vlefshmërinë së kësaj shenje.

**B40 - Shenja ndalim parkimi** - Kjo shenjë tregon anën e rrugës në të cilën është i ndaluar parkimi i mjetit.



Kodi B40

ALFORM (unaza)

Figura 34. Vendosja e shenjës sipas standardit


Shenja B40 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i kaltër
2. Konturi (skaji) i shenjës, i kuq
3. Simboli i shenjës është një vijë e pjerrët me ngjyrë të kuqe.

Kësaj shenje mund t'i vendoset tabela plotësuese në të cilën vizatohen shigjetat paralelisht me aksin e rrugës dhe gjatësinë në metra të cilat tregojnë ndalesën, përkatësisht kufizimin që ka të bëjë vetëm me pjesën e rrugës që tregojnë shigjetat dhe distancën e shënuar pranë tyre. Shenja vendoset aty ku fillon ndalimi.

Vlefshmëria e kësaj shenje në rrugët interurbane është 24 orë, ndërsa në rrugët urbane është nga ora 08:00 deri në orën 20:00. Kjo shenjë duhet të vendoset në mënyrë të përsëritur edhe pas kryqëzimit sepse nëse kjo nuk vendoset pas udhëkryqit, kjo e humbet fuqinë, në të njëjtën kohë kjo shenjë e ndalon edhe pushimin në shiritin qarkullues ku është vendosur.

**B41 - Shenja ndalim parkimi alternativ** -Kjo shenjë tregon anën e rrugës ku është i ndaluar parkimi në ditët tek.



Kodi B41

ALFORM (unaza)

Figura 35. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B41 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i kaltër
2. Konturi (skaji) i shenjës dhe vija e pjerrtë janë me ngjyrë të kuqe, kurse dy pjesët e tjera janë me ngjyrë të kaltër
3. Simboli i shenjës është një vijë vertikale me ngjyrë të bardhë.

Vija e pjerrtë me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të vijës së bardhë vertikale. Ditët tek janë ditët sipas kalendarit mujor 1, 3, 5.....31. Shenja vendoset aty ku fillon ndalimi.

**B42 - Shenja ndalim parkimi alternativ** - Kjo shenjë tregon anën e rrugës në të cilën është i ndaluar parkimi alternativ në ditët çift.




Figura 36. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B42 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i kaltër
2. Konturi (skaji) i shenjës dhe vija e pjerrtë janë me ngjyrë të kuqe, kurse dy pjesët e tjera janë me ngjyrë të kaltër
3. Simbole të shenjës janë dy vija vertikale me ngjyrë të bardhë.

Vija e pjerrtë me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të vijave të bardha vertikale. Ditët çifte janë ditët sipas kalendarit mujor 2, 4, 6.....30. Shenja vendoset aty ku fillon ndalimi.

**B43 - Shenja ndalim fotografimi, incizimi, skicimi e të ngjashëm** - Kjo shenjë tregon hapësirën pranë rrugës në të cilën janë të ndaluar fotografimi, incizimi, skicimi e të ngjashëm.




Figura 37. Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B43 ka formë të rrumbullakët. Ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Sfondi i kaltër
2. Konturi (skaji) i shenjës dhe vija e pjerrtë janë me ngjyrë të kuqe
3. Simboli i shenjës është forma e aparatit fotografues me ngjyrë të zezë.

Vija e pjerrtë me ngjyrë të kuqe paraqet ndalimin dhe e mbulon një pjesë të simbolit të shenjës. Shenja vendoset në vendin ku fillon detyrimi (ndalimi). Zakonisht vendoset në hyrje të objekteve të rëndësisë së veçantë, institucioneve, kazermave ushtarake, ambasadave etj.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave të ndalimit me kode B32-B43;
- Shenjat e ndalimit, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave të ndalimit.

Pyetjet:

35. Forma e shenjave të ndalimit nga B32-B43
36. Ngjyrat bazë të shenjave të ndalimit nga B32-B43
37. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode B32-B43
38. Tregoni shenjat e ndalimit nga B32 deri B43




## 1.2.4 SHENJAT E DETYRIMIT

Këto shenja na urdhërojnë lëvizjen e detyruar të mjeteve sipas simboleve të tyre. Shenjat e detyrimit kanë formë të rrumbullakët, sfondi i shenjës është ngjyrë e kaltër, ndërsa simboli i shenjës është me ngjyrë të bardhë. Ngjyrat bazë të të gjitha shenjave të detyrimit në përputhje me standardet evropiane janë dy:


- Fusha e shenjës është e kaltër apo (sfondi i kaltër);
- Simboli i shenjës është i bardhë.

Në vazhdim do ta shohim mënyrën e vendosjes teknike të këtyre shenjave në rrugë sipas standardeve dhe rangut të rrugës.

Forma rrethore e detyrimit në cm		
	C	D
E vogël	0.8	40
Normale	1	60
E madhe	1.5	90


**B44 - Shenja e detyrimit: shpejtësia më e vogël e lejuar**







ALFORM (unaza)




Kodi B44



ALKANT (unaza)



ALFORM (unaza)



Tubi




Figura 38. Vendosija e shenjës sipas standardit

Shenja tregon rrugën ose pjesën e rrugës në të cilin mjetet në kushte normale duhet të lëvizin me shpejtësi 40 (km/h), por edhe duke mos e kaluar kufirin maksimal të kësaj shpejtësie prej 40 (km/h), e cila është e përcaktuar me shenjë.

1. Shenja B44 ka formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër
2. Si shenjë simboli janë dy shifra (numër), të cilat tregojnë shpejtësinë më të vogël që duhet zhvilluar automjeti në atë rrugë
3. Numri në shenjën e paraqitur me poshtë është dhënë vetëm si shembull.


Shpejtësia më e vogël e lejuar përcaktohet varësisht kushteve të rrugës dhe sigurisë së komunikacionit. Shenja mund të vlejë për një ose më shumë shirita qarkullues (korsi), mirëpo zakonisht kjo shenjë vendoset në autostrada. Pra, kjo shenjë e qarkullimit ndalon mjetet të cilat nuk janë në gjendje ta zhvillojnë këtë shpejtësi.

Paneli plotësues i shenjave rrethore me dimensione në cm

	A	B	C	D	R
E Vogël	33	0.3	0.6	17	2
Normale	50	0.4	0.8	25	3
EMadhe	75	0.5	1	33	4

Figura 39. Paneli plotësues i shenjave rrethore me dimensione në cm

**B45 - Shenja e detyrimit për pajisje dimërore** - Kjo shenjë tregon pjesën e rrugës në të cilën mjetet motorike, përveç motoçikletave, duhet të kenë pajisje dimërore të parapara gjatë kushteve dimërore.



Vendosja e shenjës sipas standardit

Kodi B45

ALFORM (unaza)


Shenja B45 ka formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër. Si shenjë simboli është forma e rrotës së automjetit me ngjyrë të bardhë, kurse disqet dhe mbështjellja e rrotës me zinxhirë janë me ngjyrë të zezë. Shenja vendoset në vendin ku fillon detyrimi dhe detyron ta kufizojmë shpejtësinë e lëvizjes dhe të lëvizim me kujdes të shtuar. Kjo shenjë gjendet në ato rrugë të cilat janë të mbuluara nga bora apo akulli, dhe tregon vendosjen e detyruar të zinxhirëve ose të gomave për borë.

### **B46 - Shenja e detyrimit të shtegut për biçikleta**

Kjo shenjë tregon shtegun në të cilin duhet të lëvizin biçikletat.



Kodi B46



Vendosja e shenjës sipas standardit


Shenja B46 ka formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltra. Simboli është forma e biçikletës me ngjyrë të bardhë. Shenja vendoset në shtegun në të cilin mund të lëvizet vetëm me biçikleta. Kjo shenjë vendoset në vendin ku fillon shtegu i biçikletave, mirëpo tregon edhe vazhdimin e një korsie e cila është e rezervuar vetëm për biçikleta.

### **B47 - Shenja e detyrimit të shtegut për këmbësorë**

Kjo shenjë tregon shtegun në të cilin duhet të lëvizin këmbësorët.



Kodi B47



Vendosja e shenjës sipas standardit


Shenja B47 ka formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltra. Simboli i shenjës është forma e këmbësorëve me ngjyrë të bardhë, ku njëri këmbësor është i moshës madhore, ndërsa tjetri fëmijë. Shenja vendoset në vendin ku fillon shtegu i këmbësorëve. Shenja vendoset në shtegun në të cilin lejohet vetëm lëvizja e këmbësorëve, kurse ndalohet lëvizja e pjesëmarrësve të tjerë të komunikacionit.

### **B48 - Shenja e detyrimit të shtegut për këmbësorë dhe biçikleta**

Kjo shenjë tregon shtegun e këmbësorëve dhe të biçikletave, në të cilin këmbësorët dhe biçiklistët duhet të lëvizin, ndërsa u ndalohe lëvizja pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion.



Kodi B48



Vendosja e shenjës sipas standardit

Me vijë të bardhë në sipërfaqen e shtegut është e ndarë sipërfaqja për këmbësorë nga sipërfaqja për biçikleta.

Shenja B48 ka formë të rrumbullakët, kurse ngjyrat bazë të shenjës janë:

1. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër
2. Është forma e biçikletës dhe e këmbësorëve me ngjyrë të bardhë të ndara në mes me vijë vertikale të bardhë
3. Shenja vendoset në vendin ku fillon shtegu i këmbësorëve dhe çiklistëve.


Në shenjën e paraqitur më poshtë simbolet e paraqitura janë: biçikleta në anën e majtë, ndërsa këmbësorët në anën e djathtë. Simbolet në shenjë në të kundërt duhet të vendosen sipas shtegut të dedikuar për çiklistë apo për këmbësorë, varësisht nga krahu që u është dedikuar.

### **B49 - Shenja e detyrimit të shtegut për kalorës**

Kjo shenjë tregon shtegun në të cilin duhet të lëvizin kalorësit, ndërsa u ndalohet lëvizja pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion.




Kodi B49



Vendosja e shenjës sipas standardit

Shenja B49 ka formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër. Shenja vendoset në vendin ku fillon shtegu i kalorësit. Si shenjë simboli është forma e kalit së bashku me kalorësin me ngjyrë të bardhë.





**B50, B51, B52, B53, B54, B55 - Shenja të detyrimit të drejtimit të obliguar**

Këto shenja tregojnë drejtimet në të cilat mjetet duhet të lëvizin në trafik.




Kodi B50



Kodi B51



Kodi B52



Vendosja e shenjave sipas standardit



Kodi B53



Kodi B54



Kodi B55

Shenjat B50, B51, B52, B53, B54 dhe B55 kanë formë të rrumbullakët dhe vendosen para vendit ku fillon obligimi për kthimin e mjetit. Ngjyra bazë e shenjës është e kaltër. Si shenjë simboli janë format e shigjetave me ngjyrë të bardhë. Këto lloje të shenjave vendosen në kryqëzim.

### **B56, B57, B58 - Shenja të detyrimit të drejtimeve të lejuara**

Këto shenja tregojnë drejtimet në të cilat mjetet lejohen të lëvizin në trafik.




Kodi B56



Kodi B57



Kodi B58



Vendosja e shenjave sipas standardit

Shenjat B56, B57 dhe B58 kanë formë të rrumbullakët. Ngjyra bazë e shenjave është e kaltër. Si shenja të simbolit janë format e dy shigjetave të lidhura në formë të shkronjës (T) dhe (Y) me ngjyrë të bardhë. Shigjetat tregojnë drejtimet në të cilat mund të lëvizë mjeti. Vendosen në vendin ku fillon drejtimi i lejuar.

**B59, B60, B61, B62 - Shenja të detyrimit të anashkalimit të obliguar nga ana e djathtë, majtë dhe me rrethrotullim**

Këto shenja tregojnë rrugën ose pjesën e rrugës në të cilën mjetet duhet të lëvizin gjatë anashkalimit të ishullit të këmbësorëve, ishullit për orientimin e trafikut dhe objekteve të tjera në rrugë ose të lëvizin në rrethrotullim.



Kodi B59




Kodi B60



Kodi B61



Kodi B62



Vendosja e shenjave sipas standardit

Shenjat vendosen në maje ose skaje të ishullit të këmbësorëve, përkatësisht ishujt për orientimin e trafikut ose para objekteve të tjera në rrugë. Shenjat B59, B60, B61 dhe B62 kanë formë të rumbullakët. Ngjyra bazë e shenjave është e kaltër. Si shenja të simbolit janë format e shigjetave të cilat tregojnë drejtimin që duhet të marrë automjeti.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave të detyrimit me kode B45-B62;
- Shenjat detyruese, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave detyruese.

Pyetjet:

39. Forma e shenjave detyruese nga B45-B62
40. Ngjyrat bazë të shenjave detyruese nga B45-B62
41. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave me kode B45-B62
42. Tregoni shenjat detyruese nga B45 deri B62

### 1.2.5 SHENJAT E LAJMËRIMIT

Shenjat e lajmërimit pjesëmarrësve në trafik u japin lajmërimet të nevojshme për rrugën nëpër të cilën lëvizin, emërtimet e vendeve nëpër të cilat kalon rruga dhe distancën deri tek ato vende, ndërprerjen e vlefshmërisë së shenjave të urdhrave të prera dhe lajmërimet e tjera të cilat mund t'i shfrytëzojnë. Shenjat e lajmërimit kanë formën e katrorit, të katërkëndëshit ose të rrethit. Ngjyra bazë e shenjave të lajmërimit ndahet në tri lloje:

1. E kaltër, kurse simboli dhe mbishkrimi janë me ngjyrë të bardhë, të gjelbër ose të kuqe;
2. E gjelbër, kurse simboli dhe mbishkrimi janë me ngjyrë të bardhë;
3. E bardhë, kurse simboli dhe mbishkrimi kanë ngjyrë të zezë, të kuqe ose të kaltër.

Ngjyra e shenjave për orientimin e përkohshëm të trafikut, shiritat për mbulimin e shenjës si dhe rregullimi i trafikut me dorë, kanë ngjyrë të portokalltë. Mënyrën e vendosjes së shenjave të lajmërimit do ta paraqesim në vazhdim. Për shpejtësi (km/h) të caktuara do të paraqesim edhe madhësinë e shenjës përkatëse.

Tabela 6. Madhësia e shenjave të trafikut

		Madhësia 1 (70 %)	Madhësia 2 (100 %)	Madhësia 3 (125% deri 140 %)
Disqet	∅	420	600	750 (125 %)
Trekëndëshat	SL	630	900	1260 (140 %)
Katrori	SL	420	600	840 (140 %)
Drejtëndësh	H x B	630 x 420	900 x 600	1260 x 840 (140 %)
Te gjitha shifrat ne	mm	mm	mm	mm








70 % 	100 % 	125 % 
$\emptyset = 420 \text{ mm}$	$\emptyset = 600 \text{ mm}$	$\emptyset = 750 \text{ mm}$
70 % 	100 % 	140 % 
SL = 630 mm	SL = 900 mm	SL = 1260 mm
H = 231 mm   H = 315 mm   H = 420 mm	H = 330 mm   H = 450 mm   H = 600 mm	H = 412 mm   H = 562 mm   H = 750 mm

Figura 40. Madhësia e shenjave të trafikut në mm dhe %






Figura 41. Madhësia e shenjave të trafikut në mm dhe %




Figura 42. Vendosija e shenjave të trafikut në m<sup>2</sup>

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Madhësia 1, 2, 3 e shenjave të trafikut për (70 %, 100 %, 125 % deri 140 %);
- Vendosja e tyre, lartësia e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave.

Pyetjet:

43. Disqet dhe madhësia 1, 2, 3 për (70 %, 100 %, 125 % deri 140 %)
44. Trekëndëshat e madhësisë 1, 2, 3 për (70 %, 100 %, 125 % deri 140 %)
45. Katrori dhe madhësia 1, 2, 3 për (70 %, 100 %, 125 % deri 140 %)
46. Drejtkëndëshi dhe madhësia 1, 2, 3 për (70 %, 100 %, 125 % deri 140 %)
47. Të gjitha shifrat në mm.



Tabela 7. Diametri i rrethit të shenjave të lajmërimit është

Lloj i Rrugës	Gjerësia e Rrugës	Madhësia e Shenjës (D)	Largësia e Vendosijes së Shenjës	Kujdes
<b>Shenja rrethore</b>				
Ne Autostradë dhe Rruge të rezervuar për komunikacion, në rrugë në vendbanim që nuk janë në lagje.	Mbi 7.0 m	90 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	Në qoftë se tereni, objekti apo lokacioni të cilën e lajmëron shenja nuk ndodhet në atë rrugë që është e vendosur shenja, atëherë me tabelë plotësuese ose ne vetë shenjën duhet të lajmërohet objekti, lokacioni apo tereni te cilin ka të bëjë shenja.
Në rrugët kryesore urbane dhe me gjerësinë e cekur në këtë tabelë	5.0 – 7.0 m	60 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	
Në tunele dhe galeri	///	60 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	
Në të gjitha rrugët tjera dhe rrugët urbane	///	40 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	

Tabela 8. Madhësia e brinjës së katrorit të shenjës së lajmërimit është

Lloj i Rrugës	Gjerësia e Rrugës	Madhësia e Shenjës (D)	Largësia e Vendosijes së Shenjës	Kujdes
<b>Shenja katrore</b>				
Ne Autostradë dhe Rruge të rezervuar për komunikacion, në rrugë në vendbanim që nuk janë në lagje.	Mbi 7.0 m	90 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	Në qoftë se tereni, objekti apo lokacioni të cilën e lajmëron shenja nuk ndodhet në atë rrugë që është e vendosur shenja, atëherë me tabelë plotësuese ose ne vetë shenjën duhet të lajmërohet objekti, lokacioni apo tereni te cilin ka të bëjë shenja.
Në rrugët kryesore urbane dhe me gjerësinë e cekur në këtë tabelë	5.0 – 7.0 m	60 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	
Në tunele dhe galeri	///	60 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	
Në të gjitha rrugët tjera dhe rrugët urbane	///	40 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	

Tabela 9. Madhësia e brinjës së katërkëndëshit të shenjave të lajmërimit është


Lloji i Rrugës	Gjerësia e Rrugës	Madhësia e Shenjës (D)	Largësia e Vendosjes së Shenjës	Kujdes
<b>Shenja katërkëndëshe</b>				
Ne Autostradë dhe Rruge të rezervuar për komunikacion, në rrugë në vendbanim që nuk janë në lagje.	Mbi 7.0 m	90 x 135 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	Në qoftë se tereni, objekti apo lokacioni të cilin e lajmëron shenja nuk ndodhet në atë rrugë që është e vendosur shenja, atëherë me tabelë plotësuese ose ne vetë shenjën duhet të lajmërohet objekti, lokacioni apo tereni të cilin ka të bëjë shenja.
Në rrugët kryesore urbane dhe me gjerësinë e cekur në këtë tabelë	5.0 – 7.0 m	60 x 90 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	
Në tunele dhe galeri	///	60 x 90 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	
Në të gjitha rrugët tjera dhe rrugët urbane	///	40 x 60 cm	Në vendin ku fillon lajmërimi	

Pra, shenjat e trafikut i lajmërojnë pjesëmarrësit në trafik për:

1. Kahun e lëvizjes
2. Rreshtimin e mjetit
3. Kthimin djathtas apo majtas
4. Shënimin e objekteve
5. Terrenin
6. Rrugët apo pjesët e rrugëve për të cilat bëhet fjalë.

Mirëpo nëse tereni apo objekti i cili është lajmëruar nuk gjendet në rrugën ku është vendosur shenja, atëherë është e nevojshme që ky informacion i nevojshëm të jepet me anë të tabelës plotësuese ose me shenjën e vet përkatëse ashtu që pjesëmarrësve në trafik t'u mundësohet gjetja e objekteve shpejt dhe lehtë, posaçërisht terrenin për të cilin ka të bëjë shenja.

Tabela 10. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform

 Kodi C01	Kuptimi	Madhësia a mm	Alkant			Alform			
			RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C	RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C	
			WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44	
		420 420	x	88	134	159	120	139	168
		600 600	x	100	143	176	112	155	188
		840 840	x	212	314	388	215	317	391

Shenjat vendkalimi i shënuar për këmbësorë C02 dhe vendkalimi i shënuar për shtegun e biçikletave C03 tregojnë vendin në rrugë në të cilin gjendet vendkalimi i shënuar për këmbësorë, përkatësisht vendkalimi i shtegut për biçikleta:

Shenja punohet së paku me klasë të dytë retroreflektive. Këto shenja vendosen drejtpërsëdrejti para vendkalimit të shënuar për këmbësorë, përkatësisht biçikletave.

Pajisjet e kalimeve për këmbësorë, si dhe ndriçim vertikal për një gjerësi të mbikalimit deri në 6.50 metra.

Pajisjet e kalimeve për këmbësorë, si dhe ndriçim vertikal për një gjerësi të mbikalimit deri në 8.50 metra.

Rregullimi i dyanshëm i shenjave të komunikacionit dhe transparent me ndriçim në FGÛ në gjerësinë e rrugës deri në 8.50 metra.


Për të gjitha ndriçimet vertikale të ilustruara, kjo kërkesë është marrë parasysh. Kjo shenjë është punuar transparente, me qendër të vëmendjes së integruar. Është projektuar si një shenjë trafiku e brendshme, e dyfishtë (350-40), ose e njëanshme (350-10 ose 350-20 për rregullimin në korsi të veçantë).



Kodi C02



Kodi C03



**Ndriçim vertikal, duke filluar nga vetëm një qendër e vëmendjes**

**Ndriçim vertikal, duke filluar nga vetëm një qendër e vëmendjes**

**Deri në 8.5 metra**

Rregullimi i dyanshëm i shenjave të komunikacionit dhe transparent me ndriçim në kalimin e këmbësorëve në gjerësinë e rrugës deri në 8.50 m

Rregullimi i shenjave të komunikacionit dhe transparenta me ndriçimin në kalimin e këmbësorëve me ishujt mbrojtës të këmbësorëve

Figura 43. Ndriçim vertikal, duke filluar nga vetëm një qendër e vëmendjes





Figura 44. Mënyra e vendosjes së shenjës së vendkalimit të këmbësorëve me ndriçim

Transparenca e kalimit të këmbësorëve arrin funksionalitet të lartë përmes ndriçimit optimal të kalimit për këmbësorë dhe mirëdashmërisë së shërbimit. Projektimi përmes integritit të vëmendjes në transparente.

Shenja “fëmijët në rrugë” C04 tregon vendin në rrugë në të cilin fëmijët lëvizin shpesh ose në numër të madhe (p. sh., para shkollave, fushave sportive, çerdheve të fëmijëve, hapësirave të ngjashme). Kjo shenjë punohet së paku me klasë të II-të retrorefleksive. Shenja nënkalim ose mbikalim për këmbësorë C05 vendoset vetëm drejtpërsëdrejti para vendit të shënuar për këmbësorë, përkatësisht mbi të.



Kodi C04



Kodi C05

Shenja e rrugës së komunikacionit në një drejtim C06 dhe C07 paralajmërojnë pjesëmarrësit në komunikacion për rrugën njëdrejtimëshe. Shenja vendoset përgjatë rrugës me komunikacionin njëdrejtimësh, në vendin në të cilën shoferi i cili lëviz rrugës, përkatësisht i cili hynë në rrugën njëdrejtimëshe, është e nevojshme të lajmërohet për komunikacion njëdrejtimësh. Shenja C06 vendoset ashtu që shigjeta është në pozitë vertikale përgjatë aksit të rrugës, ndërsa shenja C07 ashtu që shigjeta është tërthorazi me aksin gjatësor të rrugës.



Kodi C06



Kodi C07

Shenja e rrugës me përparësi kalimi C08 tregon rrugën ose pjesën në të cilën mjetet kanë përparësi kalimi ndaj mjeteve të cilat lëvizin në rrugën e cila kryqëzohet me atë rrugë ose pjesën e saj. Shenja ka katrorin me ngjyrë të verdhë, ndërsa hapësira ndërmjet katrorit të brendshëm dhe skajit të jashtëm

të shenjës është me ngjyrë të bardhë. Shenja vendoset, sipas rregullave, në rrugët kryesore në vendbanim dhe në hyrje të vendbanimit, para kryqëzimit.






Figura 45. Forma katrore e vendosur vertikalisht në cm



Shenja e mbarimit të rrugës me përparësi kalimi C09 tregon vendin në të cilin përfundon rruga ose pjesa e rrugës me përparësi kalimi. Shenja e katrorin me ngjyrë të verdhë, ndërsa hapësira ndërmjet katrorit të brendshëm dhe skajit të jashtëm të shenjës është me ngjyrë të bardhë.

Shenja e gungës në rrugë C10 tregon vendin ku vendosen pajisjet për

qetësimin (ngadalësimin) e komunikacionit. Shenja punohet së paku me klasë të dytë retrorefleksive.



Kodi C10

Shenja e mbarimit të tejkalimit C11 tregon vendin ku mbaron ndalimi i tejkalimit për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore. Shenja vendoset në vendin ku mbaron ndalimi i tejkalimit për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletave pa rimorkio anësore.



Kodi C11



Kodi C13



Kodi C12

Shenja e ndalimit të tejkalimit për mjetet transportuese - kamionëve C12 - tregon vendin ku mbaron ndalimi i tejkalimit të mjeteve transportuese me masën më të madhe të lejuar mbi 3.5 tonë. Shenja vendoset në rrugë në vendin prej ku mbaron ndalimi i tejkalimit për mjetet transportuese.

Shenja e mbarimit të kufizimit të shpejtësisë C13 tregon vendin ku mbaron kufizimi i shpejtësisë, ndërsa shenja e mbarimit të shpejtësisë më të vogël të lejuar C14 tregon vendin ku mbaron shpejtësia më e vogël e lejuar.



Shpejtësia e dhënë në figurë është marrë vetëm si shembull. Kjo shenjë vendoset në rrugë në vendin ku mbaron kufizimi i shpejtësisë.



Kodi C14



Kodi C15



Kodi C16

Shenja e mbarimit të ndalimit të dhënies së shenjave akustike - zërit C15 - tregon vendin ku mbaron ndalimi i dhënies së shenjave akustike.

Shenja e mbarimit të të gjithave ndalesave C16 tregon vendin në rrugë ku mbarojnë të gjitha ndalesat në atë rrugë.

Shenja e mbarimit të ndalimit të përdorimit të pajisjeve dimërore C17, shenja e mbarimit të shtegut për biçikleta C18, shenja e mbarimit të shtegut për këmbësorë C19 dhe mbarimi i shtegut për kalorës C20 tregojnë vendet në rrugë ku mbarojnë ndalimet e caktuara të parapara me shenjat e komunikacionit të cilat janë të vendosura në ato rrugë.



Kodi C17



Kodi C18



Kodi C19



Kodi C20

Shenja e zonës ku është e kufizuar shpejtësia C21 tregon hapësirën, përkatësisht zonën në të cilën mjetet nuk lejohen të lëvizin (km/h) më shumë sesa që parashihet me shenjë.

Shenja e mbarimit të zonës ku është e kufizuar shpejtësia C22 tregon vendin ku mbaron kufizimi i shpejtësisë. Shenja përbëhet nga vënia e shenjave përkatëse dhe është e kryqëzuar me pesë vija të pjerrëta me ngjyrë të zezë.



Kodi C21




Kodi C22



Kodi C23

Shenja e zonës së këmbësorëve C23 tregon hapësirën e paraparë për lëvizjen e këmbësorëve, kurse u ndalohet lëvizja të gjitha mjeteve me veprim motorik.

Shenja e mbarimit të zonës së këmbësorëve C24 tregon vendin ku mbaron zona e këmbësorëve.



Kodi C24


Kodi C25

Kodi C26

Shenja e zonës së komunikacionit të qetë C25 tregon vendin në vendbanim në të cilin nuk lejohet të lëvizet më shpejt se shpejtësia e këmbësorëve sepse janë të lejuara lojërat e fëmijëve në zonë.

Shenja e mbarimit të zonës së komunikacionit të qetë C26 tregon vendin ku dilet nga zona e komunikacionit të qetë.

Shenja e zonës së kufizimit të kohëzgjatjes së parkimit C27 tregon vendin në vendbanim ku hynë në zonën në të cilën është i paraparë kufizimi i përgjithshëm i kohëzgjatjes së parkimit në kohë të caktuar, pa marrë parasysh se është me pagesë ose kompensim për parkim në kohë të caktuar apo jo. Shenjës mund t'i bashkëngjitet tabela plotësuese në të cilën tregohen ditët ose orët për të cilat vlen kufizimi.



Kodi C27

Kodi C28

Shenja e mbarimit të zonës ku është kufizuar kohëzgjatja e parkimit C28 tregon vendin në vendbanim ku del nga zona në të cilën është i paraparë

kufizimi i përgjithshëm i kohëzgjatjes së parkimit në kohë të caktuar. Shenja përbëhet nga vënia e shenjës përkatëse të komunikacionit dhe është e kryqëzuar me pesë shirita të pjerrët me ngjyrë të zezë.

Shenja e shpejtësisë së rekomanduar C29 tregon shpejtësinë e cila rekomandohet në pjesën e caktuar të rrugës. Shpejtësia në shenjë është e dhënë si shembull.



Shenja e mbarimit të shpejtësisë së rekomanduar C30 tregon vendin ku mbaron rekomandimi i shpejtësisë në pjesën e caktuar të rrugës. Shpejtësia në shenjë është e dhënë si shembull.

Shenja e patrullës shkollore C311 lajmëron shoferët për afërsinë e vendit ose vendin në të cilën pjesëtarët e njësive shkollore të komunikacionit sigurojnë kalimin e fëmijëve përtej rrugës ose në vendkalimin e shënuar për këmbësorë.




Figura 46. Dimensionet e shenjës katror në cm

Shenja C32 tregon afërsinë e spitalit dhe i paralajmëron shoferët që me mjet mos të krijojnë zhurmë të madhe.



Kodi C32



Kodi C33



Kodi C34

Shenja e institucionit të ndihmës së shpejtë mjekësore C33 tregon afërsinë ose vendin në të cilën gjendet institucioni i ndihmës së shpejtë mjekësore. Simboli në shenjë është me ngjyrë të zezë, ndërsa shenja e stacionit policor C34 tregon afërsinë ose vendin ku gjendet stacioni policor. Shenja e parkimit C35, e garazhit C36, e parkimit me kohë të kufizuar C37

tregojnë hapësirat e përcaktuara, posaçërisht të ndërtuara për parkimin e mjeteve, përkatësisht grazhdimin e mjeteve. Në shenjën C35 ose në tabelën plotësuese me simbole përkatëse ose mbishkrime mund të tregohet drejtimi ku gjendet parkimi, distanca në metër deri te parkimi, kategoria e mjeteve për të cilat është paraparë parkimi dhe mundësia e kufizimit të kohëzgjatjes së parkimit C37.




Kodi C35

Kodi C36

Kodi C37

Shenja C38 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet kabina e telefonit. Nëse shenja vendoset në tunel, nën fushën e bardhë shkruhet mbishkrimi SOS, ndërsa shenja tjetër C39 tregon afërsinë e vendit ku gjendet pika e karburanteve.



Kodi C38

Kodi C39

Kodi C40



Kodi C41



Kodi C42



Kodi C43

Shenja C40 tregon afërsinë e vendit ose vendin në të cilën mund të merren informata të nevojshme (turistike etj.).

Shenja C41 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet hoteli ose moteli.

Shenja C42 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet restoranti.

Shenja C43 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet uji i pijshëm.

Shenja C44 tregon vendin ku gjendet vendndalja e autobusit. Shenja vendoset në pjesën dalëse të vendndaljes, e cila është paralelisht me aksin gjatësor të rrugës, shikuar në drejtim të lëvizjes.



Kodi C44



Kodi C45



Kodi C46



Kodi C47



Kodi C48



Kodi C49

Shenja C45 tregon vendin ku gjendet vendndalja e tramvajit. Shenja vendoset në pjesën dalëse të vendndaljes e cila është paralelisht me aksin gjatësor të rrugës, shikuar në drejtim të lëvizjes.

Shenja C46 tregon vendin ku gjendet vendndalja e taksistëve. Shenja vendoset në pjesën dalëse të vendndaljes e cila është paralelisht me aksin gjatësor të rrugës, shikuar në drejtim të lëvizjes.

Shenja C47 tregon afërsinë e aeroportit ose vendin e aeroportit.

Shenjat C48 dhe C49 tregojnë afërsinë e portit, limanit, përkatësisht trajektit, ose vendet ku gjenden porti, limani ose trajekti.

Shenja C50 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet porti për lundrime turistike dhe sportive.

Shenja C51 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet kafeneja.

Shenja C52 tregon vendi për lëshimin e ujërave të mbeturinave (të ndotura, të zeza etj.) nga mjeti për kamping.



Kodi C50



Kodi C51



Kodi C52





Kodi C53



Kodi C54



Kodi C55

Shenja C53, terreni për kamping nën shator; C54 terreni për kamping me rimorkio; C55, terreni për kamping në mjet, tregojnë afërsinë e terrenit ose terrenin e ndërtuar për kamping nën shator, qëndrimin në rimorkio ose në mjet. Shenjat mund të kombinohen ndërmjet vete sipas destinimit të terrenit për kamping.

Shenja C56 shënon afërsinë e terrenit ose terrenin e ndërtuar për piknik.

Shenja C57 shënon afërsinë e vendit ose vendin ku gjenden shtëpitë malore dhe terrenin e ndërtuar për piknik.

Shenja C58 na tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet aparati për shuarjen e zjarrit ose shërbimi i zjarrfikëseve. Nëse shenja vendoset para shërbimit të zjarrfikësve, nën fushën e bardhë shkruhet zjarrfikësit. Simboli në shenjë është me ngjyrë të kuqe.



Kodi C56



Kodi C57



Kodi C58



Kodi C59



Kodi C60



Kodi C61

Shenja C59 tregon afërsinë e vendit ose vendin ku gjendet shërbimi për afrimin e ndihmës në rast të defektit në mjet.

Shenja C60 tregon afërsinë e vendit ku gjendet punëtorja për riparimin e mjetit. Shenja C61 tregon afërsinë e vendit ku gjendet autolarja.

Shenja C62 tregon afërsinë e vendit ku gjenden WC-të publike.



Kodi C62



Kodi C63

Shenja punëtorja për riparimin e gomave C63 tregon afërsinë e vendit ku gjendet punëtorja për riparimin e gomave.





Figura 47. Shenja e formës drejtëndëshe në cm

Shenja C64 tregon hapësirën ku mund të dëgjohet radiostacioni për gjendjen e rrugëve. Emërtimi dhe frekuencat e vendit janë të shënuara në shenjë.



Shenja C65 tregon vendin në rrugë, e cila shtrihet nën hapësirën e mbrojtjes së ujit, në të cilën shoferët duhet të jenë të kujdesshëm. Simboli në shenjë është me ngjyrë të portokalltë, përkatësisht aksi i mjetit me ngjyrë të zezë, dy vija valore me ngjyrë të kaltër.

Shenja C66 tregon vendin kur fillon autostrada.

Shenja C67 tregon vendin ku përfundon autostrada.




Figura 48. Shenja e formës katërkëndëshe


Shenja C68 tregon vendin ku fillon rruga e rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike - rruga e shpejtë.



Kodi C68

Kodi C69

Shenja C69 tregon vendin ku mbaron rruga e rezervuar për komunikacion të mjeteve motorike - rruga e shpejtë. Shenja është e kryqëzuar me vijë të pjerrtë me ngjyrë të kuqe.



Kodi C70

Kodi C71

Shenja C70 tregon afërsinë dhe pozitën e rrugës e cila nuk ka dalje. Pozita e simbolit në shenjë duhet t'i përgjigjet pozitës reale të rrugës pa dalje ndaj rrugës në të cilën vendoset shenja.

Shenja C71 tregon rrugën në të cilën mjeti duhet të lëvizë deri te ky kryqëzim. Shenja vendoset në kryqëzimin e parë para atij në të cilën është i ndaluar kthimi majtas. Shenja e vendit për ndalje të dhunshme të mjetit tregon vendin ose afërsinë e vendit në të cilën është e ndërtuar sipërfaqja e veçantë në rrugë për ndalje të dhunshme. Shenja vendoset në fillim të zgjerimit në 250 metra, por mundet edhe në 150 metra para vendit të shënuar.

Shenja C72 ka mbishkrimin SOS në shtresën e kuqe.



Kodi C72



Kodi C73

Shenja C72 vendoset në zgjerimin në të cilën gjendet SOS telefoni, kurse shenja C73 vendoset në zgjerimin në afërsi të së cilës nuk ka SOS telefon. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja.

Shenja C74 tregon qafëmalin me lartësi mbidetare. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja.



Kodi C74



Kodi C75

Shenja C75 tregon emrin e lumit përtej të cilit kalon rruga. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja, kurse shenja C76 dhe C 77 tregojnë emrin dhe gjatësinë e objekteve rrugore me rëndësi të veçantë tunel, viadukt. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugës në të cilën vendoset shenja.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Diametri i rrethit të shenjave të lajmërimit nga C11-C20;
- Madhësia e brinjës të katrorit të shenjës së lajmërimit është;
- Madhësia e brinjës të katërkëndëshit të shenjave të lajmërimit është.

Pyetjet:

48. Gjerësia e rrugës

49. Madhësia e shenjës


50. Largësia e vendosjes së shenjës

51. Kodi i këtyre shenjave

## 1.2.6 SHENJA TË TJERA DHE TABELAT PLOTËSUESE


Këto shenja kanë forma të ndryshme dhe japin informacione të ndryshme, sidomos për parkim. Në vazhdim do t'i tregojmë disa shembuj të mënyrës së rregullimit të parkimit.

Tabela 11. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform

 Kodi C35	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform		
			RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
			WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
Vendparkimi i cili tregon zonën për ndaljen e mjeteve për kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur jepen udhëzime të tjera.	420	X	88	134	159	120	139	168
	420							
	600	X	100	143	176	112	155	188
	600							
	840	X	212	314	388	215	317	391
	840							

Kjo shenjë mund të shoqërohet edhe me panelet plotësuese siç do t'i tregojmë në vazhdim.

Tabela 12. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform

 Kodi C35 Kodi E20	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform		
			RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
			WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
Vendparkimi i cili tregon zonën për ndalimin e mjeteve për kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur jepen udhëzime të tjera.	420	X	88	134	159	120	139	168
	420							
	600	X	100	143	176	112	155	188
	600							
	840	X	212	314	388	215	317	391
	840							

Shenja e parkimit e shoqëruar me panelet plotësuese përkatëse.



Tabela 13. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C35 Kodi E18	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform			
			Vendparkim i cili tregon zonën për ndalimin e mjetit për kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur jepen udhëzime të tjera.	RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
				WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
		420	X	88	134	159	120	139	168
		420							
		600	X	100	143	176	112	155	188
		600							
		840	X	212	314	388	215	317	391
		840							

Tabela 14. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C35 Kodi E29	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform			
			Vendparkim i cili tregon zonën për ndalimin e mjetit për kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur jepen udhëzime të tjera.	RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
				WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
		420	X	88	134	159	120	139	168
		420							
		600	X	100	143	176	112	155	188
		600							
		840	X	212	314	388	215	317	391
		840							

Tabela 15. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C35 Kodi E24	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform			
			Vendparkim i cili tregon zonën për ndalimin e mjetit për kohë të pacaktuar, përveç rasteve kur jepen udhëzime të tjera.	RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
				WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
		420	X	88	134	159	120	139	168
		420							
		600	X	100	143	176	112	155	188
		600							
		840	X	212	314	388	215	317	391
		840							

Tabela 16. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C36	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform			
	Garazhi tregon hapësirën e cila është e përcaktuar ose posaçërisht e ndërtuar për ndaljen e mjeteve, përkatësisht grazhdimin e mjeteve.			RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
				WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
	420 420	x	88	134	159	120	139	168	
	600 600	x	100	143	176	112	155	188	
	840 840	x	212	314	388	215	317	391	

Tabela 17. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C37	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform			
	Vendpikimi i cili tregon zonën për ndalimin e mjeteve për kohën e pacaktuar me pagesë, përveç rasteve kur jepen udhëzime të tjera.			RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
				WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
	420 420	x	88	134	159	120	139	168	
	600 600	x	100	143	176	112	155	188	
	840 840	x	212	314	388	215	317	391	

Tabela 18. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C35-.....	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform			
	Fillim parkimi dhe Mbarim parkimi			RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
				WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
	420 420	x	88	134	159	120	139	168	
	600 600	x	100	143	176	112	155	188	
	840 840	x	212	314	388	215	317	391	

Tabela 19. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform


 Kodi C35-.....	Kuptimi	Madhësi a mm	Alkant			Alform			
	Mbarim parkimi dhe Fillim parkimi			RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C	RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C
		WG33		WG34	WG45	WG05	WG06	WG44	
		420	x	88	134	159	120	139	168
		420							
		600	x	100	143	176	112	155	188
600									
		840	x	212	314	388	215	317	391
		840							

Tabela 20. Madhësia e shenjës në mm për alkant dhe alform





 Kodi C35-.....	Kuptimi	Madhësi a mm	Alkant			Alform			
	Parkimi në qendër			RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C	RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C
		WG33		WG34	WG45	WG05	WG06	WG44	
		420	x	88	134	159	120	139	168
		420							
		600	x	100	143	176	112	155	188
600									
		840	x	212	314	388	215	317	391
		840							

Tabela 21. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform

	Kuptimi	Madhësi a mm	Alkant			Alform			
			RA1/ A WG3 3	RA2/ C WG3 4	RA3/ C WG4 5	RA1/ A WG0 5	RA2/ C WG0 6	RA3/ C WG4 4	
	Fillimi i një zone të menaxhimit të parkimit në të dyja anët	420	X	88	134	159	120	139	168
		600	X	100	143	176	112	155	188
	Fund i një zone të menaxhimit të parkimit	840	X	212	314	388	215	317	391
		840							

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave të tjera dhe tabelave plotësuese me kode C35, E18 deri C37, E24;
- Shenjat e tjera dhe tabelat plotësuese, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të shenjave dhe tabelave plotësuese.



Pyetjet:

52. Forma e shenjave të tjera dhe tabelat plotësuese C35, E18 deri C37, E24
53. Ngjyra të shenjave të tjera dhe tabelat plotësuese C35, E18 deri C37, E24
54. Tregoni madhësinë, vendosjen dhe kuptimin e shenjave dhe tabelave plotësuese C35, E18 deri C37, E24
55. Tregoni shenjat dhe tabelat plotësuese nga C35, E18 deri C37, E24

### 1.2.6.1 NDALIM PUSHIMI

Në vazhdim do të flasim për disa shenja të ndalim pushimit dhe të njëjtat do t'i paraqesim me shembuj.

Tabela 22. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform

	Kuptimi	Alkant			Alform		
		RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C	RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C
		WG3 3	WG3 4	WG4 5	WG0 5	WG0 6	WG4 4
	Ndalim-pushimi para rrugë kalimit	Kjo shenjë tregon ndalim pushimin për arsye se bëhet bllokimi i rrugës apo, më mirë të themi, bllokohet kalimi në parkingje, garazhe etj.					
	Pushim i lejuar për një kategori të caktuar të mjeteve	Kjo shenjë tregon ndalim pushimin për të gjitha mjetet të cilat nuk janë të paraqitura në shenjë, por i lejohet vetëm një kategorie të caktuar të mjeteve.					
 <p>Kodi.....</p>	Kuptimi	Alkant			Alform		
	Pushim i lejuar brenda qendrave të banuara	RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C	RA1/ A	RA2/ C	RA3/ C
WG3 3		WG3 4	WG4 5	WG0 5	WG0 6	WG4 4	
		Tregon rregullimin e parkimit të mjeteve në qendra të banuara ku:					
		<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndalon parkimin e mjeteve nga ora e caktuar në tabelë</li> <li>2. E lejon parkimin e mjeteve nga ora e caktuar në tabelë.</li> </ol>					

### 1.2.6.2 QARKULLIM I REZERVUAR

Këto shenja na tregojnë se rruga apo zona është e rezervuar për këmbësorë, biçikleta dhe kafshë shtëpiake. Janë paraqitur edhe dimensionet standarde për shenjat e qarkullimit të rezervuar të formës alkant dhe alform.

Tabela 23. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform




















	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform		
			RA1/A WG33	RA2/C WG34	RA3/C WG45	RA1/A WG05	RA2/C WG06	RA3/C WG44
	Kodi B46: Shtegu i biçikletave	420	85,30	127,00	159,20	101,70	152,40	184,60
		600	87,20	129,40	165,10	118,50	161,00	196,70
	Kodi B49: Shtegu për kalorës		 <p>Kodi C18</p> <p>Kodi C19</p> <p>Kodi C20</p> <p>Ndalimi i shtegut për këmbësorë, çiklistë dhe kafshë shtëpiake</p>					
	Kodi B47: Shtegu i këmbësorëve							
	Kodi B48: Shtegu i këmbësorëve dhe biçikletave							
	Shtegu i këmbësorëve dhe biçikletave nga ana e majtë							
	Shtegu i këmbësorëve dhe biçikletave nga ana e djathtë							

Tabela 24. Madhësia e shenjave në mm për alkant dhe alform

	Kuptimi	Madhësia mm	Alkant			Alform		
			RA1/A	RA2/C	RA3/C	RA1/A	RA2/C	RA3/C
			WG33	WG34	WG45	WG05	WG06	WG44
	Kodi C23: Fillimi i një zone për këmbësor	600x600	100,00	143,00	176,30	112,00	155,00	188,30
840x840		212,00	314,00	388,00	215,00	317,00	391,00	
	Kodi C23, C24: Fillimi dhe mbarimi i një zone për këmbësorë nga të dyja anët	420x420	88,00	134,00	159,00	120,40	139,90	168,00
600x600		100,00	143,00	176,30	112,00	155,00	188,30	
840x840	212,00	314,00	388,00	215,00	317,00	391,00		
	Kodi C24: Mbarimi i një zone për këmbësorë							
								
	Fillimi i një zone për çiklistë							
	Fillimi dhe mbarimi i një zone për çiklistë nga të dyja anët							
	Mbarimi i një zone për çiklistë							
		Mbarimi i zonës për këmbësorë dhe çiklistë nga të dyja anët						

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Madhësia e brinjës së katrorit të shenjës C23, C24;
- Madhësia e brinjës së shenjave C23, C24.

Pyetjet:

56. Gjerësia e rrugës
57. Madhësia e shenjës
58. Largësia e vendosjes së shenjës
59. Kodi i këtyre shenjave

## 1.2.7 TABELAT PLOTËSUESE

Tabelat plotësuese tregojnë informacione shtesë për pjesën tjetër të rrugës apo vendit i cili na rrethon. Këto panele mund t'i vendosim së bashku me shenjat e rrezikut, të urdhrave të prera dhe të lajmërimit. Këto panele plotësuese më për së afërmi përcaktojnë domethënien e shenjës së komunikacionit. Tabelat plotësuese kanë formën e drejtkëndëshit, sfondi i shenjës është ngjyrë e bardhë, ndërsa simboli i shenjës dhe mbishkrimi është me ngjyrë të zezë.

Ngjyrat bazë të të gjitha shenjave të tabelave plotësuese në përputhje me standardet evropiane janë dy:

- Fusha e shenjës është e bardhë apo (sfondi i bardhë);
- Simboli i shenjës dhe mbishkrimi është i zi.

Ndërsa sipas ligjit në fuqi, thuhet:

1. Tabela plotësuese vendoset së bashku me shenjën e komunikacionit për të cilën ka të bëjë dhe nën skajin e poshtëm të shenjës së komunikacionit. Por, mund të vendoset edhe në pjesën e sipërme të shenjës.

2. Gjerësia e tabelës plotësuese e vendosur me shenjën në rrugë nuk lejohet të jetë më e madhe se gjatësia e asaj brinje me të cilën vendoset tabela plotësuese, përkatësisht nga projektimi i pikës së fundit.


3. Lartësia e tabelës plotësuese, sipas rregullave, nuk lejohet të jetë më e madhe se gjysma e gjatësisë së saj, përveç tabelave plotësuese E06, E07, E20, E21, E22, E35, E36, E47, E48, E50 dhe E51.

4. Tabelën plotësuese e vendosin personat e autorizuar.

5. Tabela plotësuese duhet të hiqet pasi të ndërpriten shkaqet e vendosjes.




Në vazhdim do ta shohim mënyrën e vendosjes teknike të këtyre shenjave në rrugë sipas standardeve dhe rangut të rrugës.




Paneli plotësues me dimensione në cm

	A	B	C	D	R
E Vogël	10	0.2	0.4	25	2
Normale	15	0.3	0.6	35	2.5
EMadhe					




Paneli plotësues i shenjave rrethore me dimensione në cm

	A	B	C	D	R
E Vogël	33	0.3	0.6	17	2
Normale	50	0.4	0.8	25	3
EMadhe	75	0.5	1	33	4



### **E01 - Shenja tabelë plotësuese**

Kjo shenjë tregon distancën ndërmjet shenjës në të cilën është e vendosur tabela plotësuese dhe fillimin e pjesës së rrugës, përkatësisht vendit për të cilin ka të bëjë shenja.



Kodi E01

ALFORM (unaza)





Figura 49. Vendosija e shenjës plotësuese sipas standardit, kodit E01

### **E02 - Shenja e tabelës plotësuese**

Kjo shenjë tregon distancën (largësinë) deri te vendi në të cilën qëndron shenja B02 (ndalje e obligueshme), tek e cila shoferi duhet ta ndalë mjetin.



Kodi E02




Figura 50. Vendosja e shenjës plotësuese sipas standardit, kodit E02

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i tabelave plotësuese me kode E06-E51;
- Tabela plotësuese, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të tabelave plotësuese.

Pyetjet:

60. Forma e tabelave plotësuese nga E06-E51
61. Ngjyrat bazë të tabelave plotësuese nga E06-E51
62. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e tabelave plotësuese nga E06-E51
63. Tregoni tabelat plotësuese nga E06-E51

### 1.2.8 SHENJAT TREGUESE

Shenjat treguese na shërbejnë për dhënien e informacioneve të nevojshme për përdoruesit e rrugëve, për një qarkullim sa më të rregullt dhe të sigurt, po ashtu edhe për dallimin e itinerareve, qendrave administrative, si dhe në pjesët e tjera të rrugëve. Këto shenja treguese duhet të vendosen sa më afër që të jetë e mundur në atë pikë në të cilën nis përshkrimi si dhe të ketë një hapësirë minimale të shikimit nga drejtuesi ku në autostradë duhet të jetë prej 250 m dhe në rrugët kryesore interurbane, ndërsa 150 m në rrugët dytësore interurbane si dhe në rrugët e tjera 80 m. Këto shenja kanë formën e katrorit ose të drejtkëndëshit, ndërsa në varësi nga rruga në të cilën vendosen informacionet të cilat i japin, këto shenja kanë sponde me ngjyra të ndryshme:

- |                 |                    |
|-----------------|--------------------|
| 1. E bardha     | 2. Blu             |
| 3. Jeshile      | 4. Gri             |
| 5. Bardhë e kuq | 6. E zeza e thellë |
| 7. Kafe         | 8. E verdhë        |
| 9. E kuqe       | 10. E portokalltë  |

**E bardha:** Kjo ngjyrë përdoret për rrugët urbane apo për rrugët të cilat na shpijnë deri te rrugët urbane.

**E kaltër:** Kjo ngjyrë përdoret për rrugët interurbane apo për rrugët të cilat na shpijnë deri te rrugët interurbane.

**E gjelbër:** Kjo ngjyrë përdoret për autostrada si dhe rrugët pranë autostradave, që japin informata për autostradën.

**Gri:** Kjo ngjyrë përdoret për shenjat horizontale dhe ato të cilat janë në ribërje.

**Bardhë dhe kuq:** Këto ngjyra përdoren për shenja të vijëzuara të cilat përdoren për kontejnerët e ndryshëm rrugorë.

**E zeza e thellë:** Kjo ngjyrë përdoret për shenja të qendrave industriale, uzinave të ndryshme, si dhe fabrikave etj.

**Kafe:** Kjo ngjyrë përdoret për shenja të cilat na informojnë se afër kemi vende gjeografike, ekologjike, turistike, historike, kulturore etj.

**E verdhë:** Kjo ngjyrë përdoret për shenja të cilat na informojnë se kemi të bëjmë me punime në rrugë.

**E kuqe:** Kjo ngjyrë përdoret për dhënien e sinjaleve për ndihmë siç është “SOS” dhe në rast të “aksidenteve”.

**E portokallta:** Kjo ngjyrë përdoret për dhënien e sinjaleve për autobusë të shkollave, taksive dhe paneleve të cilat sinjalizojnë lëndë të rrezikshme.

### 1.2.8.1 SHENJAT E PARALAJMËRIMIT

Këto shenja kanë formën e drejtkëndëshit dhe vendosen në kryqëzime, me shigjeta. Te këto shenja, mbi shigjeta, mund të vendosen shenja të cilat tregojnë një kufizim apo rrezik. Madhësia e shenjave të lajmërimit për udhëheqjen e komunikacionit varet nga lartësia dhe numri i germave në shenjë.

Madhësia e shkronjave është:

Për autostradë:

Shenja e vendosur mbi rrugë 35 cm;

Shenja e vendosur anash rrugës 28 cm;

Për të gjitha rrugët e tjera prej 10.5 deri 28 cm;

Për bashkëngjitje të rrugëve në autostradë 17.5 cm.


Lajmërimi i pjesëmarrësve në komunikacion, për udhëheqjen e komunikacionit në zonën e kryqëzimit realizohet në pesë shkallë.

Shkallët e lajmërimit janë:

- I - Paralajmërimi paraprak
- II - Lajmërimi për drejtimin e lëvizjes
- III - Lajmërimi për rreshtim
- IV - Lajmërimi për kthim
- V - Vërtetimi për lajmërim

Varësisht nga lloji i kategorisë së rrugëve, formës gjeometrike të kryqëzimit dhe distancës së dy kryqëzimeve fqinje, mund të mungojë ose t'i shtohet njëra nga shkallët e lajmërimit, përveç shkallës së katërt të lajmërimit e cila është obliguese.

Shenja D08 vendoset në nyjat inter-regionale. Ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja. Për destinacion, i cili gjendet në rrugën e llojit tjetër, përdoret baza e vendosur në shenjë, ngjyra e së cilës i përgjigjet llojit të rrugës në të cilën shpie. Shenja D08 është marrë si shembull, ndërsa pozita reale në rrugë duhet t'i përgjigjet shenjës.



Kodi D08

Kodi D09

Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e komunikacionit të shkallës së tretë janë:

Shenja “paraudhëtreguese” (D09) tregon drejtimin e lëvizjes deri te vendbanimi. Ngjyra bazë për shënimin e drejtimit të lëvizjes përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie.



Kodi D12



Kodi D13

Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e komunikacionit të shkallës së katërt janë: Shenja “tabela udhëtreguese” (D12) tregon drejtimin e rrugës për vendbanim të shënuar në shenjë dhe largësinë në kilometra (përveç në fushën e bardhë). Shenja mund t’i ketë më së shumti tri fusha për shënimin e drejtimit të lëvizjes dhe më së shumti dy vendbanime brenda fushës.

Kur shenja vendoset mbi rrugë (në portal), secila fushë vendoset si shenjë e veçantë mbi shirita të komunikacionit që parashihet në shenjë. Shenja vendoset në kryqëzim në vendin ku fillon rruga që parashihet në shenjë. Ngjyrat bazë për shënimin e drejtimit të lëvizjes përcaktohen sipas llojit të rrugës në të cilën shpie rruga.

Shenjat “udhëtregues në portal mbi një shiritit të komunikacionit” (D13), (D14) dhe “udhëtregues në portal mbi dy shirita të komunikacionit” (D15) dhe (D16) në autostradë dhe në rrugë me kryqëzim në disnivel tregojnë drejtimin e lëvizjes deri te vendbanimet e shënuara në shenjë.



Kodi D15



Kodi D16



Në shenja mund të shkruhen tri, më së shumti katër emërtime të vendbanimeve, përfshirë edhe emrat e parqeve nacionale, qendra olimpike ose ndonjë përmbajtje me rëndësi nacionale.

Shenjat vendosen në hyrje dhe në zona të kryqëzimit në disnivel, dy autostrada, përkatësisht rrugë të rezervuara për mjetet motorike në vendin ku fillon shiriti për ngadalësimin e mjetit.

Ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie. Për destinacionin e cila gjendet në rrugët e llojit tjetër, përdoret ngjyra e së cilës është e përcaktuar sipas rregullave të sinjalizimit.

Shenjat e lajmërimit për udhëheqjen e komunikacionit të shkallës së pestë janë:

Shenja “vërtetimi i drejtimit” (D17) tregon vërtetimin e drejtimit të lëvizjes pas kalimit të kryqëzimit;

Shenja mban emërtimin e vendeve, distancën në kilometra deri tek ato vende dhe numrin e rrugëve në të cilën vendi gjendet;

Pozita e shenjës së numrit të shenjës është në mes, mbi emrin e vendit, përkatësisht nga ana e majtë;

Në shenjë mund të jenë të shkruar më së shumti pesë emra të vendeve;

Në autostradë dhe në rrugë të rezervuara për mjetet motorike e cila ka dy shirita rrugorë të ndarë, shenja vendoset mbi rrugë;

Shenja vendoset në distancë më së shumti 500 metra prej bashkëngjites së fundit;

Ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja.



Kodi D17

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave treguese dhe të paralajmërimit nga E06-E51;
- Shenjat treguese dhe të paralajmërimit, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të këtyre shenjave.


Pyetjet:

64. Forma e shenjave treguese dhe të paralajmërimit nga D08-D17
65. Ngjyrat e shenjave treguese dhe të paralajmërimit nga D08-D17
66. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave treguese dhe të paralajmërimit nga D08-D17
67. Tregoni shenjat treguese dhe të paralajmërimit nga D08-D17

### 1.2.8.2 SHENJAT E DREJTIMIT

Këto shenja vendosen në rrugën me dy ose më shumë korsi për kahe të lëvizjes, pak para zonës së përzgjedhur në të cilën duhet të bëjmë zgjedhje paraprake të pozicionit të rrugës, varësisht drejtimit që vozitësi i mjetit e ka ndërmend ta ndjekë apo të drejtojë automjetin e tij.

Shenja “emri i vendbanimit” (C 79) tregon emrin e vendbanimit në të cilën hynë rruga dhe kufirin nga ku fillon ky vend. Shenja vendoset në vendin e hyrjes në vendbanim dhe shoferët duhet t’i zbatojnë rregullat e trafikut të cilat vlejné për vendbanim.



Kodi C79

Shenja “udhëtreguese” (C 81) tregon vendin, karakteristikën e objekteve ose përmbajtjen kah shtrihet rruga në të cilën udhëtreguesi tregon:



Kodi C81

Në udhëtregues mund të shkruhen më së shumti dy emra të cilët shkruhen njëri nën tjetrin.

Me shenjat C81 dhe C82 duhet të shënohet distanca deri te destinacioni në km.



### 1.2.8.3 SHENJAT E INTINERARIT

Këto lloje të shenjave tregojnë se ku mund të arrihet nëse do ta shfrytëzohet daljeja e cila është pas disa metrave, pas asaj që është e shënuar në shenjë.

Shenjat “paraudhëtreguese për dalje” (D10), (D11) në autostradë tregojnë drejtimin e lëvizjes deri te vendbanimet e shënuara në shenjë.

Ngjyra e bazës për shënimin e drejtimit të lëvizjes përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën shpie rruga.



Shenjat e itinerarit tregojnë se ndodhemi në një rrugë e cila është rrugë interurbane dhe se, pas 250 m, përkatësisht 500 m, është një dalje që është e

emërtuar sipas shenjës së dhënë, e cila të dërgon në destinacionin e shënuar. Këto shenja vendosen në rrugët interurbane kryesore dhe në autostrada.

#### 1.2.8.4 SHENJAT POHUESE (TË POHIMIT)

Edhe këto shenja si të shenjat e tjera tregojnë një distancë në km e cila na tregon për të arritur deri në destinacionin e shënuar në shenjë.



Kodi D17

Shenja në autostradë tregon distancën në kilometra për destinacionin e shënuar në shenjë, ndërsa nëse sfondi i shenjës është me ngjyrë blu dhe na jep të kuptojmë se ndodhemi në rrugë interurbane.

Shenja “vërtetimi i drejtimit” (D17) tregon vërtetimin e drejtimit të lëvizjes pas kalimit të kryqëzimit;

Shenja mban emërtimin e vendeve, distancën në kilometra deri tek ato vende dhe numrin e rrugëve në të cilën gjendet vendi;

Pozita e shenjës së numrit të shenjës është në mes mbi emrin e vendit, përkatësisht nga ana e majtë;

Në shenjë mund të jenë të shkruar më së shumti pesë emra të vendeve;


Në autostradë dhe në rrugë të rezervuara për mjetet motorike e cila ka dy shirita rrugorë të ndarë, shenja vendoset mbi rrugë;

Shenja vendoset në distancë më së shumti 500 metra prej bashkëngjithjes së fundit. Ngjyra e bazës së shenjës përcaktohet sipas llojit të rrugës në të cilën vendoset shenja.

### 1.2.8.5 SHENJAT INFORMUESE TË CILAT NA INFORMOJNË PËR GJENDJEN E RRUGËS SI DHE KUFIJTË E LEJUAR TË SHPEJTËSISË NË TO

Këto lloje të shenjave na japin informacione mbi gjendjen e rrugës, kalueshmërinë e tyre në kohën e dimrit me borë apo në periudha të ndryshme kohore, si dhe për llojin e rrugës dhe shpejtësinë e lejuar në to.

Shenja “kufizimi i shpejtësisë më të madhe të lejuar në rrugët e Kosovës” (C122) tregon kufizimin e përgjithshëm të shpejtësisë në Kosovë sipas llojit të rrugës dhe obligimin e ndezjes së dritave të shkurtra kur mjete është në komunikacion.



Kodi C122

Shenja “ndalim i hyrjes të llojit të caktuar të mjeteve në autostradë ose në rrugë të rezervuara për mjetet motorike” (C100) tregon cilave lloje të mjeteve dhe të pjesëmarrësve në komunikacion u ndalohe lëvizja në autostradë dhe në rrugë të rezervuara për mjetet motorike. Kur rruga është e rezervuar për mjete motorike, shenja është me ngjyrë të katër.



Kodi C100

### 1.2.8.6 SHENJAT TURISTIKE DHE TË TERRITORIT

Shenjat (C98) dhe (C99) tregojnë arritjen në vendin ku gjendet vendi i pushimores me përmbajtje të shërbimeve dhe hapësirës për pushimin e udhëtarëve. Në shenjë simbolet përmbajnë vendin e pushimores, distancën deri te pushimorja (C98), përkatësisht deri te pika tjetër e karburanteve (C99).

Kur shenja (C99) vendoset në fillim të shiritit të komunikacionit për shkyçje, nën simbol të përmbajtjes së vendit të pushimores gjendet shigjeta e pjerrët në të djathtë. Ngjyra e shenjës varet nga lloji i rrugëve në të cilën vendoset shenja.



Kodi C98



Kodi C99

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave të drejtimit dhe itinerarit, pohuese, informuese, turistike nga C79-C122;
- Shenjat e drejtimit dhe itinerarit, pohuese, informuese, turistike, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të këtyre shenjave.

Pyetjet:

68. Forma e shenjave të drejtimit dhe itinerarit, pohuese, informuese, turistike nga C79-C122
69. Ngjyrat e shenjave të drejtimit, itinerarit, pohuese, informuese, turistike nga C79-C122
70. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave të drejtimit dhe itinerarit, pohuese, informuese, turistike nga C79-C122
71. Tregoni shenjat e drejtimit dhe itinerarit, pohuese, informuese, turistike nga C79-C122.



## 2 SHENJAT NDRIÇUESE

Shenjat ndriçuese zakonisht vendosen nëpër udhëkryqet e trafikut rrugor dhe shërbejnë për rregullimin e qarkullimit për ngasësit e automjeteve dhe të këmbësorëve. Shenjat ndriçuese kanë për detyrë ta vendosin qarkullimin e drejtë dhe të rregullt të trafikut, pastaj rritjen e sigurisë së trafikut rrugor, po ashtu vendosjen e përafërt të qarkullimit të pandërprerë të trafikut rrugor. Këto sinjale mund ta bëjnë edhe ndërprerjen e qarkullimit të trafikut rrugor në rrugët me ngarkesë të madhe, si dhe ndërprerjen e qarkullimit me qëllim të kalimit të këmbësorëve dhe automjeteve nga rrugët dytësore, pastaj për dhënien e përparësisë së kalimit, drejtimin e trafikut në drejtime dhe kahe të ndryshme, si dhe paralajmërimin e ngarkesave për vende të rrezikshme.

Këto shenja ndriçuese i ndajmë në:

- a. Shenja ndriçuese për rregullimin e trafikut të automjeteve
- b. Shenja ndriçuese për rregullimin e trafikut për këmbësorë dhe çiklistë
- c. Shenja ndriçuese për rregullimin e trafikut të tramvajit
- d. Shenja ndriçuese për shënimin e kalimit të rrugës përtej hekurudhës në nivel
- e. Shenja ndriçuese për shënimin e vendit ku zhvillohen punimet në rrugë.

### 2.1 SHENJAT NDRIÇUESE PËR RREGULLIMIN E TRAFIKUT TË AUTOMJETEVE

Këto shenja janë semaforët normalë për të gjitha mjetet të cilat lëvizin në rrugë. Këto e bëjnë rregullimin e qarkullimit në udhëkryqe. Sipas ndezjes së dritave, na informojnë edhe për veprimet të cilat ngasësi i mjetit duhet t'i ndër marrë. Kështu që, me ndezjen e dritës së kuqe, verdhë dhe të gjelbër marrim këto informacione:

**Ndezja e dritës së gjelbër** na lejon të lëvizim lirshëm me mjet dhe mund të vazhdojmë drejt dhe djathtas, mirëpo duke u dhënë përparësi këmbësorëve të cilët mund ta kapërcejnë rrugën në të cilën dëshirojnë të lëvizin, ose mund të kthehen majtas, por duke u dhënë përparësi kalimi atyre mjeteve që vijnë nga ana e djathtë. Për rregullimin e trafikut përdoren pajisjet të cilat japin shenjat, me dritat ngjyrë të kuqe, të verdhë dhe të gjelbër.

Shenjat ndriçuese të trafikut janë:

1. Shenjat ndriçuese të trafikut për rregullimin e trafikut të mjeteve
2. Shenjat ndriçuese të trafikut për rregullimin e trafikut të destinuar vetëm për këmbësorë
3. Shenjat ndriçuese të trafikut për ta rregulluar transportin publik
4. Shenjat ndriçuese të trafikut në vendkalimin hekurudhor
5. Shenjat ndriçuese të trafikut për shënimin e punimeve dhe pengesave në rrugë.

Drita e përdorur si shenjë ndriçuese e trafikut mund të jetë e pandërprerë ose me ndërprerje (vezulluese). Shenjat e trafikut me dritë mund të vendosen në tabelën me ngjyrë të bardhë, me skaje ngjyrë të zezë (pllaka e kontrastit).

Shenjat ndriçuese me tri ngjyra mund të përdoren edhe për rregullimin e komunikacionit në shumë shirita të trafikut në të njëjtën kohë ose për secilin shirit të trafikut veçmas. Nëse me këto pajisje rregullohet trafiku në secilin shirit veç e veç, shenjat ndriçuese vendosen mbi shirit të trafikut për të cilët ka të bëjë.

Kur shenjat ndriçuese përdoren për rregullimin e trafikut në shumë shirita të trafikut dhe për shumë kahe të lëvizjes në të njëjtën kohë, shenjat ndriçuese vendosen në anën e djathtë të rrugës.

Në rrugët me më shumë se një shirit trafiku për secilën shirit të lëvizjes është e nevojshme të përsëriten shenjat me drita trengjyreshe.

Në fusha ndriçuese me ngjyrë të kuqe, shigjeta e drejtimit është e zezë, ndërsa në fushën ndriçuese të gjelbër, shigjeta çdoherë është e gjelbër në bazën e zezë.

Sinjalizimi ndriçues shërben për të rregulluar qarkullimin e përdoruesve të rrugës si këmbësoreve po ashtu edhe mjeteve, sinjalizimi ndriçues ndahet në:

- ✚ Shenjat ndriçuese të komunikacionit për rregullimin e komunikacionit të mjeteve;
- ✚ Shenjat ndriçuese të komunikacionit për rregullimin e komunikacionit të destinuar vetëm për këmbësorë;
- ✚ Shenjat ndriçuese të komunikacionit për të rregulluar transportin publik;
- ✚ Shenjat ndriçuese të komunikacionit në vendkalimin hekurudhor;
- ✚ Shenjat ndriçuese të komunikacionit për shënimin e punimeve dhe pengesave në rrugë.

### 2.1.1 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT TË MJETEVE

Rregullojnë lëvizjen përkatësisht qarkullimin e mjeteve në kryqëzim.

Ndezja e dritës së kuqe Fig.51 lajmëron ngasësit për ndaljen e detyruar të mjetit para vijës të tërthortë horizontale ose në distancë të mjaftueshme në mënyrë që ngasësi i mjetit me qenë në gjendje ta shohë semaforin.




Figura 51

Drita e verdhë ndalon kalimin e mjeteve Fig.52, përveç atyre që janë futur në kryqëzim si dhe atyre që nuk kanë mundësi të ndalen para vijës tërthore.



Figura 52

Drita e gjelbër lejon lëvizjen e mjeteve në kryqëzim drejtë Fig.53, me mundësi kthimi djathtas duke ju dhënë përparësi këmbësorëve në rrugën në të cilën kyçeni, po ashtu lejon kthimin majtas duke ju dhënë përparësi kalimi mjeteve që vijnë nga kahu i kundërt (përballë).



Figura 53

Ndezja e dritës së gjelbër plotësuese Fig.54 tregon lejinim e kalimit në kryqëzim në drejtim të shigjetës por me kujdes të shtuar duke ju dhënë përparësi kalimi të gjitha mjeteve dhe këmbësorëve që gjenden në kryqëzim.




Figura 54

Drita e gjelbër vezulluese Fig.55 paralajmëron shoferet se shume shpejt do të ndërpritet kalimi i lirë pastaj do të ndizet drita e verdhë e pa ndërprerë, pas të cilës do të ndizet drita e kuqe.




Figura 55

Drita e verdhë vezulluese Fig.56 tregon kalimin e lirë por me kujdes të shtuar, ky sinjal nuk e ka kuptimin e njëjtë me sinjalin e verdhë të pa ndërprerë.



Figura 56

Drita e kuqe dhe e verdhë njëkohësisht Fig.57 paralajmëron pjesëmarrësit në trafik se së shpejti do të pushon ndalimi i kalimit, përgatitje për nisje, pas këtij sinjali do të vije sinjali i gjelbër kalim i lirë.




Figura 57

Semaforët me shigjeta orientuese i detyrojnë drejtuesit e mjeteve të cilët janë rreshtuar në atë shirit qarkullues të lëvizin sipas drejtimit të shigjetës Fig. 58

Domethënia e sinjaleve ndriçuese është e njëjtë siç është tek semaforët normal.



Figura 58

Semaforët e shiritave të ndryshëm janë semafor të cilët vendosen mbi rrugë (portal) të cilët informojnë ngasësit e mjeteve për ndryshimet e kahes së lëvizjes së mjeteve , siç shihet në Fig.59 drita e kuqe në formë të shkronjës (X) ndalon qarkullimin e mjeteve përgjatë shiritit të trafikut, kurse

drita e gjelbër në formë shigjete do të thotë kalim i lirë përgjatë shiritit të trafikut.




Figura 59

Shigjeta e verdhë me maje të kthyer nga e djathtë ose e majtë tregon kalimin e rrjedhës së komunikacionit nga shiriti i komunikacionit mbi të cilën është i vendosur shenja në shirit tjetër Fig.60




Figura 60



## 2.1.2 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR RREGULLIMIN E KOMUNIKACIONIT TË DESTINUAR VETËM PËR KËMBËSORË

Këta semafor vendosen në vendkalimet e këmbësorëve dhe të biçikletave të cilët bejn të mundur qarkullimin ne vendkalim e këmbësorëve ose në shtegun e biçikletave Fig.61.




Figura 61

Ndezja e dritës së kuqe tregon për ndalimin e kalimit të këmbësoreve ose biçikletave, drita e gjelbër tregon për kalimin e lirë në vendkalim ose në shtegun e biçikletave, në vendkalimet e këmbësoreve sinjali i gjelbër në një kohë të caktuar mund të jetë vezullues i cili tregon se së shpejti do të ndizet drita e kuqe Fig.62



Figura 62

### 2.1.3 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR TË RREGULLUAR TRANSPORTIN PUBLIK

Janë semafor të njëjtë si semaforët normal por e veçanta e tyre është se shërbejnë vetëm për mjetet e transportit publik si p.sh. (Tramvaji, trolejbus, autobus, etj) Fig.63.

Funksionojnë në bashkëveprim me semaforët tjerë. Ndezja e dritës së bardhe në forme të vijës horizontale detyron ndalimin e mjeteve të transportit publik, domethënia është e njëjtë me semaforin e kuq tek sinjalet normale.

Ndërsa vijat vertikale dhe të tërthorta lejojnë kalimin e mjeteve të transportit publik në drejtimet përkatëse, vija e bardhe vertikale kalimi i lirë drejt, vija e tërthortë majtas kalim i lirë majtas, vija e tërthortë djathtas kalimi i lirë djathtas.




Figura 63

### 2.1.4 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT NË VENDKALIMIN HEKURUDHOR

Shenjat ndriçuese në vendkalimin hekurudhor paralajmërohet ardhja e trenit, përkatësisht ulja e barrierave ose gjysmë barrierave, ku me këto shenja pjesëmarrësit në komunikacion lajmërohen mbi atë se barrierat ose

gjysmë barrierat janë në pozitën e mbyllur, këto shenja ndriçuese japin drita të kuqe alternative të cilat janë në formë të rrethit

Në Fig.64 është paraqitur paralajmërimi për ardhjen e trenit pra ndalimi i kalimit mbi binaret hekurudhor.



Figura 64

Në Fig.65 është paraqitur lejimi i kalimit mbi binaret hekurudhor.



Figura 65

## 2.1.5 SHENJAT NDRIÇUESE TË KOMUNIKACIONIT PËR SHËNIMIN E PUNIMEVE DHE PENGESAVE NE RRUGË

Shenjat ndriçuese për shënimin e punimeve në rrugë dhe pengesat mund të jenë pllaka për shënim të pengesave me dritë vezulluese.

Në Fig.66 janë paraqitur shenjat ndriçuese të trafikut për punimet në rrugë si dhe pengesave tjera. Janë drita vezulluese me ngjyrë portokalli të vendosura në mbrojtëse.

Mbrojtëset vendosen sipas kësaj mënyre: a) kur pengesa është vetëm në njërin skaj të rrugës ndërsa drita duhet të vendoset në mes të rrugës, b) kur pengesa është në mes të rrugës dhe rruga është e lirë nga të dy anët në këtë rast dritat vezulluese duhet të vendosen në të dy skajet e mbrojtëses, c) në rastet kur mbrojtëset e mbyllin tërë gjerësinë e rrugës, dritat vezulluese ngjyrë portokalli duhet të vendosen në tri pozicione në dy skajet dhe në mes të mbrojtëses.





Figura 66

Domethënia e shenjave ndriçuese është:

- Drita e kuqe nënkupton ndalim kalimi për mjete, kodi G01;
- Drita e kuqe dhe e verdhë tregojnë së shpejti ndërprerje të ndalim trafikut para paraqitjes së dritës së gjelbër, kodi G02;
- Drita e gjelbër tregon kalim të lirë të mjeteve dhe duhet të jetë e ndezur si dritë e pavarur. Kalimi nga drita e gjelbër në të verdhë duhet të sinjalizohet me ndërprerje të dritës së gjelbër tri herë, kodi G03.



Drita e verdhë para dritës së kuqe nënkupton ndalim lëvizje përveç mjeteve të cilat, kur drita e verdhë ndizet, gjenden në atë largësi nga shenja ndriçuese që nuk mund të ndalen në mënyrë të sigurt, e që mos të kalojnë këtë shenjë, kodi G04.

Shigjeta ndriçuese plotësuese (shtesë) tregon kalimin e lirë për mjete në kahun e shënuar me dritë të gjelbër edhe gjatë kohës kur është ndezur drita e kuqe ose e verdhë, kodi g05 dhe kodi g06.


Format e shigjetave të paraqitura në kodin G07 (për shigjetat me ndriçim të kuq) dhe kodi g08 (për shigjetat me ndriçim të gjelbër).



Kodi G07



Kodi G08

Vijat e kryqëzuara me ngjyrë të kuqe [  ] tregojnë ndalimin e trafikut përgjatë shiritit të trafikut të shiritit mbi të cilin është vendosur shenja, kodi G09.



Kodi G09




Kodi G10

Shigjeta e gjelbër me majë të kthyer teposhtë, tregon kalim të lirë përgjatë shiritit të trafikut mbi të cilën është vendosur shenja, kodi G10.

Shigjeta e verdhë me majë të kthyer nga e djathta ose e majta, tregon kalimin e rrjedhës së trafikut nga shiriti i trafikut mbi të cilën është i vendosur shenja në shirit tjetër, kodi G11 dhe kodi G12.



Kodi G11




Kodi G12

Nëse me semafor rregullohet trafiku i biçiklistëve në vendkalimin e shtegut të biçikletave përtej rrugës, dritat në semafor janë në formë të siluetës së biçikletës dhe kanë domethënie:

- Kalim i lirë për biçiklistë, kodi G13;
- Ndalim kalimi për biçiklistë, kodi G14.

E njëjta pajisje për dhënien e shenjave ndriçuese për biçiklistë dhe këmbësorë mund të aplikohet edhe në rastet kur shigjeta e këmbësorëve dhe ajo e biçiklistëve janë njëra pranë tjetrës, kodi G15 dhe kodi G16.



Kodi G13

Kodi G14

Kodi G15

Kodi G16

Kur shenjat ndriçuese kanë të bëjnë vetëm për kahun e caktuar të lëvizjes, atëherë drejtimi duhet të shënohet me shigjeta me ngjyrë të gjelbër dhe të kuqe në sipërfaqe ndriçuese. Nëse në sipërfaqe të shenjës ndriçuese kryesore tregohet shigjeta e kahut, atëherë edhe të tjerat sipërfaqe ndriçuese të shenjave ndriçuese duhet të kenë shigjeta për kahun e lëvizjes.


Kur në afërsi të kryqëzimit me shiritat për kthim, pa ndarje fizike të rrjedhës të trafikut e cila kthehet, shënohet me shigjetë të kahut në fushën ndriçuese shigjeta për kthim, tregon vetëm për rrjedhjen e trafikut e cila kthehet.

Për rregullimin e trafikut të këmbësorëve mund të përdoret semafori me drita, dy ngjyra.

**Drita e gjelbër** mund të jetë e instaluar ashtu që në interval të caktuar kohor, para se të fikët, paralajmërohet me dritën e gjelbër vezulluese.

**Drita e kuqe** dhe e gjelbër nuk mund të jenë të ndezura në të njëjtën kohë. Shenjat ndriçuese në semaforë kanë domethënie si vijon:

- **Kalim i lirë për këmbësorë**, kodi G17;
- **Ndalim i kalimit për këmbësorë**, kodi G18.



Kodi G17

Kodi G18

Për drejtimin e trafikut të tramvajit përdoret shenja ndriçuese njëngjyrëshe, në formën e shigjetës ndriçuese me ngjyrë të bardhë ose të verdhë.

Vija ndriçuese mund të jetë e shtrirë (horizontal), e drejtë dhe e pjerrët, ndërsa vija e shtrirë do të thotë ndalim kalimi për tramvaj dhe vendoset në aksin horizontal lart. Shigjeta drejt dhe e pjerrët do të thotë kalimi i lirë dhe vendosen poshtë.

Me vija tregohet:

- Ndalimi kalimi për tramvaj, kodi G19;
- Kalimi i lirë për tramvaj në drejtimin drejt, kodi G20;
- Kalimi i lirë për tramvaj në drejtim djathtas, kodi G21;
- Kalimi i lirë për tramvaj në drejtim majtas, kodi G22.






Kodi G19



Kodi G20



Kodi G21



Kodi G22

Madhësia e shenjës ndriçuese është:

Te shenjat me kod G01 deri kod G08 diametri i rrethit të dritës është 200 dhe 300 mm.

Te shenjat nga kod G13 deri te kod G22 diametri i rrethit të dritës është 200 mm.

Madhësia e shenjës ndriçuese është 300 mm.

Për të gjitha rrugët kur shenja ndriçuese e trafikut vendoset mbi rrugë, kur shenja ndriçuese e trafikut vendoset pranë skajit të rrugës në të gjitha rrugët e tjera, madhësia e saj është 200 mm.

Shenjat ndriçuese për rregullimin e trafikut në kryqëzime të cilat vendosen në shtylla në afërsi të rrugës duhet të vendosen në lartësi 2 deri 3.5 metra mbi sipërfaqen e rrugës.

Në shtyllën në të cilën gjendet shenja ndriçuese mund të vendoset edhe shenja ndriçuese e trafikut në lartësi më të ulët dhe me ndriçim më të vogël.

Nëse shenjat ndriçuese të trafikut vendosen mbi rrugë, nuk lejohen të jenë në lartësi më të vogël se 4.5 m, as më të madhe se 5.5 m mbi rrugë.

Në afërsi të kryqëzimit jashtë vendbanimeve në të cilat janë të vendosura shenjat ndriçuese për drejtimin e trafikut duhet të vendosen shenjat e trafikut të cilat paralajmërojnë afërsinë e shenjave ndriçuese (kodi A23 ose kodin A24), me tabelë plotësuese kodin E01, kryqëzimi (kodi D01 ose kodin D02),

ndalim i tejkalimit për të gjitha mjetet motorike, përveç motoçikletave pa rimorkio (kodi B32) dhe kufizimi i shpejtësisë (kodi B31) nëse shpejtësia e lëvizjes e lejuar është mbi 60 km/h.

Largësia e shenjave të trafikut nga kryqëzimi varet nga shpejtësia e lejuar e lëvizjes dhe situata reale.

Shenjat ndriçuese në vendkalimin hekurudhor (për shënimin e kalimit të rrugës mbi binarët e hekurudhës në të njëjtin nivel) mund të jenë shenjat për shënimin e barrierave dhe gjysmëbarrierave si dhe shenjat me të cilat paralajmërohet ardhja (afërsinë) e trenit, gjegjësisht mbyllja e kalimit me barriera ose gjysmëbarriera. Përveç shënimit të vendkalimit hekurudhor me shenjat ndriçuese, kalimi duhet të sigurohet edhe me sinjale akustike.

Nëse me shenjat ndriçuese në vendkalimin hekurudhor paralajmërohet ardhja e trenit, përkatësisht ulja e barrierave ose gjysmëbarrierave, me këto shenja pjesëmarrësit në trafik lajmërohen se barrierat ose gjysmëbarrierat janë në pozitën e mbyllur. Këto shenja ndriçuese japin drita të kuqe alternative të cilat janë në formë të rrethit Ø 300.

Dritat duhet të jenë të vendosura njëra pranë-tjetrës në shtyllën vertikale të tabelës e cila ka formën e trekëndëshit barabrinjës me majë të kthyer nga lart, kurse ngjyrat dhe dimensionet e saj i përgjigjen ngjyrës dhe dimensioneve të shenjave të rrezikut. Ndërkaq, gjatësia e brinjëve të trekëndëshit barabrinjës është me madhësi 120 (kodi G23), me ngjyrë retroreflektuese të klasës së trettë.

Dritat punohen nga teknologjia e diodave ndriçuese (LED).



Kodi G23

Shenjat ndriçuese për shënimin e punimeve në rrugë dhe pengesat mund të jenë pllaka për shënim të pengesave me dritë vezulluese (kodi K22 dhe kodi K23), tabela lëvizëse me dritë vezulluese dhe shenja (kodi K24, kodi K25 dhe kodi K26) si dhe pajisjet e përkohshme për dhënien e shenjave ndriçuese me qëllim të lëshimit të mjeteve nga drejtimi i kundërt.

### 3 PAISJET E TJERA TË TRAFIKUT NË RRUGË

Pajisjet për shënimin e skajeve të rrugës janë:

Kahja e treguesit, kodi K01, shërben për shënimin e skajit të rrugës.

Shtylla e kaheve të treguesve në kahun e drejtimit të lëvizjes duhet ta ketë shenjën retroreflektuese nga xhami retroreflektues.

Shenja retroreflektuese në kahun e lëvizjes nga ana e djathtë është ngjyrë e kuqe, ndërsa nga ana e majtë është ngjyrë e bardhë.

Në rrugët me një drejtim të lëvizjes shenja retroreflektuese është nga të dyja anët me ngjyrë të kuqe. Kahu i treguesit, kodi K01, në parim vendoset në distancë prej 0.75 (m) nga skaji i rrugës, përgjatë rrugës në largësi prej 50 m kur rruga është e drejtë, ndërsa 25 (m) kur rruga është me kthesa dhe varet nga rrezja e kthesës, përkatësisht sipas tabelës së paraqitur.


Në autostrada dhe rrugë të rezervuar për mjetet motorike, kahu i treguesit, kodi K01, vendoset në lartësi prej 105 cm, ndërsa në rrugët e tjera në lartësi prej 0.90 cm nga niveli i sipërfaqes.

Kur përgjatë rrugës vendoset rrethoja e mbrojtësit zbutës, kahet e treguesit vendosen:

Në rastet kur rrethoja e mbrojtësit zbutës është e larguar nga skaji i rrugës 1.5 (m) dhe në rrethojat e vogla;

Në rastet kur rrethoja mbrojtëse me material të butë është e larguar më tepër se 1.5 (m), në distancë minimale 0.5 (m) deri maksimalisht 0.9 (m) prej skajit të jashtëm të rrugës;

Në rastet kur rrethoja mbrojtëse me material të butë është e vendosur në shiritin ndarës në distancë prej 1.6 (m) e më pak, shtyllat e kahut të treguesit vendosen në rrethojë.



Kodi K01




Figura 67. Treguesit e kaheve dhe dimensionet në mm

Kahet e treguesit, shenjat për tunele dhe galeri, kodi K02, shënojnë skajin e rrugës në tunel, përkatësisht në galeri dhe punohen me teknologjinë e diodave ndriçuese (LED) dhe duhet të ketë furnizim të përhershëm me energji.

Kahet treguese për tunele, në kahun e lëvizjes në anën e djathtë, janë me ngjyrë të kuqe, ndërsa në anën e majtë me ngjyrë të bardhë.

Në rrugë me komunikacion njëdrejtimëshe shenja reflektuese në kahun e lëvizjes nga ana e djathtë është me ngjyrë të kuqe, me prapavijë të bardhë, ndërsa nga ana e majtë është nga dyja anët e punuar me ngjyrë të kuqe për raste të drejtimit të komunikacionit dhe shfrytëzimin e shiritit për komunikacion në dy kahe.

Në tunele dhe galeri shenjat e kahut lëvizës janë me teknologji të diodave ndriçuese (LED), kodi K02 dhe vendosen në distancë 25 m kur tuneli ose

galeria janë të drejta, përkatësisht në distancën 15 m në kthesa dhe në 100 m para të tunelit ose galerisë.




Kodi K02

Shenjat reflektuese, kodin K03, përcaktojnë skajin e rrugës të cilat vendosen në objekte, në vendet në të cilat nuk është e mundur të vendosen në shtylla. Forma, madhësia dhe ngjyra varen nga vendi i vendosjes (në rrethojën mbrojtëse, në pjesët anësore të tunelit, në muret mbajtëse ose ngjashëm si dhe në shenjat gjatësore dhe tërthore të rrugës).

Sipërfaqja e shenjës reflektuese duhet të jetë e klasës së tretë retroreflektuese:

Kur në rrugë është e vendosur rrethoja mbrojtëse nga betoni dhe në të vendoset shenja reflektuese, kodin K03, në distancën e caktuar dhe në të njëjtën lartësi sikurse edhe në shtyllat e kahut të treguesve, kodin K01.




Kodi K03

Shtyllat për borë në kushtet e dimrit tregojnë skajin e shiritit rrugor dhe shënojnë zgjatjen e rrugës ose të objekteve rrugore.

Shtyllat për borë në rrugë, kodi K04 dhe objektet rrugore, kodi K05, janë të ngjyrosura në mënyrë alternative ngjyrë të kuqe dhe të verdhë. Fusha më e lartë duhet të jetë e lyer me materie reflektuese.


Shtyllat për borë, kodi K04, vendosen në skaje të rrugës ku janë të vendosura edhe shtyllat e kahut të treguesve. Vendosja nga ana e djathtë e shtyllës së kahut të treguesve, shikuar në kahun e lëvizjes, ashtu që mos të mbulohet pjesa reflektuese e kaheve të treguesve.

Shtylla për borë duhet të vendoset para dhe në fund të rrethojës mbrojtëse.




Kodi K04

Në fillim të objektit rrugor vendoset shtylla me kufizues të kthyer nga poshtë, ndërsa në fund të objektit rrugor shtylla me kufizues të kthyer nga lart, ndërsa maja e kufizuesit duhet të jetë e ngjyrosur me materie reflektuese.




Kodi K05

Tabelat për shënimin e ishullit, kodi K06, kodi K07, kodi K08 dhe kodi K09, shënojnë majën e ishullit të komunikacionit në kryqëzime dhe vendosen në majë të ishullit ndarës, në krahët dalës të autostradave dhe rrugëve të rezervuara për mjetet motorike. Shenja me kodin K08 punohet si element hapësinor. Ngjyra bazë e shenjës, me kodin K09, është e verdhë-kuqe, kurse ngjyra retroreflektuese e klasës së tretë.



Kodi K06

Kodi K07



Kodi K08

Kodi K09

Pajisjet, shenjat dhe shënimet për njoftimin e punimeve, pengesave dhe dëmtimin e rrugës janë:

Tabela për shënimin e pengesave në anën e majtë të rrugës, kodi K10 dhe në anën e djathtë të rrugës, kodi K11, në drejtimin e ngasjes tregon punët ose pengesat në rrugë, në objekte dhe në sipërfaqe të tjera të trafikut.





Kodi K10

Kodi K11

Tabela për shënimin e kthesës në rrugë, kodi K12 dhe kodi K13, dhe tabela për shënimin e kthesave të ashpra në rrugë, kodi K14, me kahun e udhëzimit në të majtë ose në të djathtë.

Ngjyra e shigjetës në shenjën e kodit K14 është e verdhë dhe e kuqe retroreflektuese të klasës së tretë. Këto shenja vendosen në vendin ku fillon kthesa e ashpër. Tabela me kodin K14 vendoset në kthesa të ashpra dhe të papritura.



Kodi K12



Kodi K13



Kodi K14





Figura 68. Mënyra e vendosjes së shenjës

Tabela (anësore) e pengesës, me kodin K15, kodin K16, kodin K17, kodin K18, shënon vendin anësor që zvogëlon profilin e rrugës. Me tabelat fizikisht ndahen shiritat rrugorë të kaheve të kundërta të lëvizjes. Tabelat me kodin K17 dhe kodin K18 vendosen edhe në vendet ku janë sipërfaqet e ngritura të rrugës ose gunga artificiale në rrugë.

Ngjyra e shiritave të pjerrët në shenjat kodin K17 dhe kodin K18 janë verdhë e kuq retroreflektuese të klasës së tretë.




Konat kufizuese të kodit K19 shërbejnë për shënimin e punimeve në rrugë me kohëzgjatje të shkurtër.



Kodi K19

Rrethoja për shënimin e pengesave në rrugë, kodi K20 dhe kodi K21, shërben për shënimin e pengesave në sipërfaqen e trafikut.



Kodi K20

Kodi K21


Tabela për shënimin e vendit ku kryhen punimet në rrugë ose të dëmtimeve në rrugë, kodi K22 dhe kodi K23.



Kodi K22

Kodi K23


Tabela lëvizëse me dritë vezulluese dhe shenja, kodi K24 dhe kodi K25, shënon vendin e punimeve në rrugë ose dëmtimin e rrugës.



Kodi K24


Kodi K25

Tabela lëvizëse me drita vezulluese dhe shigjeta ndriçuese të kthyera poshtë dhe shenjën e komunikacionit, kodi K26, shënon vendin në rrugë ku shiriti i komunikacionit është i mbyllur, me të cilat komunikacioni orientohet.



Kodi K26


Tabela ndriçuese lëvizëse me përmbajtje të ndryshuar, kodi K27, kodi K28 dhe kodi K29, paralajmëron vendin ku kryhen punimet ose ku është dhënë kahja dhe mënyra e orientimit të komunikacionit.



Shenjat ndriçuese për shënimin e punimeve, të pengesave si dhe të dëmtimeve në rrugë.


Diametri i dritave nuk duhet të jetë më i vogël se 210 mm. Distanca në mes të dritave, varësisht nga situata, është prej 5 m deri në 10 m.

Drita e kuqe përdoret në tabelat për shënimin e pjesës së mbyllur të rrugës, kodi K30.




Kodi K30

Drita e verdhë vezulluese përdoret për theksimin e shenjës së trafikut mbi të cilën është e vendosur, kodi K31. Kur është fjala për shenjën, të drejtuarit dhe mbikëqyrjen e komunikacionit që shfrytëzon policia, atëherë në vend të dritës me ngjyrë të verdhë vezulluese përdoret drita me ngjyrë të kaltër vezulluese.



Kodi K31

Vargu i dritave të verdha ndriçuese është i lidhur dhe në intervale kohore ndizen dhe fiken në mënyrë alternative në drejtim të lëvizjes. Vargu i ndriçueseve njofton se një ose më shumë shirita lëvizës janë mbyllur për lëvizje dhe që trafiku orientohet sipas “udhëtimit me drita”, kodi K32.



Kodi K32

Pajisjet, shenjat për shënimin e punimeve, të pengesave dhe dëmtimeve në rrugë si dhe pajisjet për udhëheqjen dhe orientimin e trafikut në zonat e punimeve në rrugë, pengesave dhe dëmtimeve në rrugë, vendosen duke u bazuar në projektin e trafikut.

Pajisjet për udhëheqje dhe orientimin e trafikut në zonat e punimeve në rrugë, pengesave të tjera si dhe dëmtimeve në rrugë, janë:

Skajoret e montuara të cilat shërbejnë për drejtimin e trafikut të mjeteve nëpër shirita të trafikut me ngjyrë të verdhë.


Në skajore duhen të jenë të ngjitura shenjat reflektuese për dukshmëri më të mirë natën dhe në kushtet e dukshmërisë së zvogëluar, kodi K33.



Kodi K33

Markeret për ndarjen e kaheve të ngasjes vendosen në rastet kur trafiku zhvillohet në dy kahe nëpër rrugën njëdrejtimëshe.

Sipërfaqja e markerëve duhet të jetë me shenja reflektuese, kodi K34, kodi K35 dhe kodi K36, ndërsa markeri mund të jetë i pavarur ose i përforcuar në anësorë të montuar. Kur markerët janë të përforcuar në skajore montuese duhet të jenë ngjyrë të kuqe dhe të bardhë të drejtuar me majë teposhtë në drejtim të lëvizjes, kodi K35 dhe kodi K36.



Kodi K34

Kodi K35

Kodi K36

Shenjat me kahe treguese për ndarjen e drejtimeve të lëvizjes dhe shënimin e kalimit të këmbësorëve si dhe kalimin e rrugës mbi binarë të hekurudhës, kodi K37.

Shenjat e kaheve treguese (markerët) kanë shenja reflektuese orientuese ose shenja ndriçuese nga të dyja anët me ngjyrë të bardhë.

Shenjat e kaheve treguese për ndarjen e shiritave të trafikut në tunele (galeri), vendosen në distancën 6 m në rastin kur trafiku është dydrejtimësh në tunele, përkatësisht në distancën 12 m kur trafiku është njëdrejtimësh.



Kodi K37




Perdet dhe shiritat shërbejnë për kufizimin e sipërfaqeve të vogla (fig. K38).



Kodi K38


Rrethoja ndarëse (pengesat elastike) bëjnë ndarjen fizike të sipërfaqes së paraparë për trafikun nga kahja e kundërt dhe sipërfaqe të rrugës ku trafiku është i ndaluar, kodi K39.




Kodi K39

Rrethoja elastike (zgjerohen dhe ngushtohen) për mbylljen e sipërfaqeve të vogla lëvizëse, kodi K40 dhe kodi K41.





odi K40




Kodi K41

K

Barrierat dhe gjysmëbarrierat janë mjete për mbyllje të trafikut të mjeteve dhe këmbësorëve në kahun ku ato janë të vendosura tërthorazi. Në barriera drita e kuqe vezulluese vendoset në mes të mbrojtësit, ndërsa në gjysmëbarriera në fund të tij. Diametri i rrethit të dritës ndërprerëse minimum është 210 mm.

Barrierat të cilët janë të vendosura në vendkalimin hekurudhor, të cilat e mbyllin rrugën përgjatë tërë gjerësisë së saj, kodin K42, duhen shënuar së paku me tri drita të kuqe, me xham reflektues, prej të cilave njëra duhet të vendoset në mes të barrierave, ndërsa dy të tjerat në skajet e barrierës.



Kodi K42

Gjysmëbarrierat në vendkalimin hekurudhor mbyllin trafikun vetëm deri te mesi i gjerësisë së rrugës, kodin K43. Duhet shënuar të paktën me tri drita të kuqe reflektuese të vendosura në distancën e caktuar gjatë tërë gjatësisë së gjysmëbarrierës, prej të cilëve njëri duhet të vendoset në fundin e gjysmëbarrierës.



Kodi K43

Kur barriera dhe gjysmëbarriera vendosen në hyrje të vendparkingjeve ose garazheve, ato janë të ngjyrosura me të kuqe dhe, sipas mundësive, të shënuara me një xham reflektuese ngjyrë të kuqe.

Barriera dhe gjysmëbarriera duhet të jenë të shënuara me xhama ngjyrë të kuqe reflektues, edhe nëse janë të shënuara me shenja të veçanta të dritës pa ndërprerje ose vezulluese.

Xhamat reflektues nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni duhet të kenë sipërfaqe të paktën 40 cm dhe duhet të vendosen ashtu që të duken nga kahja e rrugës ku trafiku mbyllet.

Barriera dhe gjysmëbarriera duhet që gjatë tërë gjatësisë të jenë të mbështjella me materie retroreflektuese të klasës së dytë.

Pasqyrat e trafikut janë të destinuara për kyçje të sigurt nga rruga anësore në rrugë me përparësi kalimi ose në situata të ngjashme në vendet me dukshmëri të zvogëluar.

Skaji i jashtëm i pasqyrës së trafikut duhet të jetë i ngjyrosur alternativisht me fushë ngjyrë të kuqe dhe të bardhë.


Pasqyrat e trafikut mund të jenë të formës drejtkëndëshe ose rrethore, kodi K44 dhe kodi K45.



Kodi K44



Kodi K45



Pasqyra për më shumë siguri në trafik



Pasqyra për më shumë siguri në trafik

Me anë të këtyre pasqyrave kemi një pamje të qartë dhe të shkëlqyeshme si dhe dukshmëri në të gjitha kushtet e motit.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i pajisjeve të tjera në rrugë nga K01-K45;
- Vendosja e pajisjeve të tjera në rrugë, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të këtyre shenjave.

Pyetjet:

72. Format e pajisjeve të tjera në rrugë nga K01-K45
73. Ngjyrat e pajisjeve të tjera në rrugë nga K01-K45
74. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e pajisjeve të tjera në rrugë nga K01-K45
75. Tregoni pajisjet e tjera në rrugë nga K01-K45.

## 4 SHENJAT HORIZONTALE

### 4.1 SINJALIZIMI HORIZONTAL I RRUGËVE

Sinjalizimi horizontal i rrugëve duhet të bëhet në përputhje të plotë me kodin rrugor të Republikës së Kosovës. Edhe pse shpeshherë nënvlerësohet, sinjalizimi horizontal është një ndër elementet thelbësore të kontrollit dhe menaxhimit të trafikut si dhe sigurinë e komunikacionit rrugor në përgjithësi. Këto detyra arrihen:

- ♦ Duke i përdorur shenjat përkatëse;
- ♦ Duke i përdorur materialet e duhura;
- ♦ Duke i aplikuar si duhet;
- ♦ Duke siguruar funksionalitetin e tyre gjatë gjithë kohës.

Shenjat horizontale të komunikacionit kërkohet ta kenë dukshmërinë e mjaftueshme gjatë ditës, natës, ne kushte të pafavorshme atmosferike etj. Në përgjithësi shenjat e komunikacionit, si ato vertikale po ashtu edhe shenjat horizontale, kërkojnë mirëmbajtje duke e kontrolluar gjendjen e tyre rregullisht si dhe duke bërë riparimet e nevojshme ose ndërrimin e tërësishëm të tyre.

Ndërsa sa i përket ndarjes së shenjave horizontale, ato ndahen në:

- a. Vija gjatësore
- b. Tërthore
- c. Të pjerrëta dhe të lakuara
- d. Vendkalim këmbësorësh ose biçikletash
- e. Shigjetat drejtuese
- f. Shkrimet dhe simbolet
- g. Vijat kufizuese për vendet e parkimit, vendparkingjet e rezervuara
- h. Ishujt e trafikut, shenjat paraprake për pengesat brenda rrugës

- i. Vijat kufizuese të stacioneve të qëndrimit të mjeteve të transportit publik të linjës
- j. Shenjat e paralajmërimeve të ndryshme

#### 4.2 VENDOSJA E SHENJAVE HORIZONTALE NË RRUGË DHE SHKËLQIMI I TYRE

Shenjat horizontale në rrugë duhet të jenë me retrorefleksion. Retrorefleksion arrihet duke vendosur trupa retroreflektues në materialin për shënim. Këto materiale retroreflektuese kryesisht janë nga grimcat e qelqit, me një diametër nga 0.1 deri në 2.0 mm.

Retrorefleksioni duhet të shihet gjatë natës, kur dritat e automjetit godasin grimcat e qelqit në sipërfaqet e shënuara. Ndrërimi i automjetit në grimcat e qelqit pasqyrohet dhe kthehet përsëri tek shoferi dhe në këtë mënyrë u mundësohet dukshmëria më e mirë e sinjaleve horizontale (fig. 69). Gjatë ditës rrezet e diellit i godasin grimcat e qelqit në sipërfaqet e shënuara, ndrërimi nga drita e diellit reflekton në drejtim të shoferit, por edhe në drejtime të tjera.




Figura 69. Retrorefleksioni gjatë natës dhe ditës

Për fat të keq, për shkaqe fizike, efekti i retrorefleksionit në sipërfaqet e shënuara zvogëlohet me rritjen e lagështisë. Ky efekt arrihet me ndikimin e ujit i cili mbush sipërfaqen e shënuar, ku rruga optike e dritës ndryshohet në mënyrë të konsiderueshme, drita shtrembërohet në drejtime të ndryshme dhe nuk reflekton (fig. 70). Sidomos kur është errësirë dhe bie shi, kur përdoruesit e rrugës janë të varur nga një udhëzim i mirë vizual (fig. 70).




Figura 70. Retrorefleksionit gjatë kohës me shi me thyerje të dritës gjatë të reshurave

Për ta përmirësuar shkëlqimin (dukshmërinë) gjatë natës, kur bie shi dhe kur ka lagështi, mund të përdoren rruaza qelqi me diametër më të madh, deri në 2 mm ose duke ndryshuar strukturën e shenjës në rrugë, tipi i dytë i shenjave (fig. 71). Në këtë mënyrë mund të arrihet retrorefleksioni edhe në kushte të lagështisë për shkak se sipërfaqja e shënuar ka një komponentë të madhe vertikale.




Figura 71. Retrorefleksioni në kushtet me lagështi dhe reflektimi i dritës te ngasësi

Shenjat konvencionale në sipërfaqet e rrugëve zakonisht nuk kanë pasur retrorefleksion gjatë natës kur koha ka qenë me lagështi. Ky lloj i shenjave quhet tipi i parë i shenjave. Shënimet në sipërfaqet e rrugëve, veçanërisht me retrorefleksion të fortë gjatë natës dhe kur ka lagështi, quhet tipi i dytë i shenjave.

Tipi i parë nuk ka veti të veçanta.

Tipi i dytë i vijëzimit në rrugë është me veti të veçanta për kushtet e drejtimit të reflektimit (fig. 72). Ky tip i vijave mund të ndryshojë për nga forma. Mund të jetë me pika (fig. 72), linja sistematike (fig. 72), kaotike (vrazhda) (fig. 72).

Arsye tjetër e këtij tipi të vijave është edhe siguria gjatë ngasjes sepse udhëzojnë ngasësit të mos dalin nga rruga. Në rast se automjeti shkel mbi këtë lloj të vijës emitohen dridhje të lehta si dhe dëgjohet një zhurmë e cila njofton ngasësin se është duke dalë nga traseja e rrugës.





Figura 72. Pika, linja sistematike, kaotike (vrazhda)

Është shumë e rëndësishme që gjatë vendosjes së shenjave horizontale të përdoren edhe trupat adekuatë reflektues. Për këtë ekzistojnë instrumente të veçanta për përcaktimin e retrorefleksionit gjatë natës ( $R_L$ ), gjatë ditës ( $Q_D$ ) si dhe në kushtet e lagështisë. Një nga këto instrumente është paraqitur në fig. 73. Instrumenti përdoret duke vendosur mbi shenjën horizontale, ku brenda një kohe shumë të shkurtër përcakton retrorefleksionin.

Sipas standardeve evropiane EN 1436, shenjat horizontale duhet ta kenë këtë intensitet të retrorefleksionit gjatë ditës, natës dhe kohës me lagështi, (tabela 25, 26) dhe 27).

Tabela 25. Retrorefleksioni i shenjave sipas standardeve evropiane EN 1436

Tipi i shënjimit	Ngjyra	Klasa	Koeficienti minimal i shkëlqimit të retrorefleksionit $R_L$ $\text{mcd}\cdot\text{m}^{-2}\cdot\text{lx}^{-1}$
Të përhershme	Bardhë	R0	E pa përcaktuar
		R2	$R_L \geq 100$
		R3	$R_L \geq 150$
		R4	$R_L \geq 200$
		R5	$R_L \geq 300$
	Verdhë	R0	E pa përcaktuar
		R1	$R_L \geq 80$
		R2	$R_L \geq 150$
		R3	$R_L \geq 200$
		R5	$R_L \geq 300$
Të përkohshme		R0	E pa përcaktuar
		R3	$R_L \geq 150$
		R5	$R_L \geq 300$

**Klasa R0 është për kushtet ku dukshmëria e rrugës arrihet pa retrorefleksion**

Tabela 26. Intensiteti i retrorefleksionit gjatë ditës (QD) në gjendje të thatë

Ngjyra	Lloji i sipërfaqes së rrugës	Klasa	Koeficienti minimal i shkëlqimit të retrorefleksionit $Q_d$ $\text{mcd}\cdot\text{m}^{-2}\cdot\text{lx}^{-1}$
Bardhë	Asfalt	Q0	E pa përcaktuar
		Q2	$Q_d \geq 100$
		Q3	$Q_d \geq 130$
		Q4	$Q_d \geq 160$
	Beton	Q0	E pa përcaktuar
		Q3	$Q_d \geq 130$
		Q4	$Q_d \geq 160$
		Q5	$Q_d \geq 200$
Verdhë		Q0	E pa përcaktuar
		Q1	$Q_d \geq 80$
		Q2	$Q_d \geq 100$
		Q3	$Q_d \geq 130$

**Klasa Q0 është për kushtet ku dukshmëria e shenjave të rrugës arrihet pa retrorefleksion**

Tabela 27. Intensiteti i retrorefleksionit gjatë natës (RL) në gjendje të lagësht

Kushtet për matjen e retrorefleksionit në gjendje të lagësht	Klasa	Koeficienti minimal i shkëlqimit të retrorefleksionit $R_L$ $\text{mcd} \cdot \text{m}^2 \cdot \text{lx}^{-1}$
Ky test bëhet duke derdhur ujë të pastër nga një kovë prej 10 litrash dhe nga një lartësi prej 0.5m nga sipërfaqja e rrugës. Uji duhet të derdhet në mënyrë të barabartë në tërë sipërfaqen matëse. Zona matëse përkohësisht duhet të përmbysset (mbulohet) nga uji. Koeficienti $R_L$ i shkëlqimit të retrorefleksionit në kushte të lagështisë duhet të matet një minutë pas derdhjes së ujit.	RW0 RW1 RW2 RW3 RW4	E papërcaktuar $R_L \geq 25$ $R_L \geq 35$ $R_L \geq 50$ $R_L \geq 75$
Klasa RW0 për situatat kur retrorefleksioni nuk kërkohet për arsye ekonomike apo teknologjike		



Figura 73. Pajisje për matjen e retrorefleksionit

### 4.3 MATERIALET

Materialet për shënimet në rrugë janë materiale të parafabrikuara ose të parashënuara. Elementet për shënimin e shenjave janë komponente inerte të ndara.

Ngjyrat e shenjave në rrugë ndahen në pesë grupe të ndryshme të substancave:

Plastikë e ftohtë

Ngjyrosje e thjeshtë

Termoplastikë

Termoplastikë e paraformuar

Shirit.

**Plastika e ftohtë** është një përzierje e dy deri tre komponentëve që, së bashku, krijojnë një reaksion kimik. Plastika e ftohtë mund të aplikohet për zonat ku ka trafik me intensitet të lartë dhe në zonat e ndryshme klimatike. Aplikimi i plastikës së ftohtë mund të bëhet me makina ose me dorë. Retrorefleksioni arrihet duke i ngulitur rruaza qelqi në material. Ky lloj i shënjimit të plastikës së ftohtë mund të përdoret për tipin e parë dhe tipin e dytë të shenjave si dhe për shiritat për të verbrit.

**Ngjyrosja e thjeshtë** është ngjyrë që aplikohet në rrugët me intensitet të vogël të trafikut, zakonisht përdoret në rrugët lokale, në parkingje, depo etj. Aplikimi bëhet me makina.

**Termoplastika** është kategori e materialeve për shënimin e rrugëve e cila vendoset në gjendje të ngrohtë. Përdoret në zona me intensitet të lartë të trafikut si dhe në zonat e ndryshme klimatike. Aplikimi mund të bëhet me makinë ose me dorë. Retrorefleksioni arrihet duke i ngulitur rruaza qelqi në material. Ky lloj i shenjzimit të plastikës së ftohtë mund të përdoret për tipin e parë dhe tipin e dytë të shenjave.

**Termoplastika e paraformuar** përdoret kryesisht për shenjzimin e simboleve, p. sh., vendkalimet e këmbësorëve, shtigjet e biçikletave, simbolet për persona me aftësi të kufizuara, shigjeta, shënime në rrugë etj. Aplikimi bëhet me anë të ngjitësit dhe flakëdhësit me gaz.

**Shiriti** është një lloj materiali fleksibil me retrorefleksion me rruaza qelqi të vendosura paraprakisht. Ky lloj shenjzimi zakonisht aplikohet për shenja të përkohshme të cilat hiqen lehtë.

#### 4.4 VIJAT GJATËSORE NË RRUGË DHE NDARJA E TYRE

Shënjimet në rrugë përmbushin një shumëllojshmëri të detyrave për ta përmirësuar rrjedhën e trafikut dhe për ta mundësuar orientimin e trafikut në mënyrë të qartë dhe të sigurt. Vijat gjatësore të rrugës janë të vendosura përgjatë rrugës (paralel me boshtin e rrugës), njëherësh shërbejnë për ndarjen e sipërfaqeve të rrugës duke mundësuar zhvillim më të sigurt të trafikut, përcaktim të gjerësisë së rrugës të cilën e shfrytëzojnë pjesëmarrësit në trafik.

Vijat gjatësore në rrugë ndahen:

- ♦ Vijat e korsisë dhe të ndarjes së drejtimit të qarkullimit
- ♦ Vijat anësore (vijat që shënon skajin e rrugës)
- ♦ Vijat udhëheqëse (udhërrëfyeset).

Vijat gjatësore sipas fushave ndahen edhe në:

- ♦ Vija gjatësore të plota
- ♦ Vija gjatësore të ndërprera
- ♦ Vija gjatësore të dyfishta.

Vija e plotë gjatësore (ndarëse dhe anësore) shënon ndalimin e kalimit të mjeteve përtej asaj vije si dhe ndalimin e lëvizjes së mjeteve në vijë.

Trashësia e vendosjes së vijave nuk bën të jetë më e madhe se 0.6 cm si dhe nuk bën ta rrisin rrëshqitshmërinë e rrugës. Në raste të veçanta trashësia

e vijave mund të bëhet edhe më e madhe se 0.6 cm, deri në 2.0 cm. Vija e mesit ose e skajeve të rrugës ose devijimit, trashësia e tyre nuk bën të jetë më e madhe se 2.0 cm. Për matjen e trashësisë së vendosjes së shenjave në rrugë ekzistojnë instrumente të veçanta për këto lloje të matjeve. Një nga këto instrumente është paraqitur në fig. 74. Për matjen e rezistencës së fërkimit dhe qëndrueshmërinë e shenjave horizontale përdoret instrumenti i paraqitur në fig.75.



Figura 74. Matësi i trashësisë së ngjyrës      Figura 75. Matësi i rezistencës së fërkimit

Këto lloje të instrumenteve përdoren edhe në shenjat tërthore dhe shenjat e tjera të sinjalizimit horizontal.

#### 4.4.1 NGJYRA E SHENJAVE HORIZONTALE NË RRUGË









Shenjat në sipërfaqen e rrugës janë me ngjyrë të bardhë, me përjashtim të disa shenjave të cilat kanë ngjyrë të verdhë. Shenja me ngjyrë të verdhë janë:

- Shënimi i vendeve në rrugë dhe vendkalimeve për këmbësorë ku ndalohet parkimi;
- Vija për ndarjen e shiritave për lëvizjen e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve;
- Shenjat e vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara;
- Shenjat për qëllime të caktuara, si: stacion i autobusëve, taksi, policia, shtigjet e çiklistëve, shtigjet e këmbësorëve etj.;
- Pajisjet për qetësimin e komunikacionit, sipërfaqet e ngritura dhe gungat në rrugë;
- Shenjat e përkohshme për orientimin e trafikut, punimeve në rrugë dhe shënimi i rrezeve të përkohshme në rrugë.

Tabela 28. Gjerësia e vijave sipas rangut të rrugës


Gjerësia e vijave	Gjerësia e rrugës			
	2.5m deri 2.75 m	2.75m deri 3m	3.0m deri 3.5m	Mbi 3.5m
Vijë të njëfishtë	10 cm	12 cm	15 cm	20 cm
Vijë e dyfishtë	10+10+10	12+10+12	15+10+15	20+10+20

Tabela 29. Format e vijave dhe llojet e tyre

Lloji i vijës	Përshkrimi	Forma
Vija e pandërprerë	Gjerësia e vijës (b) sipas tab. 4	
Vija e ndërprerë	Gjatësia 1-1-1: një fushë e plotë, një e zbrazët	
Vija e ndërprerë	Gjatësia 1-2-1: një fushë e plotë, dy fusha të zbrazëta, një fushë e plotë	
Vija e ndërprerë e shkurtër	Gjatësia 1m 1-1-1: një fushë e plotë një e zbrazët	
Vija e ndërprerë e gjere	Gjatësia 1m 1-1-1: një fushë e plotë, një e zbrazët. Gjerësia $b=0.3\div 0.5$	
Vija e dyfishtë	Gjerësia e vijës (b) sipas tab. 4	
Vija e dyfishtë e kombinuar	Gjerësia e vijës (b) sipas tab. 4 Gjatësia 1-2-1	
Vija e dyfishtë e ndërprerë	Gjerësia e vijës (b) sipas tab. 4 Gjatësia 1-1-1	




Vija gjatësore e njëfishtë H01 është vijë e plotë e cila ndalon tejkalimin e automjeteve, pos mjeteve të cilat zhvillojnë shpejtësi më të vogël se 30km/h dhe mjeteve që nuk konsiderohen mjete motorike. Ngjyra e vijave është e bardhë.




H01

Vija gjatësore e njëfishtë H02 është vijë ndarëse, e ndërprerë, e shkurtër, vijë e ndërprerë e gjerë dhe vijë paralajmëruese. Ngjyra e vijave është e bardhë.




H02

Vija gjatësore e njëfishtë H03 është vijë paralajmëruese e cila paraqet afërsinë e vijës së plotë ndarëse. Ngjyra e vijave është e bardhë.



H03

Vija gjatësore H04 është vijë e ndërprerë, e cila shërben për ndarjen e shiritave të qarkullimit në afërsi të kryqëzimit, si vijë udhëzuese në kryqëzime si dhe shërben për ndarjen e shiritave të trafikut për mjetet e transportit publik. Ngjyra e vijave është e bardhë.




Vijat ndarëse të dyfishta mund të jenë:

- ♦ Vijë e plotë
- ♦ Vijë e ndërprerë
- ♦ Vijë e kombinuar

Vijat e dyfishta të pandërprera (të plota) H05 bëjnë pjesë në vijat gjatësore në rrugë të cilat e ndalojnë kalimin apo ndaljen e mjeteve mbi vija.


Vijat e dyfishta të pandërprera aplikohen në rrugët me trafik në dy drejtime:

- ♦ Në rrugët ku janë më shumë se dy shiritat qarkullues në një drejtim;
- ♦ Në rrugët ku numri i shiritave është tek në qoftë se tejkalimi ndalohet në të dyja kahet;
- ♦ Në afërsi të tuneleve, së paku 200 m si dhe në tunele;
- ♦ Nëse një gjë të tillë e kërkojnë kushtet e sigurisë së trafikut;
- ♦ Ngjyra e vijave është e bardhë.




H05

Vijat e dyfishta të ndërprera H06 bëjnë pjesë në vijat gjatësore në rrugë të cilat shërbejnë për ndarjen dhe shënimin e shiritave të trafikut në kahe të ndryshme të lëvizjes ku trafiku udhëhiqet me shenja ndriçuese. Ngjyra e vijave është e bardhë.



H06


Vijat e dyfishta të kombinuara H07 bëjnë pjesë në vijat gjatësore në rrugë të cilat shërbejnë për ndarjen e shiritave qarkullues të trafikut të cilat, varësisht nga kushtet e dukshmërisë, e lejojnë apo e ndalojnë tejkalimin vetëm nga një kah i lëvizjes. Ngjyra e vijave është e bardhë, ndërsa gjerësia në mes të vijave shih Tab. 29.



H07

Vendosja e sinjaleve horizontale gjatësore në afërsi të qafëmalit, kryqëzimit, kalimit të rrugës mbi binarët hekurudhorë në nivel në zonat dhe vendbanimet ku dukshmëria e rrugës është e zvogëluar dukshëm, në këto pozicione duhet të aplikohen vijat paralele të pandërprera të plotë ose vija të dyfishta, ku njëra nga vijat është e plotë dhe tjetra është e ndërprerë.

Vijat e kombinuara të njëfishta dhe të dyfishta H08, H09, H10 bëjnë pjesë në vijat gjatësore në rrugë të cilat shërbejnë për ndarjen dhe shënimin e shiritave të trafikut. Ngjyra e vijave është e bardhë, ndërsa gjerësia dhe gjatësia në mes të vijave shih Tab. 29, 30.




$n > 1:60$  për  $v > 50$  km/h

$N < 1:30$  për  $v < 50$  km/h


H08

*L*-Gjatësia e shikushmërisë  
*M*-(A-B,C-D)-Gjerësia e shikushmërisë  
*H*-Lartësia e shikushmërisë



H09

*L*= Largësia e shikushmërisë  
*M*-(A-B,C-D)= Gjerësia e shikushmërisë



H10

*L*= Gjatësia e shikushmërisë  
*M*-(A-B, C-D)=Gjerësia e shikushmërisë

Përcaktimi i gjatësisë së dukshmërisë (M) bëhet sipas shpejtësisë së lëvizjes së automjeteve në atë segment rrugor.

Tabela 30. Gjatësia e dukshmërisë sipas shpejtësisë në km/h

Gjatësia e dukshmërisë (M) dhe fillimi i vijës paralajmëruese		
Shpejtësia km/h	Dukshmëria (M)	Vija Paralajmëruese
130	200 m deri 400 m	160 m
100	160 m deri 320 m	120 m
80	130 m deri 260 m	100 m
60	50 m deri 100 m	80 m
40		60 m

Vija paralajmëruese mund të plotësohet edhe me një apo më shumë shigjeta (H26), e cila tregon se cilin nga shiritat e trafikut duhet shfrytëzuar.

## 4.5 VIJAT TËRTHORE

Shenjat tërthore në rrugë janë sinjale të cilat shërbejnë për ndalimin, orientimin dhe sigurinë e trafikut në përgjithësi. Për nga forma janë shenja me vija të plota ose të ndërprera të cilat vendosen tërthorazi në rrugë. Ky lloj i shenjave mund të përfshijë një apo më shumë shirita të trafikut.

Llojet e shenjave tërthore të sinjalizimit horizontal janë:



- ♦ Vija e ndalimit;
- ♦ Vija e pjerrët;
- ♦ Kufizuesit;
- ♦ Vendkalimi i këmbësorëve;
- ♦ Vendkalimi i shtegut të çiklistëve.

Vijat e ndalimit përcaktojnë vendin ku drejtuesi i mjetit është i obliguar të ndalet. Ky lloj i vijave mund të jenë vija të plota ose të ndërprera. Vendosja e vijave të ndalimit bëhet në ato pozicione ku i mundësohet ngasësit dukshmëri e mjaftueshme mbi trafikun e mjeteve dhe këmbësorëve në kryqëzimin e rrugëve.


Vija e plotë e ndalimit H11 bën pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor, e cila përcakton vendin ku drejtuesi i mjetit është i obliguar ta ndalë mjetin e tij. Para vijës së ndalimit mund të shkruhet edhe shenja STOP. Ngjyra e shenjës është e bardhë.

Vija e ndërprerë e ndalimit H12 bën pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor, e cila përcakton vendin ku drejtuesi i mjetit, sipas nevojës, duhet ta ndalë mjetin dhe, nëse është e nevojshme, t'ua japë përparësi mjeteve të tjera të cilat lëvizin në rrugë me përparësi kalimi, sikur tek shenja H11 së cilës mund t'i shtohet shenja STOP. Edhe tek kjo shenjë mund të vendoset shenja trekëndësh me majë, të kthyer përballë shoferit. Ngjyra e shenjës është e bardhë.

Shenja H13 bën pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor. Kjo përcakton vendin ku drejtuesi i mjetit, sipas nevojës, duhet ta ndalë mjetin dhe, nëse është e nevojshme, t'u japë përparësi mjeteve të tjera të cilat lëvizin në rrugë me përparësi kalimi. Në vend të vijave të ndërprera vendosen trekëndësha me majë të kthyer përballë shoferit. Ngjyra e shenjës është e bardhë.



H11



H12

H13




Figura 76. Dimensionet e vendosjes së shenjave horizontale në afërsi të kryqëzimit



Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:


- Vendosja dhe kuptimi i vijave gjatësore dhe tërthore nga H01-H13;
- Vijat gjatësore dhe tërthore, vendosja e tyre, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të këtyre shenjave.

Pyetjet:


76. Forma e vijave gjatësore dhe tërthore nga H01-H13
77. Ngjyrat e vijave gjatësore dhe tërthore nga H01-H13
78. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e vijave gjatësore dhe tërthore nga H01-H13
79. Tregoni vijat gjatësore dhe tërthore nga H01-H13.

## 4.6 VIJAT E PJERRËTA DHE TË LAKUARA

Vijat e pjerrëta H14 dhe H15 bëjnë pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor të cilat përcaktojnë vendin e hapjes së shiritit dalës apo vendin e mbylljes së shiritit të trafikut. Këto shenja zakonisht përdoren në autostrada dhe në rrugë të rezervuara për mjete motorike. Ngjyra e shenjave është e bardhë.




Vija e pjerrët H16 bën pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor dhe përcakton vendin e hapjes dhe të mbylljes së trafikut i cili është i destinuar për transportin publik të udhëtarëve. Ngjyra e shenjës është e bardhë.



H16


Kufizuesit H17 bëjnë pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor e cila shënon vendin në të cilin është e nevojshme ndarja e pjesës së rrugës në të cilin është ndaluar trafiku. Ngjyra e shenjës është e bardhë.




H17

#### 4.7 VENDKALIM KËMBËSORËSH OSE BIÇIKLETASH


Vendkalimi i këmbësorëve H18 bën pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor e cila shënon vendin ose pjesën e sipërfaqes së rrugës që është e destinuar për kalimin e këmbësorëve. Në vendet ku vendkalimi është në afërsi të shkollës duhet të shkruhet mbishkrimi “Shkolla”. Ngjyra e shenjës është e bardhë. Në ato vende ku nuk mund të shënohet vendkalimi i këmbësorëve me ngjyrë, atëherë vendkalimi mund të shënohet me elemente të çelikut, plastikës, kona ose shenja retroreflektuese. Shenja horizontale vendkalim i këmbësorëve kombinohet me shenjën vertikale C02 dhe A33 (vendkalim i shënuar për këmbësorë).




H18



Kalimi i shtegut të biçiklistëve, përtej rrugës H19, bën pjesë në shenjat tërthore të trafikut rrugor dhe shënon vendin ose pjesën e sipërfaqes së rrugës që është e destinuar për kalimin e biçiklistëve. Ngjyra e shenjës është e bardhë.



H19



Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave nga H14-H19;
- Vendosja e shenjave, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të këtyre shenjave.

Pyetjet:

80. Forma e shenjave nga H14-H19

81. Ngjyrat e shenjave nga H14-H19

82. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shenjave nga H14-H19

83. Tregoni shenjat nga H14-H19.

## 4.8 SHIGJETA DREJTUESE

Në shenjat e tjera në rrugë dhe objektet në skaje ose përgjatë skajeve të rrugëve bëjnë pjesë:

- ♦ Shigjetat;
- ♦ Fushat për orientimin e trafikut;
- ♦ Vijat orientuese;
- ♦ Shenjat për shënimin e sipërfaqeve të rrugës për qëllime të veçanta.

Shigjetat H20, H21, H22, H23, H24, H25, H26 bëjnë pjesë në shenjat e tjera të trafikut rrugor me të cilat shënohet kahja e detyruar e lëvizjes së mjeteve. Me anë të shigjetave të vendosura në rrugë ngasësit e automjeteve paralajmërohen për destinimin e shiritave me vijë të ndërprerë ose të kufizuar ku u lejohe ndërrimi i shiritave. Me anë të shigjetave mund të shënohen: një kaheje H20, dy kaheje H21 dhe H22, rreshtim për dy kryqëzime të afërta, ku rreshtimi kryhet para kryqit të parë, por që e kanë të ndaluar kthimin në kryqëzimin e parë H23. Kahja e lëvizjes për në garazhe H24, kthimi në komunikacion H25, paralajmërimi i përfundimit të tejkalimit H26. Ngjyra e shenjave është e bardhë.



H20



H21




H22




H23



H24



H25



H26




Figura 77. Dimensionet e shigjetave orientuese të gjatësisë 5 m




Figura 78. Dimensionet e shigjetave orientuese të gjatësisë 7 m






Figura 79. Dimensionet e shigjetave orientuese për dy kryqëzime të afërta të gjatësisë 5 m dhe 7 m




Figura 80. Dimensionet e shigjetës kthim në trafik dhe kahja e lëvizjes për në garazhe

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shigjetave drejtuese nga H20-H26;
- Vendosja e shigjetave drejtuese, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të këtyre shenjave.

Pyetjet:







84. Forma e shigjetave drejtuese nga H20-H26
85. Ngjyrat e shigjetave drejtuese nga H20-H26
86. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shigjetave drejtuese nga H20-H26
87. Tregoni shigjetat drejtuese nga H20-H26.

## 4.9 SHKRIME DHE SIMBOLE

Mbishkrimet apo simbolet në rrugë bëjnë pjesë në shenjat e tjera të trafikut të cilat u japin informata të nevojshme ngasësve për mënyrën e sjelljes në atë pjesë të rrugës.

Tabela 31. Shkrimet dhe simbolet në rrugë

Shkrimet dhe simbolet në rrugë			
Përshkrimi	Kodi	Ngjyra	Forma
Paraqet shiritin apo vendqëndrimin e autobusit	H38	E verdhë	BUS
Paraqet vendin në të cilin ngasësi është i detyruar të ndalet, p. sh., para vendkalimit	H39	E bardhë	STOP
Paraqet shiritin që është i rezervuar për tramvaj	H40	E bardhë	TRAMVAJI
Paraqet vendqëndrimin e taksistëve	H41	E verdhë	TAXI
Paraqet afërsinë e vendit ku është shkolla. Para vendkalimit në afërsi të shkollave duhet të vendoset ky mbishkrim	H42	E bardhë	SHKOLLA
Paraqet vendkalimin e trenit	H43	E bardhë	TRENI

Paraqet drejtimin	H44	E bardhë	PEJË
Paraqet vendin ku fillon kufizimi i shpejtësisë, në rastin tonë 50km/h	H45	E kuqe, e bardhë, e zeze	
Paralajmëron ngasësit për afërsinë e vendit ku mund të ketë fëmijë në rrugë	H46	E kuqe, e bardhë, e zeze	
Paraqet zonën ku është e kufizuar shpejtësia	H47	E kuqe, e bardhë, e zeze	
Paraqet sipërfaqen e shtegut për persona me aftësi të veçanta (aftësi ndryshe)	H48	E bardhë	
Paraqet sipërfaqen e shtegut për biçikleta	H49	E bardhë	
Paraqet vendin në të cilin ngasësi është duke u kyçur në rrugën me përparëses kalimi	H50	E bardhë	

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shkrimeve dhe simboleve nga H38-H50;
- Vendosja e shkrimeve dhe simboleve, distanca e vendosjes sipas rangut të rrugës si dhe ngjyrat bazë të tyre.

Pyetjet:





88. Forma e shkrimeve dhe simboleve nga H38-H50
89. Ngjyrat e shkrimeve dhe simboleve nga H38-H50
90. Tregoni vendosjen dhe kuptimin e shkrimeve dhe simboleve nga H38-H50
91. Tregoni shkrimet dhe simbolet nga H38-H50.

#### 4.10 VIJAT KUFIZUESE PËR VENDET E PARKIMIT, VENDPARKINGJET E REZERVUARA

Shënimi i vendeve për parkimin e automjeteve bën pjesë në shenjat e tjera të trafikut. Shërben për shënimin e hapësirave për parkim. Mbishkrimet në vendparkingje mund ta përcaktojnë vendin e rezervuar, si: vendparkim për autobus, për taksì, për persona me aftësi të kufizuara etj. Vendparkimet mund të jenë:

- për së gjati
- pjerrtas
- vertikalisht




Tabela 32. Vendparkimet dhe format e tyre






Vendparkimet dhe format e tyre			
Përshkrimi	Kodi	Ngjyra	Forma
Vendparkimi për persona me aftësi të kufizuara	H56	E bardhë, e verdhë	
Vendparkimi për së gjati	H60	E bardhë	
Vendparkimi pjerrtas	H61	E bardhë	
Vendparkimi vertikal	H62	E bardhë	

#### 4.11 ISHUJT E TRAFIKUT, SHENJAT PARAPRAKE PËR PENGESAT BRENDA RRUGËS

Ishujt e trafikut apo fushat për orientimin e trafikut bëjnë pjesë në shenjat e tjera të trafikut. Ata shënojnë sipërfaqen e rrugës në të cilën është i ndaluar lëvizja dhe ndalja e mjeteve në atë pjesë. Ngjyra e shenjave është e bardhë.

Tabela 33. Ishujt e trafikut për orientim

Ishujt e trafikut për orientim		
Përshkrimi	Kodi	Forma
Vendoset në mes të dy shiritave me kah të kundërt	H27	
Vendoset në mes të dy shiritave me kah të njëjtë	H28	 H28
Vendoset në vendet ku bëhet hapja e një shiriti të veçantë për kthim	H29	

Vendoset përpara ishujve për ndarjen e rrjedhës së trafikut	H30		
	H31		
	H32		
Vendoset në krahun për hyrje në autostradë	H33		
Vendoset në krahun për daljen nga autostrada	H34		






Figura 81. Dimensionet e fushave për orientim

Pengesat brenda rrugës apo gungat artificiale (kurrizet artificiale) bëjnë pjesë në shenjat e tjera të trafikut. Shërbejnë për qetësimin dhe detyrimin e ngadalësimit të lëvizjes së mjeteve në trafik. Vendosen në rrugët urbane, gjegjësisht në vendet ku kërkohet ngadalësimi i shpejtësisë për arsye të ndryshme.

Gungat mund të vendosen përgjatë gjysmës apo gjithë gjerësisë së shiritit të trafikut. Nëse gungat vendosen njëra pas tjetrës, nuk bën të jenë më afër se 20 m dhe më larg se 60 m nga njëra-tjetra.



Dimensionet e gungave ndryshojnë në bazë të shpejtësisë.

Dimensionet janë të paraqitura në tab. 34.

Tabela 34. Dimensionet e gungave varësisht nga shpejtësia  
Dimensionet e gungave varësisht nga shpejtësia

Shpejtësia km/h	Gjerësia cm	Lartësia cm
50	60	3
40	90	5
30	120	7

Tabela 35. Gungat artificiale

Gungat artificiale			
Përshkrimi	Kodi	Ngjyra	Forma
Gunga artificiale e ngushtë	H63	E verdhë dhe e zezë	
Gunga artificiale e gjerë (sipërfaqe e ngritur)	H64	E verdhë	


Pos gungave artificiale që janë nga plastika, gungat mund të punohen edhe në vend nga asfalti apo betoni.

#### 4.12 VIJAT KUFIZUESE TË STACIONEVE TË QËNDRIMIT TË MJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK TË LINJËS


Shënimet në sipërfaqen e rrugës për mjetet e veçanta apo vijat kufizuese të qëndrimit të mjeteve të transportit publik si autobus dhe taksi H52 dhe H54 shënohen me shirit gjatësor të verdhë. Brenda vendparkimit apo vendndaljes shënohet “BUS” apo “TAXI”. Për vendparkimin “BUS”, në zonën përpara dhe prapa vendqëndrimit shënohen disa vija në formë zigzage, të cilat e përcaktojnë zonën e vendqëndrimit të mjetit të transportit publik. Në këtë zonë ku janë shiritat e verdhë për mjete të transportit publik apo që janë të shënuara mbishkrimet “BUS” dhe “TAXI” është i ndaluar parkimi i çdo mjeti tjetër.



H52



H53



H54




H55

#### 4.13 SHENJAT E PARALAJMËRIMEVE TË NDRYSHME

Shenjat e paralajmërimeve të ndryshme janë me viza të pjerrëta, me ngjyrë të kuqe dhe të bardhë ose bardhë dhe zi. Këto shenja zakonisht vendosen në sipërfaqet vertikale që tregojnë pengesat e përhershme brenda profilit apo zonat e kalimit të këmbësorëve.


Elementet/konstruksionet dhe pajisjet e rrugëve publike dhe objektet të cilat nënkuptojnë pengesa të përhershme brenda madhësisë së profilit të komunikacionit shënohen kuq e bardhë, ndërsa profili i lirë bardhë e zi (fig. H65).



H65

Vija në mbështjellësin e tunelit shënohet gjatë gjithë gjatësisë së tunelit në anën në të cilën janë hyrjet e zonave të kalimit të këmbësorëve dhe kalimet për mjete, me vijë të gjerësisë 50 cm në ngjyrë të kuqe (RAL, 2002) (fig. H66). Vijat informuese për evakuim të vendosura në mbështjellësin e

tunelit punohen në atë mënyrë që skaji i poshtëm i vijës duhet të jetë në lartësinë, së paku 90 cm nga niveli i korridorit të këmbësorëve.



Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Vendosja dhe kuptimi i shenjave horizontale;
- Llojet e shenjave horizontale, retrorefleksioni, llojet e materialeve, ngjyrat e shenjave horizontale, llojet e vijave gjatësore, simbolet.

Pyetjet:

92. Si bëhet ndarja e shenjave horizontale?
93. Si ndikon lagështia (shiu) gjatë natës në shenjat horizontale?
94. Kur arrihet retrorefleksioni më i mirë në kushtet e lagështisë (shiu)?
95. Në sa grupe ndahen dhe cilat janë llojet e ngjyrave sipas substancave?
96. Cilat janë vijat gjatësore në rrugë?
97. Vijat gjatësore sipas fushave ndahen në?
98. Cijat janë vijat tërthore të sinjalizimit horizontal?
99. Sipas formës, vendparkimet mund të jenë?
100. Cila është ngjyra e shënimit të vendparkimit për persona me aftësi të kufizuara?
101. Cilat janë shënimet dhe simbolet në rrugë, së paku 10 simbole?

## 5 SINJALET E POLICËVE TË TRAFIKUT

Kur një zyrtar (oficer) policie është në mes të kryqëzimit apo në rrugë duke e rregulluar trafikun, rregullat e tjera të trafikut më nuk vlejné, si: semaforët, shenjat vertikale, rregullat e përgjithshme të komunikacionit. Rregullat e sinjaleve në trafik janë të paraqitura në figurën 18, e cila tregon se çdo lloj shenje apo sinjali bie kur trafiku është duke u rregulluar nga zyrtari policor.

Shenjat të cilat i përdorë polici i trafikut apo personi i autorizuar mund të jenë me:

- Duar, ose me tabelë, si dhe nga mjete,
- Pozicioni i trupit,
- Fërshëllima (bilbil),
- Mjeti ndriçues.



Figura 82. Rregullat e prioriteteve të sinjalizimit

## 5.1 SHENJAT ME ANË TË DUARVE

Në fig. 83 është paraqitur një shembull ku polici qëndron në mes të kryqëzimit duke e rregulluar trafikun. Në këtë rast polici liron trafikun e automjeteve në drejtimet ku sinjali tregon dritën e kuqe. Edhe pse drejtimet e tjera i kanë sinjalet ndriçuese që tregojnë dritën e gjelbër, nuk kanë të drejtën e kalimit sepse e shohin gjoksin apo shpinën e policit. Në këtë rast sinjalet ndriçuese bien dhe nuk kanë asnjë kuptim, dmth. duhet të respektohen shenjat e personit të autorizuar - policit.




Figura 83. Pozicioni i policit në kryqëzim

Polici i kthyer anash, me krah të shtrirë në kryqëzim, lejon kalimin e mjeteve në drejtim të krahëve (fig. 84). Pra, shoferëve të mjeteve të cilat e shohin policin me krahun e zgjatur në drejtim të tyre u lejohe kalimi, kurse mjeteve që janë përballë gjoksit dhe shpinës së policit u ndalohe kalimi (fig. 85).



Figura 84. Kalim i lirë



Figura 85. Ndalim kalimi

Në fig. 86 është paraqitur pozicioni i personit të autorizuar në kryqëzim, i cili, me anë të shigjetave, tregon lëvizjet e mjeteve dhe të këmbësorëve që u është dhënë e drejta e kalimit të lirë dhe atyre që u është ndaluar kalimi.






Figura 86. Kahet e ndalimit dhe lejimit të kalimit, pozicioni i policit në kryqëzim

Ngritja e dorës së djathtë vertikalisht me shuplakë të hapur, ndalim i detyruar për të gjithë pjesëmarrësit në trafik të cilat nuk kanë hyrë në kryqëzim. Pas këtij veprimi polici ndërron pozitën dhe fillon urdhëresat e tjera. Në çdo përfundim të rregullimit të trafikut nga ana e policit, polici e ngre dorën dhe urdhëron mjetet në secilën kah ta fillojnë lëvizjen duke u bazuar në sinjalet ndriçuese, vertikale apo rregullave të përgjithshme të komunikacionit (fig. 87).



Figura 87. Ndalim kalimi për të gjithë pjesëmarrësit në trafik

Krahasimi i shenjave të policit me anë të duarve dhe sinjalizimit ndriçues është treguar në fig. 88.




Figura 88. Krahasimi i shenjave të policit me semafor

Personi i autorizuar me dorë të shtrirë horizontalisht me shuplakë të hapur (fig. 89), njofton për ndalim të kalimit për të gjithë pjesëmarrësit në trafik të cilët e presin drejtimin e dorës së shtrirë. Në fig. 89 është paraqitur pozicioni i personit të autorizuar në kryqëzim, ku me anë të shigjetave tregohen lëvizjet e mjeteve dhe këmbësoreve që u është dhënë e drejta e kalimit të lirë dhe atyre që u është ndaluar kalimi.




Figura 89. Ndalim kalimi për pjesëmarrësit të cilët presin drejtimin e dorës, si dhe pozicionin e policit brenda kryqëzimit

## 5.2 SHENJAT ME POZICION TË TRUPIT

Policët e rregullojnë rrjedhshmërinë e qarkullimit të trafikut duke e zvogëluar, rritur shpejtësinë apo ndaljen e mjeteve. Kur personi i autorizuar (polici) lëviz dorën nga lart-poshtë, poshtë-lart (shih fig. 90), tregon se drejtuesi i mjetit apo mjeteve që lëvizin në atë drejtim duhet ta zvogëlojnë shpejtësinë e lëvizjes.




Figura 90. Lëvizja e dorës lart-poshtë, poshtë-lart

Kur personi i autorizuar, me dorë të zgjatur, me shuplakë të hapur lëviz dorën në mënyrë rrethore, nga e majta në të djathtë, (shih fig. 91), tregon se drejtuesi i mjetit apo mjeteve që lëvizin në atë drejtim duhet ta rrisin shpejtësinë e lëvizjes.




Figura 91. Lëvizja e dorës në mënyrë rrethore

Kur personi i autorizuar ka dorën e zgjatur, me shuplakë të hapur të drejtuar nga drejtuesi i mjetit, urdhëron drejtuesin e mjetit të ndalet (shih fig. 92).



Figura 92. Ndalim kalimi për mjetin që i është drejtuar polici

Të gjitha këto sinjale të paraqitura më lart mund të jepen nga personi zyrtar - polici - edhe me tabelë.

### 5.3 SHENJAT ME FËRSHËLLIMË (BILBIL)

Gjatë rregullimit të qarkullimit të trafikut personi zyrtar (polici) jep edhe shenja me anë të fërshëllimave (bilbilit). Nëse personi zyrtar (polici) jep një fërshëllimë të gjatë, tregon se jeni të detyruar të ndaleni për shkak të shkeljes së rregullave të qarkullimit në trafik apo për t'u dhënë përparësi mjeteve të urgjencës (policisë, zjarrfikësve, autoambulancës, mjeteve me përcjellje etj.).

Nëse personi zyrtar (polici) jep dy fërshëllima të shkurtra, tregon se tani jeni i lirë për ta vazhduar lëvizjen (p. sh., kaluan mjetet nën përcjellje).

### 5.4 SHENJAT ME MJETE NDRIÇUESE

Mjetet të cilat i përdor personi zyrtar (polici) për rregullimin e qarkullimit në trafik janë:

- Elektriku
- Feneri.

Lëkundja e një drite të kuqe nga ana e personit zyrtar (policit) në drejtim të mjetit apo përdoruesit të rrugës tregon se ngasësi i mjetit apo përdoruesi i rrugës duhet të ndalet.

Diskutimet dhe pyetjet në grup:

Diskutimet:

- Kuptimi i shenjave nga personi i autorizuar (polici).

Pyetjet:

102. Cili është kuptimi i ngritjes së dorës lart nga personi i autorizuar (polici)?
103. Në rast se personit të autorizuar (policit) ia shohim gjoksin apo shpinën, a kemi të drejtë kalimi?
104. Shpina apo gjoksi i personit të autorizuar (policit) e ka kuptimin e njëjtë me dritën e semaforit. Me cilën dritë?
105. Në rastin kur personi i autorizuar (polici) ngre dorën lart-poshtë, poshtë-lart, çfarë u tregon ngasësve?
106. Çfarë tregon kur personi i autorizuar jep një fërshëllimë të gjatë?
107. Cilat janë mjetet ndriçuese të personit zyrtar që e rregullojnë qarkullimin e trafikut?

## LITERATURA

1. Udhëzimi administrativ nr. 4/2011 për vendosjen, formën, ngjyrën, dimensionet e shenjave dhe sinjalizimet e pajisjeve në komunikacionin rrugor
2. Demir Osmani, Shkëlqim Gruda, Manual i drejtuesit të mjeteve
3. Llazi Tona, Automobili dhe qarkullimi rrugor
4. Manuali i sinjalizimit rrugore për Republikën e Shqipërisë
5. Siguria dhe rregullimi në trafikun rrugor - Maqedoni
6. <http://www.dsgs.de/regelwerke.html>
7. <http://www.zehntner.com/de/produkte/kategorien/griffigkeit/srt-5800>
8. [http://www.zehntner.com/FlippingBooks/Espanol/Ueberischt\\_Strasse/#16](http://www.zehntner.com/FlippingBooks/Espanol/Ueberischt_Strasse/#16)
9. [https://www.google.com/search?q=Verkehrszeichen&tbm=isch&tbo=u&source=univ&sa=X&ved=0ahUKEwi4i521\\_qDSAhVC1BoKHb20A7AQsAQIGw&biw=1920&bih=974#imgrc=\\_](https://www.google.com/search?q=Verkehrszeichen&tbm=isch&tbo=u&source=univ&sa=X&ved=0ahUKEwi4i521_qDSAhVC1BoKHb20A7AQsAQIGw&biw=1920&bih=974#imgrc=_)
10. <http://www.dvr.de/multimedia/downloads/verkehrszeichen.htm>
11. <http://www.auto-tipps.de/rechtliches/verkehrsschilder/>
12. <http://www.heiko-fahrschule.de/hkf/images/Download/verkehrszeichen.pdf>
13. [https://de.wikipedia.org/wiki/Bildtafel\\_der\\_Verkehrszeichen\\_in\\_der\\_Bundesrepublik\\_Deutschland\\_von\\_2013\\_bis\\_2017](https://de.wikipedia.org/wiki/Bildtafel_der_Verkehrszeichen_in_der_Bundesrepublik_Deutschland_von_2013_bis_2017)
14. <https://www.frag-den-fahrlehrer.de/2016/06/04/vorfahrtsregelung-durch-einen-polizisten/>
15. <http://slideplayer.org/slide/10416272/>
16. [https://www.youtube.com/watch?v=\\_KaHbbVxJWE](https://www.youtube.com/watch?v=_KaHbbVxJWE)
17. [http://en.wikipedia.org/wiki/Vienna\\_Convention\\_on\\_Road\\_Signs\\_and\\_Signals](http://en.wikipedia.org/wiki/Vienna_Convention_on_Road_Signs_and_Signals)
18. [https://en.wikipedia.org/wiki/Road\\_surface\\_marking](https://en.wikipedia.org/wiki/Road_surface_marking)
19. <http://www.fpz.unizg.hr/traffic/index.php/PROMTT/article/viewFile/779/62>



